TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Administrim Biznesi" 180 ECTS

Me profile: Menaxhim, Marketing, Kontabilitet-Financë

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm:

1. Dr. Aurela Braholli Kryetar
2. Msc. Irma Shkrepa Anëtar
3. Msc. Sidorela Marini Anëtar
4. Noemia Kello Anëtar, student

Shtator 2025

# PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

## Përshkrim përmbledhës; (200 -400 fjalë)

Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznesi (BaAB) është një program trevjeçar i ciklit të parë me kohë të plotë, i ofruar nga Tirana Business University (TBU) përmes Departamentit të Biznesit dhe Financës, pjesë e Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë. Programi është strukturuar sipas sistemit ECTS, me një ngarkesë totale prej 180 kreditesh, të shpërndara në 6 semestra.

TBU është themeluar me VKM nr. 794, datë 06.10.2010[1], dhe licencuar me Urdhrin e MAS nr. 75, datë 16.02.2011[2], ndërsa akreditimi i parë institucional dhe i programeve të tij është kryer me Vendimin nr. 506, datë 18.07.2013[3]dhe Urdhrin përkatës të Ministrisë së Arsimit, nr.326, date 15.08.2013[4], ndërsa akreditimi periodik i fundit u përmbyll me Vendimin BA. ASCAL nr. 33, 22.04.2022[5] . Afati perfundimtar i vleshmerise se akreditimit se programit te studimit eshte 21.04.2026. Programi zhvillohet në përputhje me Ligjin nr. 80/2015, si dhe me VKM nr. 41, datë 24.01.2018[6], që përcakton strukturën dhe organizimin e studimeve sipas sistemit të krediteve.

Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznesi ofrohet me tre drejtime profilizuese: Menaxhim, Marketing dhe Kontabilitet-Financë. Objektivi kryesor i këtij programi është të përgatisë profesionistë të rinj dhe menaxherë të suksesshëm, të aftë për të përballuar sfidat e një mjedisi biznesi dinamik, të globalizuar dhe konkurrues. Programi synon të ndërtojë te studentët një bazë të qëndrueshme teorike, të integruar me aftësi praktike dhe njohuri aplikative, duke ndihmuar në punësimin e tyre të hershëm dhe përgatitjen për ndjekjen e ciklit të dytë të studimeve.

Aftësimi praktik, i përfshirë në kurrikulë përmes praktikës profesionale, projekteve dhe angazhimit në aktivitete konkrete, përbën shtyllën kryesore për arritjen e këtyre objektivave. Programi është ndërtuar mbi një strukturë të balancuar mësimore, e pasuruar me një larmi fushash që i përgjigjen kërkesave të tregut të punës dhe sektorëve të ndryshëm të industrisë, ku studentët mund të kontribuojnë në role të menaxhimit, marketingut, financës apo kontabilitetit.

Për të mbështetur këtë qasje gjithëpërfshirëse, programi ofron njohuri nga fusha themelore dhe aplikative universale, si: sipërmarrja, kontabiliteti, marketingu, menaxhimi i karrierës, komunikimi, lidershipi, sjellja organizative dhe e drejta e biznesit. Këto fusha nuk shërbejnë vetëm për ngritjen akademike, por janë të dizajnuara për të zhvilluar kompetenca profesionale,

[1] 63. TBU_Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 794, dt. 06. 10. 2010 Licensimi i TBU
[2] 64. Urdhër MAS Nr. 75, datë 16.02.2011
[3] 66. Vendim i Këshillit të Akreditimit Nr. 506, dt 18.07.2013
[4] 65. Urdhër MAS Nr. 326,dt. 15.08.2013 Akreditimi Institucional dhe i Programeve
[5] 70. Vendim BA.Ascal. Nr. 33. datë 22.04.2022
[6] 67.VKM Nr.41, datë 24.01.2018 Për elementet e programeve të studimit e ndryshuar

analitike dhe ndërpersonale, të cilat janë të nevojshme për t'u përfshirë aktivisht në tregun e punës.

Metodat bashkëkohore të mësimdhënies synojnë të nxisin mendimin kritik, aftësitë analitike, lidershipin dhe shpirtin sipërmarrës. Përmes praktikës profesionale dhe lidhjes me partnerë të tregut të punës (përfshirë kompanitë e grupit BALFIN), programi ndërmjetëson hyrjen e studentëve në treg, duke rritur mundësitë për punësim të hershëm dhe zhvillim të karrierës.

Rregulloret[7], plani mësimor[8] dhe syllabuset[9] rishikohen në mënyrë periodike nga Departamenti, në bashkëpunim me Zyrën e Kurrikulave[10] dhe aktorët e jashtëm.

Programi mbështetet nga një staf akademik me kualifikime të larta[11] dhe nga infrastruktura teknologjike bashkëkohore e TBU-së.

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

[7] 9.Rregullore e programit të studimit Ba "Administrim Biznesi" (shqip)
[8] 16.3. Plani mësimor i programit të studimit Ba"Administrim Biznesi "(shqip)
[9] 22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit – BaAB (shqip & anglish)
[10] 15. Politika e Zhvillimit të Kurrikulave në TBU; 16.1Kurrikula e programit Ba "Administrim Biznesi"(shqip)
[11] 22. CV e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM;

### Përshkrim përmbledhës; (200-400 fjalë)

Në përputhje me Manualin e ASCAL "Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimi, procesi i vlerësimit të brendshëm, në kuadër të përgatitjes për akreditimin e programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi (BaAB) me tre profilet: "Kontabilitet-Financë", "Menaxhim" dhe "Marketing", u iniciua me Urdhrin nr. 08/1, datë 20.03.2025 të Rektorit të TBU-së, për ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm (GVB)[12].

GVB është përbërë nga katër anëtarë, ku tre janë përfaqësues të stafit akademik efektiv të Departamentit të Biznesit dhe Financës, dhe njëri është student aktiv i këtij programi studimi. Me ngritjen e grupit, nisi dhe organizimi i punës sipas një plani të qartë pune, i cili përfshinte ndarjen e përgjegjësive sipas fushave të raportit dhe afatet për përgatitjen e draftit përfundimtar të Raportit të Vetëvlerësimit të Brendshëm (RVB), në përputhje me detyrimet ligjore. Departamenti Përgjegjës për këtë program studimi është caktuar Departamenti i Biznesit dhe Financës[13].

Të gjitha më sipër, si dhe ky raport hartohen bazuar në dispozitat ligjore mbi arsimin e lartë, aktet nënligjore të MASR dhe ASCAL, si dhe në Statutin dhe Rregulloren institucionale të TBU-së.

Për orientim të mëtejshëm mbi formatin e RVB-së, metodologjinë dhe standardet e vlerësimit, anëtarët e GVB-së morën pjesë në takime informuese dhe trajnime të organizuara nga Zyra e NJSBC & Komisionet e Cilësisë. Këto takime synuan harmonizimin e mënyrës së hartimit të raportit me manualin e ASCAL-it dhe standardet kombëtare të cilësisë në arsimin e lartë.

Kryetari i GVB-së ka ndarë detyrat midis anëtarëve të grupit, në përputhje me strukturën e RVB-së, duke siguruar bashkëpunim të ngushtë ndërmjet anëtarëve për temat që kërkonin ndërthurje informacioni. Në proces janë përfshirë gjithashtu dhe përfaqësues të strukturave të tjera mbështetëse të TBU-së, si Zyra e Çështjeve Studentore, Zyra e Burimeve Njerëzore, Zyra e Projekteve & Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar-Partneritetet ,Zyra e Financës, dhe Zyra e Kurrikulave, për të ofruar të dhëna dhe dokumentacion mbështetës.

Të dhënat për hartimin e raportit janë mbledhur nga burime të ndryshme, përfshirë departamentin përgjegjës, sistemin elektronik të administrimit akademik, raportet periodike të analizës së programit, dhe dokumentet themelore institucionale. Drafti përfundimtar i raportit është rishikuar nga Përgjegjësi i Departamentit të Biznesit dhe Financës, dhe më pas nga Zyra e Cilësisë dhe strukturat drejtuese të TBU-së.

GVB ka zhvilluar takime të rregullta për të diskutuar mbi ecurinë e punës, për të ndarë informacione shtesë dhe për të garantuar koherencën ndërmjet kapitujve të raportit. Dosja e

[12] 71. Urdher i Rektorit _ngritja e GVB për akreditimin e programit të studimit BaAB
[13] 2.1.4. Vendim SA Nr. 51 dt.11.09.23 mbi ristrukturimin ne zbatim te urdherave 195, 196 MAS.



TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

Vlerësimit të Brendshëm (DVV), që shoqëron RVB-në, përfshin edhe dokumentacionin mbështetës në formën e aneksimeve të strukturuara sipas kritereve për çdo standard.

Ky proces është zhvilluar në përputhje të plotë me Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor", aktet nënligjore të MASR, udhëzimet e ASCAL dhe dokumentet themelore të TBU-së, me qëllim garantimin e një vetëvlerësimi gjithëpërfshirës dhe objektiv për cilësinë e programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi.

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

# SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

## I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr., datë janë:

**Rekomandimi [1]:** *Institucioni, të marrë masa që syllabuset e ketij programi studimi, të jenë në përputhje me formatin e përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.*

**Rekomandimi [2]:** *Institucioni, të pasurojë fondin e literaturës fizike në bibloteke dhe të sigurojë materialet e nevojshme studimore, në funksion të nevojave të studentëve të këtij programi studimi.*

**Rekomandimi [3]:** *Institucioni, të përdorë një sistem të brëndshëm informatik për menaxhimin e informacionit dhe të të dhënave të studentëve, me qëllim ndjekjen dhe dokumentimin e ecurisë së tyre në këtë program studimi.*

**Rekomandimi [4]:** *Institucioni, të hartojë, dokumetojë e bëjë publike procedurën që ndjek për punësimin e personelit akademik.*

**Rekomandimi [5]:** *Institucioni, të rrisë përpjekjet për përmbushjen plotësisht të rekomandimit të lënë nga akreditimi i pare në lidhje me publikimin e vlerësimeve, lidhur me procesin e sigurimit të cilësisë.*

## II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

1. ***Syllabuset në përputhje me formatin e përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi[14]***

   Të gjitha silabuset e programeve të studimit në TBU janë hartuar në përputhje të plotë me VKM Nr. 41, datë 24.01.2008 (e ndryshuar). Ato përmbajnë pasqyrën informative të lëndës, objektivat e të nxënit, temat sipas javëve, format e kontrollit të dijeve, literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar, si dhe vërejtjet përfundimtare të pedagogut, duke reflektuar plotësisht rekomandimin e akreditimit të mëparshëm.

2. ***Pasurimi i fondit të literaturës fizike në bibloteke dhe sigurimi i materialeve të nevojshme studimore në funksion të nevojave të studentëve[15]***

   Institucioni ka identifikuar dhe siguruar literaturën fizike dhe materialet studimore të nevojshme për pasurimin e fondit të bibliotekës, duke iu përgjigjur kërkesave dhe nevojave akademike të studentëve. Për këtë qëllim, institucioni parashikon fonde të dedikuara për pasurimin me literaturë dhe tekste të reja.

---

[14] 67.VKM Nr.41, datë 24.01.2018 Për elementet e programeve të studimit e ndryshuar:22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit – BaAB (shqip & anglisht), 23. Formati i Syllabusit (shqip-anglisht) – VKM 412018.

[15] 48.2 Procedura e miratimit të Dokumentit Mbi Procedurën e Blerjes së Literaturës në TBU; 37.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programin e studimit (BaAB)

Procesi i përzgjedhjes dhe përditësimit të literaturës realizohet në bashkëpunim ndërmjet drejtuesve të njësive bazë, pedagogëve dhe drejtuesve të njësive kryesore, të cilët ndjekin një procedurë të përcaktuar për blerjen dhe sigurimin e literaturës. Ky mekanizëm garanton që biblioteka të përmbajë materiale bashkëkohore dhe në përputhje me zhvillimet shkencore e profesionale në fushën përkatëse.

Gjithashtu, vlen të theksohet marrëveshja e nënshkruar midis TBU-së dhe AADF (Albanian-American Development Foundation), e cila, ndër të tjera, mundëson pasurimin e mëtejshëm të fondit të literaturës dhe ofrimin e burimeve shtesë për studentët dhe stafin akademik.

3. ***Sistem i brëndshëm informatik për menaxhimin e informacionit dhe të të dhënave të studentëve***[16]

   Tirana Business University (TBU), në funksion të përmbushjes së rekomandimit për përdorimin e një sistemi të brendshëm informatik për menaxhimin e informacionit dhe të dhënave të studentëve, është angazhuar në mënyrë konkrete në zhvillimin dhe implementimin e sistemeve teknologjike që mbështesin procesin mësimor dhe ndjekjen e ecurisë akademike të studentëve.Aktualisht, është në proces implementimi sistemi "Pitagora", një platformë e dedikuar për menaxhimin e rezultateve të studentëve, i cili do të mundësojë ruajtjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave akademike në mënyrë të strukturuar dhe të sigurt. Ky sistem do të shërbejë si një instrument thelbësor për ndjekjen individuale të performancës së studentëve në të gjitha ciklet e studimit.Krahas kësaj, TBU ka implementuar platformën TBU LMS, e ndërtuar mbi sistemin Moodle, e cila është aktualisht funksionale dhe mbështet procesin mësimor në mënyrë gjithëpërfshirëse. Kjo platformë mundëson shpërndarjen e materialeve mësimore, komunikimin ndërmjet studentëve dhe stafit akademik, si dhe realizimin e vlerësimeve online për lëndët dhe për vetë stafin pedagogjik.Përmes përdorimit të këtyre dy platformave të integruara, TBU garanton menaxhimin efektiv të të dhënave të studentëve dhe ndjekjen e ecurisë së tyre akademike, duke rritur transparencën, efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve në mbështetje të studentëve dhe stafit akademik.

4. ***Transparencë që ndiqet për punësimin e personelit akademik***[17]

   Institucioni ka të hartuar, dokumentuar dhe bërë publik procesin e punësimit të personelit akademik, në përputhje me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë (L-AL Nr.80/2015), Statutin dhe Rregulloret përkatëse. Pozicionet vakante publikohen në faqen zyrtare (www.tbu.edu.al) dhe rrjetet sociale, ndërsa kandidatët vlerësohen e rankohen sipas kritereve të përcaktuara. Procesi drejtohet nga një Komision i posaçëm dhe përmbyllet me nënshkrimin e kontratës nga Rektori dhe publikimin e Urdhrit të Emërimit, duke garantuar transparencë dhe përzgjedhjen më të përshtatshme për çdo pozicion.

---

[16] 45.1 Udhëzues për përdorimin e teknologjisë të informacionit); 45.2 Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS; 45.3 Guidë për studentët për përdorimin e LMS

[17] 13. Rregullore për punësimin, largimin nga puna dhe vlerësimin e personelit; 13.1.Shembull njoftim për vend vakant për staf akademik në website; 13.2. Politika e BNJ ne TBU; 13.3.Format Dosje staf akademik (administrohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore, sipas PAK/PAE); 13.4.Praktika e rekrutimit te stafit

5. ***Rishikimi i procesit të sigurimit të cilësisë***[18]

Në përmbushje të rekomandimit të lënë nga procesi i akreditimit, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) ka ndërmarrë publikimin e vlerësimeve të procesit të sigurimit të cilësisë. Rezultatet e fokus-grupeve dhe anketimit të studentëve, të realizuara dy herë në vit, përpunohen dhe analizohen nga NJSBC në bashkëpunim me Komisionet e Cilësisë. Publikimi i tyre siguron transparencë institucionale, përmirësim të vazhdueshëm të programeve dhe përputhshmëri me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të akreditimit.

[18] 36.1.Rregullore e NJSBC; 36.1.2. Plan pune i NJSBC 2024-2025; 36.1.3. Raporti vjetor i NJSBC 23-24; 36.3. Politika per Sigurimin e Cilesise;.36.3.2. Plani pune i KSC FBD 24-25; 36.3.3. Raporti vjetor i KSC FBD 23-24

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në " Administrim Biznesi"

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

| Standardi I.1<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Tirana Business University College (TBU) ka nisur dhe ushtruar veprimtarinë akademike mbi bazën e kuadrit ligjor të miratuar nga institucionet shtetërore përkatëse. Krijimi dhe funksionimi i tij mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 794, datë 06.10.2010, Urdhrin e Ministrit të Arsimit Nr. 75, datë 16.02.2011, si dhe në akreditimin institucional dhe të programeve përmes Urdhrit Nr. 326, datë 15.08.2013, i paraprirë nga Vendimi i Këshillit të Akreditimit nr. 506, datë 18.07.2013[19].<br><br>Programet e studimit të ofruara nga TBU janë të konceptuara dhe zbatuara në përputhje me prioritetet kombëtare të politikave arsimore dhe zhvillimore të vendit. Fokus i veçantë u kushtohet punësimit të të rinjve, zhvillimit të sipërmarrjes, nxitjes së kreativitetit dhe inovacionit si dhe zhvillimit të kapitalit njerëzor, duke synuar ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave kulturore e akademike kombëtare.<br><br>Harmonia e programeve me objektivat kombëtare reflektohet në dokumentet themelore të institucionit, siç janë Statuti i TBU[20] dhe Strategjia e Zhvillimit Institucional 2024–2029[21] ku përcaktohet qartë misioni i institucionit për të përgatitur profesionistë që kontribuojnë në zhvillimin socio-ekonomik të vendit dhe në integrimin evropian të arsimit të lartë.<br><br>Për më tepër, përmbajtja akademike dhe struktura e programeve të studimit, të pasqyruara në kurrikulat dhe planet mësimore të programit BaAB[22] janë ndërtuar sipas kërkesave të Kuadrit Kombëtar të Kualifikimeve dhe VKM Nr. 41, datë 24.01.2018[23]. Kjo garanton përputhjen me standardet kombëtare dhe ruajtjen e integritetit akademik. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Programi Bachelor në Administrim Biznesi (BaAB) është ndërtuar në përputhje të plotë me misionin e Tirana Business University College, i cili përqendrohet në përgatitjen e profesionistëve të kualifikuar në fushat e biznesit, drejtësisë dhe inovacionit, përmes një edukimi cilësor, praktik dhe të orientuar drejt nevojave të tregut të punës dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit[24] |

[19] 63. VKM Nr. 794, dt. 06.10.2010; 64. Urdhri Nr. 75, dt. 16.02.2011; 65. Urdhri Nr. 326, dt..15.08.2013; 66. Vendimi Nr. 506, dt. 18.07.2013.
[20] 2. Statuti i TBU-së, Neni 8
[21] 3.1 Strategjia e Zhvillimit Institucional 2024–2029, fq. 8-9.
[22] 16.1Kurrikula e programit Ba "Administrim Biznesi"(shqip); 16.3. Plani mësimor i programit të studimit Ba"Administrim Biznesi "(shqip).
[23] 67.VKM Nr.41, datë 24.01.2018 Për elementet e programeve të studimit e ndryshuar
[24] 3.1. Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029, fq. 8-9

| | |
|---|---|
| | Ky mision institucional është i formalizuar në Statutin e TBU-së dhe reflektohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në strukturën organizative dhe akademike të institucionit, ku Fakulteti i Biznesit dhe Drejtësisë dhe Departamenti i Biznesit dhe Financës përbëjnë njësi themelore që mbulojnë këtë fushë veprimtarie[25].<br><br>Programi BaAB është projektuar dhe menaxhohet nga njësia përgjegjëse në përputhje me kapacitetet institucionale, eksperiencën në arsimin profesional, dhe objektivat afatmesme të zhvillimit të ofrimit akademik të TBU-së. Në dokumente si Plani Strategjik i programit dhe Raportet periodike të vetëvlerësimit, theksohet se ky program është një hallkë kyçe për realizimin e misionit të institucionit dhe për konsolidimin e pozicionit të tij në arsimin e lartë në fushën e administrimit të biznesit.[26]<br><br>Gjithashtu, programi është i strukturuar sipas standardeve të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018[27] me përmbajtje që pasqyron fushën konkrete të veprimtarisë së institucionit. Kurrikula, plani mësimor dhe syllabuset janë të përqendruara në zhvillimin e kompetencave profesionale në administrim biznesi dhe sipërmarrje, në përputhje me misionin formues dhe profilin institucional.[28] |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij. | Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznesi, me tre profilet e tij: Kontabilitet-Financë, Menaxhim dhe Marketing, është hartuar dhe ofrohet në përputhje të plotë me Strategjinë e Zhvillimit të TBU-së 2024–2029[29] e cila përcakton zhvillimin e programeve të orientuara drejt tregut të punës, digjitalizimit, ndërkombëtarizimit dhe zhvillimit të kompetencave praktike të studentëve. Ky program përputhet gjithashtu me Statutin e TBU-së[30], i cili sanksionon të drejtën e institucionit për të ofruar programe në fushat e miratuara akademike dhe në përputhje me misionin institucional.<br><br>Programi është zhvilluar brenda strukturës së përcaktuar nga Rregullorja e TBU[31], Rregullorja e Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë[32] dhe Rregullorja e Departamentit të Biznesit dhe Financës[33], të cilat rregullojnë procedurat për hartimin, miratimin dhe menaxhimin e programeve të studimit në përputhje me standardet ligjore dhe institucionale. Gjithashtu, programi është i mbështetur në strukturën organizative të TBU-së[34] dhe Vendimin e Senatit për riorganizimin e njësive akademike[35] të cilat konfirmojnë kompetencën e njësisë përkatëse për ofrimin e këtij programi.<br><br>Për rrjedhojë, programi i ciklit të parë Bachelor në Administrim Biznesi është ndërtuar në përputhje të qartë me dokumentet strategjike, statutore dhe |

[25] 2.Statuti TBU; 2.2. Struktura Organizative TBU; 2.1.1. Vendim Senati 7 dt.28.09. 2022 per riorganizmin e Fakulteteve FAB dhe FD.

[26] 4. Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit AB-BA; 54.2. Raporti vjetor i DBF 23-24

[27] 67.VKM Nr.41, datë 24.01.2018 Për elementet e programeve të studimit e ndryshuar

[28] 16.1. Kurrikula e programit Ba "Administrim Biznesi"(shqip); 16.3. Plani mësimor i programit të studimit Ba"Administrim Biznesi "(shqip); 15. Politika e Zhvillimit të Kurrikulave në TBU, 22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit – BaAB (shqip & anglisht)

[29] 3.1. Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029

[30] 2. Statuti i TBU-së, Neni 8

[31] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"

[32] 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë

[33] 7. Rregullore e Departamentit të Biznesit dhe Financës (FBD)

[34] 2.2. Struktura Organizative TBU

[35] 2.1.1. Vendim Senati 7 dt.28.09. 2022 per riorganizmin e Fakulteteve FAB dhe FD

| | |
|---|---|
| | rregullatore të institucionit dhe përfaqëson një zhvillim të qëndrueshëm brenda fushës akademike të TBU-së. |
| **Kriteri 4.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznesi (BaAB) mbështetet mbi një bazë të konsoliduar akademike dhe institucionale, që dëshmon qartë se institucioni ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e nevojshme për ofrimin e një programi të tillë në këtë fushë.<br><br>Në kuadër të programit, është angazhuar një strukturë e kualifikuar e stafit akademik, me tituj dhe grada shkencore në fushat përkatëse të programit[36] Të dhënat tabelore për ngarkesat mësimore dhe profili i stafit tregojnë që programi ofrohet në përputhje me standardet e kërkuara për përfaqësim dhe cilësi akademike. CV-të e stafit[37] dëshmojnë për përvojën e tyre në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, si dhe për përfshirjen e tyre të mëparshme në programe të ngjashme.<br><br>Programi mbështetet gjithashtu nga burime të mjaftueshme infrastrukturore dhe logjistike, përfshirë mjedise mësimore, pajisje didaktike dhe platforma digjitale[38], që mundësojnë zhvillimin efikas të procesit mësimor. Biblioteka institucionale, me akses në literaturë të përditësuar dhe burime elektronike për fushën e administrimit të biznesit, përmbush kriteret për mbështetjen akademike të studentëve.[39]<br><br>Bazuar në të gjitha këto elemente, rezulton se TBU ka përvojën institucionale, kapacitetin akademik dhe burimet materiale të nevojshme për të ofruar programin Bachelor në Administrim Biznesi në përputhje me standardet e kërkuara të arsimit të lartë. |
| **Kriteri 5.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznesi (BaAB), është i pozicionuar qartë brenda fushës akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë, që përbën njësinë bazë përgjegjëse për zhvillimin dhe administrimin e tij. Kjo fushë akademike është e përcaktuar në vendimet e Senatit Akademik dhe në strukturën organizative të TBU-së[40] ku përfshihen fushat e ekonomisë, administrimit dhe drejtësisë së biznesit.<br><br>Në përputhje me klasifikimin dhe kodifikimin e programeve të studimit, të bazuar në VKM Nr. 310, datë 11.05.2022[41] dhe Udhëzimin Nr. 31, datë 15.11.2022[42], programi BaAB klasifikohet në fushën "Ekonomi, Biznes dhe Administrim", me nënfusha që përputhen me specializimet e ofruara. Ky |

[36] 27. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse (Aneks Tabela no.1 & 2 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB), 28. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit BaAB për 3 vite 21-24 (Aneks Tabela 6,12,7,8 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB
[37] 24. CV e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit
[38] 44.2. Mjediset e FakultetitNjësive Bazë (Aneks Tabela 16); 45. Strategjia e zhvillimit të IT; 49. Të dhëna të plota për platformat on-line-Struktura e teknologjisë së informacionit, Biblioteka, Biblioteka online, etj (Aneks Tabela 17)
[39] 48.1. Inventari i teksteve në bibliotekë për fushën e programit të studimit Ba AB
[40] 2.1.1. Vendim Senati 7 dt.28.09. 2022 per riorganizmin e Fakulteteve FAB dhe FD; 2.2. Struktura Organizative TBU
[41] 69.1.VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 Kodifikimi programeve qbz
[42] 69.3Udhezim-Nr.31-date-15.11.2022-Kodifikimi-i-programeve-te-studimit-IAL

| | |
|---|---|
| | kodifikim është konfirmuar gjithashtu nga korrespondenca me MAS dhe shkresa zyrtare për konfirmimin e kodeve të programeve të studimit në TBU[43] duke garantuar përputhje të plotë me standardet kombëtare dhe direktivat evropiane.<br><br>Fusha specifike e programit lidhet ngushtë me aktivitetin kërkimor dhe pedagogjik të njësisë përgjegjëse, e cila, përmes strukturave të saj akademike dhe kërkimore si QKSEJ dhe Departamenti i Biznesit dhe Financës, zhvillon projekte, kërkime dhe publikime në fushat që mbulon ky program[44] |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi I.2<br>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Tirana Business University (TBU) organizon dhe menaxhon programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi (BaAB), përmes një strukture të qartë përgjegjësish dhe një bashkëpunimi funksional ndërmjet njësive akademike dhe administrative[45].<br><br>Në procesin e hartimit dhe zhvillimit të programit, është ndjekur një qasje institucionale e koordinuar, ku njësia bazë përgjegjëse (Departamenti i Biznesit dhe Financës) ka bashkëpunuar ngushtë me Zyrën e Kurrikulave, Zyrën e Projekteve dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar, Zyrën e Burimeve Njerëzore, si dhe me njësitë mbështetëse akademike, për të siguruar një zhvillim koherent të përmbajtjes mësimore, përzgjedhjen e stafit dhe përditësimin e vazhdueshëm të programit.<br><br>Përgjegjësitë janë të ndara qartë përmes rregulloreve përkatëse[46], duke përcaktuar rolin e fakultetit, departamentit, koordinatorit të programit[47]. Procesverbalet dhe raportet vjetore të njësive[48] tregojnë një analizë të vazhdueshme të performancës së programit dhe përmirësimit të tij në bazë të të dhënave cilësore dhe sasiore. |

[43] 69.5. Shkresa e MAS Nr. 738122, dt. 30.12.2024 për Konfimimin e kodeve te programeve të studimit në Kolegjin Universitar Tirana Business University
[44] 43. Rregullore e Qendrës për Kërkime e Studime Ekonomike dhe Juridike – QKSE; 43.1. Indikatorët e vlerësimit të performancës kërkimore -shkencore për personelin akademik; 43.3. Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit të programit të studimit BaAB (Aneks Tabela 19)
[45] 2.2.Struktura Organizative TBU
[46] 26. 5Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU; 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë;7. Rregullore e Departamentit të Biznesit dhe Financës (FBD)
[47] 39. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit BaAB
[48] 54.2. Raporti vjetor i DBF 23-24.

| | |
|---|---|
| | Njësitë bazë në TBU funksionojnë në përputhjë të plotë me Statutin dhe të gjitha rregulloret e TBU-së,[49] duke përfshirë këtu edhe Rregulloren e Funksionimit të Njësisë Bazë.[50]<br><br>Gjithashtu, TBU siguron monitorim sistematik të zhvillimit të programit përmes mekanizmave të cilësisë, si NJSBC dhe Komisionet e Cilësisë në fakultet [51], të cilët mbledhin vazhdimisht të dhëna përmes pyetësorëve, fokus-grupeve dhe raportimeve nga stafi e studentët[52] . |
| Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | Tirana Business University (TBU), në funksion të realizimit të objektivave të programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi (BaAB), ka ndërtuar dhe zhvilluar një rrjet të gjerë bashkëpunimesh institucionale me aktorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, që mbështesin drejtpërdrejt formimin profesional, zhvillimin akademik dhe punësueshmërinë e studentëve.<br><br>Fakulteti i Biznesit dhe Drejtësisë, si njësi përgjegjëse për ofrimin e këtij programi, në bashkëpunim me Departamentin e Biznesit dhe Financës dhe Zyrën e Projekteve & Bashkëpunimit Ndërkombëtar, ka vendosur marrëdhënie të qëndrueshme me institucione të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit, si dhe me kompani të njohura kombëtare dhe ndërkombëtare, institucione publike dhe organizata të rëndësishme jo publike.<br><br>Për vitin akademik 2023–2024, studentëve të programit BaAB u është mundësuar kontakti për internship-e punësime pranë 59 kompanive[53] të mirënjohura në fushën e biznesit, nëpërmjet rrjetit të partnerëve të TBU dhe strukturave të brendshme si Bordi i Tregut të Punës[54]. Këto bashkëpunime kanë ndihmuar në identifikimin e nevojave reale të tregut të punës dhe në përshtatjen e vazhdueshme të kurrikulës, për të garantuar që formimi i studentëve të jetë në përputhje me kërkesat aktuale të sektorit privat dhe institucional.<br><br>Pjesë e një grupi të konsoliduar si BALFIN Group, TBU përfiton nga akses i drejtpërdrejtë në rrjete reale biznesi, duke e kthyer këtë në një nga avantazhet e tij strategjike për zhvillimin praktik dhe profesional të studentëve. Marrëveshjet e bashkëpunimit me universitete të njohura kombëtare dhe ndërkombëtare[55] kanë gjeneruar gjithashtu mundësi për shkëmbime akademike, përfshirje në projekte ndërkombëtare dhe trajnime për stafin, duke rritur cilësinë dhe ndërkombëtarizimin e programeve. |

[49] 2. Statuti i TBU; 3.1 Strategjia e Zhvillimit te TBU 2024-2029; 4. Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit MP-ABA120; 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU; 6. Rregullore e Fakultetit te Biznesit dhe Drejtesise.
[50] 7. Rregullore e Departamentit te Biznesit dhe Finances.
[51] 36.1.2. Plan pune i NJSBC 2024-2025; 36.3.2. Plan pune i KSC FBD 24-25
[52] 36.6.Formati i pyetësorit për vlerësimin e lëndës & pedagogut nga studentët; 36.7. Raporti i Fokus Grupeve
[53] 37.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi (Aneks Tabela 5)
[54] 14.1. Vendim Dekanati për Bordin e Tregut të Punës FBD; 14.1.1. Axhenda e takimit me BTP 2023-2024; 37.3.Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & biznese në lidhje me programet e studimit (BaAB).
[55] 34.Projektet e fituara nga TBU Projekte ku është përfshirë DFB Projekte të fituara tek AKKSHI; 47.3. Raporti në lidhje me mobilitetet e stafit dhe studentëve



TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| | Këto marrëveshje kanë sjellë përfitime të shumanshme:<br><br>• Zhvillim i praktikave profesionale të studentëve, me fokus në qasjen reale të kërkuar nga tregu;<br>• Përmirësim i vazhdueshëm i kurrikulës në konsultim me aktorët e biznesit;<br>• Shkëmbim stafi akademik dhe eksperience me partnerë vendas dhe europianë, që ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e mësimdhënies;<br>• Ndërthurje e ekspertizës akademike me përvojën praktike që ofron tregu i punës, duke e bërë programin BaAB më të aplikueshëm dhe të orientuar drejt karrierës.<br><br>Përmes këtij rrjeti bashkëpunimesh, TBU jo vetëm që forcon misionin e tij si institucion i orientuar drejt tregut, por gjithashtu siguron një platformë të qëndrueshme për zhvillimin profesional të studentëve dhe stafit |
| Kriteri 3. Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj. | Në funksion të realizimit sa më cilësor të programit Bachelor në Administrim Biznesi (BaAB), Tirana Business University (TBU) ka zhvilluar një rrjet të gjerë marrëdhëniesh bashkëpunimi me institucione akademike, institute kërkimore dhe kompani të fushës së biznesit, të cilat shërbejnë si një platformë e qëndrueshme për praktikat profesionale të studentëve, shkëmbimin e përvojës akademike dhe profesionale, si dhe për mbështetjen teknike dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta.<br><br>Këto marrëdhënie bashkëpunimi, të formalizuara përmes marrëveshjeve të posaçme[56], kanë për qëllim jo vetëm përfshirjen e studentëve në aktivitete praktike, por edhe krijimin e lidhjeve afatgjata dhe të strukturuara me tregun e punës, përmes identifikimit të punëdhënësve potencialë, shërbimeve të konsulencës, si dhe aktiviteteve të mbështetura nga partnerët publikë dhe privatë.<br><br>Fakti që TBU është pjesë e një prej grupeve më të mëdha ekonomikë në rajon, BALFIN Group, i jep institucionit një avantazh të veçantë në ndërtimin e urave të qëndrueshme mes botës akademike dhe asaj të biznesit. Për studentët e programit BaAB, kjo përkthehet në akses të drejtpërdrejtë në praktika profesionale cilësore, mbështetje teknike dhe mentorim nga kompani partnere, si dhe në rritje të ndjeshme të mundësive për punësim pas diplomimit.<br><br>Gjithashtu, TBU ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit[57], të cilat krijojnë hapësira për mobilitet të studentëve dhe stafit akademik, përfshirje në projekte ndërkombëtare dhe shkëmbim të përvojës mësimdhënëse dhe kërkimore. Kjo lloj qasjeje jo vetëm që forcon cilësinë e programit, por gjithashtu kontribuon |

[56] 37.3.Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & biznese në lidhje me programet e studimit (BaAB)
[57] 34.Projektet e fituara nga TBU Projekte ku është përfshirë DFB Projekte të fituara tek AKKSHL; 47.3. Raporti në lidhje me mobilitetet e stafit dhe studentëve



TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| | në ndërkombëtarizimin e përvojës studentore dhe të kapaciteteve institucionale të TBU-së.<br><br>Pra, përmes një rrjeti funksional dhe strategjik të bashkëpunimeve, TBU garanton realizimin efektiv të praktikave profesionale dhe fuqizon lidhjen e studentëve me tregun e punës dhe me zhvillimet bashkëkohore në fushën e administrimit të biznesit. |
| Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | Tirana Business University (TBU), përmes njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi (BaAB) – Departamentit të Biznesit dhe Financës – zhvillon në mënyrë periodike raporte analitike që vlerësojnë përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit, në funksion të përmirësimit dhe realizimit efektiv të programit të studimit.<br><br>Këto raporte shërbejnë si mjet reflektimi dhe vlerësimi për ndikimin e bashkëpunimeve me kompani, institucione dhe organizata të tjera në procesin formues të studentëve, veçanërisht në aspektet praktike të programit. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit[58], i përgatitur nga departamenti në bashkëpunim me Zyrën e Projekteve dhe Zyrën e Çështjeve Studentore, analizon elementë si: numri i studentëve të përfshirë në praktika, cilësia e përvojës së fituar, përshtatshmëria e institucioneve pritëse dhe ndikimi në punësueshmëri.<br><br>Për më tepër, në përputhje me praktikat e sigurimit të brendshëm të cilësisë, raportet përfshijnë edhe sugjerime për përmirësimin e bashkëpunimeve ekzistuese, si dhe identifikimin e sektorëve dhe institucioneve të reja me të cilat mund të zgjerohet rrjeti i partnerëve. Këto analiza ndihmojnë gjithashtu në rishikimin dhe përditësimin e përmbajtjes së kurrikulës, në përputhje me zhvillimet e tregut dhe me informacionin e marrë nga bashkëpunëtorët institucionalë.<br><br>Përgatitja dhe analizimi i këtyre raporteve përbën një praktikë të konsoliduar të departamentit, e dokumentuar përmes procesverbaleve dhe planit të punës së njësisë akademike[59], dhe përfshihet si komponent i rëndësishëm në raportet vjetore të vetëvlerësimit të programit. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

[58] 37.4. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.
[59] 54.2. Raporti vjetor i DBF 23-24.

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

| Standardi II.1<br>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznesi (BaAB) në Tirana Business University (TBU) është organizuar në lëndë dhe module të strukturuara, në përputhje të plotë me legjislacionin vendas në fuqi, veçanërisht me parashikimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit", si dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).<br><br>Struktura e programit është ndarë në tre profile: Kontabilitet-Financë, Menaxhim, dhe Marketing, dhe çdo profil përmban lëndë të ndara në veprimtari formuese të detyrueshme dhe me zgjedhje, të cilat janë të shpërndara në mënyrë të balancuar gjatë gjithë ciklit të studimeve.<br><br>Plani mësimor dhe kurrikula e programit[60] pasqyrojnë qartë ndarjen sipas krediteve, niveleve të formimit dhe kompetencave të synuara, duke respektuar kriteret e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.<br><br>Çdo lëndë është e shoqëruar me një syllabus të detajuar[61], që përfshin numrin e krediteve, rezultatet e të nxënit, mënyrën e vlerësimit dhe ngarkesën e përgjithshme studentore në përputhje me ECTS. Për më tepër, ndryshimet në kurrikulë për vitet akademike përkatëse janë të dokumentuara dhe të miratuara në përputhje me procedurat institucionale[62].<br><br>Organizimi i programit siguron qartësi strukturore, ndarje funksionale të përmbajtjes, dhe përshtatshmëri me standardet evropiane të arsimit të lartë, duke garantuar lëvizshmëri akademike dhe krahasueshmëri me programe të ngjashme ndërkombëtare. |
| Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të | Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznesi (BaAB) në TBU është projektuar për të zhvilluar njohuri të përparuara dhe kompetenca të thelluara profesionale, duke synuar përgatitjen e studentëve për një larmë të gjerë profesionesh dhe specialitetesh në fushën e biznesit.<br><br>Përmes strukturës së tij të balancuar ndërmjet formimit teorik dhe praktik, programi përqendrohet në zhvillimin e të kuptuarit kritik të teorive, |

[60] 16.1Kurrikula e programit Ba "Administrim Biznesi"(shqip); 16.3. Plani mësimor i programit të studimit Ba"Administrim Biznesi "(shqip); 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarise formuese -Ba "Administrim Biznesi"

[61] 22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit – BaAB (shqip & anglisht)

[62] 16.6.Shkresa TBUNr.45,dt.27.03.2025 Per ndryshimin ne kurrikulat e programeve te studimit te TBU 25-26 (ndryshim brenda 20%); 16.7. Shkresa e MAS, Nr. 2109/3, Dt. 06/05/2025 per konfirmimin e ndryshimeve

| | |
|---|---|
| përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | koncepteve dhe parimeve të administrimit, duke u mbështetur në praktikat më të mira bashkëkohore të arsimit të lartë.<br><br>Përmbajtja e programit është ndërtuar në përputhje me profilin e kualifikimit të ciklit të parë të studimeve sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, duke ofruar një bazë të fortë akademike dhe njohuri të aplikueshme në fusha si: kontabiliteti, financa, menaxhimi, marketingu, sipërmarrja, si dhe planifikimi strategjik dhe operativ i biznesit.<br><br>Përmes lëndëve të strukturuara në kategori A-E[63] , programi ofron një ndërthurje të formimit të përgjithshëm, formimit profesional karakterizues, dhe elementëve ndërdisiplinorë dhe përmbyllës, që çojnë drejt aftësimit të studentit për analizë, vendimmarrje dhe zgjidhje të situatave të ndërlikuara dhe të paparashikueshme në kontekste reale biznesi.<br><br>Zhvillimi i këtyre aftësive mbështetet edhe nga komponentët praktikë të programit, si praktikat profesionale [64], projektet me karakter aplikativ, si dhe përfshirja në aktivitete që nxisin mendimin kritik, punën në grup dhe komunikimin profesional. Gjithashtu, lëndët që përfshihen në profilizimet specifike kontribuojnë në formimin e shprehive të orientuara drejt profesionit të ardhshëm, duke ofruar njohuri të specializuara dhe aftësi të përkthyera lehtësisht në mjedise pune. |
| **Kriteri 3.** Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. | Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznesi (BaAB) në Tirana Business University (TBU) është organizuar në lëndë dhe module të strukturuara, në përputhje të plotë me legjislacionin vendas në fuqi, veçanërisht me parashikimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit", si dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).<br><br>Struktura e programit është e përshkruar qartë në Rregulloren e programit[65], ku lëndët janë të ndara sipas kategorive A-E, siç parashikohet nga legjislacioni në fuqi. Neni 5 i kësaj rregulloreje përcakton se:<br><br>"Studenti që ndjek këtë program studimi duhet të përfitojë të paktën 180 kredite, nga të cilat:<br>33 ECTS në kategorinë A – disiplinat e formimit të përgjithshëm,<br>96 ECTS në kategorinë B – disiplinat karakterizuese,<br>22 ECTS në kategorinë C – disiplinat ndërdisiplinore/integruese/profilizuese,<br>23 ECTS në kategorinë D – disiplinat plotësuese,<br>dhe 6 ECTS në kategorinë E – detyrimet përmbyllëse."<br><br>Kjo ndarje siguron ekuilibrin mes përbërësve formues, si dhe përputhjen me kornizën kombëtare të kualifikimeve, duke mundësuar një program të balancuar dhe të krahasueshëm me programet homologe europiane. |

[63] 9. Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi (shqip)
[64] 37. Rregullore e praktikës mësimore & dokumentat përkatëse
[65] 9. Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi (shqip)

| | |
|---|---|
| | Plani mësimor dhe kurrikula e programit[66] pasqyrojnë qartë ndarjen sipas krediteve, niveleve të formimit dhe kompetencave të synuara, duke respektuar kriteret e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.<br><br>Çdo lëndë është e shoqëruar me një syllabus të detajuar[67] , që përfshin numrin e krediteve, rezultatet e të nxënit, mënyrën e vlerësimit dhe ngarkesën e përgjithshme studentore në përputhje me ECTS. Për më tepër, ndryshimet në kurrikulë për vitet akademike përkatëse janë të dokumentuara dhe të miratuara në përputhje me procedurat institucionale[68]. |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. | Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznesi (BaAB) ka të përcaktuara qartë ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe kërkesat e Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS).<br><br>Sipas Rregullores së programit[69] dhe strukturës së kurrikulës [70], praktika profesionale zhvillohet në semestrin e gjashtë dhe ka një vlerë prej 15 ECTS, ndërsa punimi i diplomës, si detyrim përmbyllës i studimeve, mbart 6 ECTS.<br><br>Ky përcaktim pasqyron përmbushjen e plotë të kriterit ligjor për ngarkesën përfundimtare të programit dhe është i dokumentuar përmes syllabuseve përkatëse, ku specifikohen qëllimet e praktikës, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mënyrat e vlerësimit[71].<br><br>Praktika profesionale në TBU është konceptuar jo vetëm si detyrim akademik, por si pjesë integrale e filozofisë së institucionit për të kombinuar formimin teorik me përvojën praktike. Studentët përfitojnë nga marrëveshje bashkëpunimi me kompani të ndryshme[72], përfshirë edhe ato të grupit BALFIN, që ofrojnë mundësi reale për trajnime, internship-e dhe punësim, duke reflektuar sloganin e institucionit: "Ku studimi sjell punësim".<br><br>Ngarkesa e përcaktuar në kredite për këto komponentë përmbyllës garanton konsistencë akademike, përgatitje profesionale dhe respektim të standardeve kombëtare dhe evropiane për programet e ciklit të parë. |
| Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat | Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznesi (BaAB) në Tirana Business University (TBU) organizohet dhe funksionon në përputhje të plotë me Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe me |

[66] 16.1Kurrikula e programit Ba "Administrim Biznesi"(shqip); 16.3. Plani mësimor i programit të studimit Ba"Administrim Biznesi "(shqip); 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarise formuese -Ba "Administrim Biznesi"

[67] 22.Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit – BaAB (shqip & anglisht)

[68] 16.6.Shkresa TBUNr.45,dt.27.03.2025 Per ndryshimin ne kurrikulat e programeve te studimit te TBU 25-26 (ndryshim brenda 20%); 16.7. Shkresa e MAS, Nr. 2109/3, Dt. 06/05/2025 per konfirmimin e ndryshimeve

[69] 9. Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi ( shqip).

[70] 16.1Kurrikula e programit Ba "Administrim Biznesi"(shqip)

[71] 22.Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit – BaAB (shqip & anglisht)

[72] 37.3.Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & biznese në lidhje me programet e studimit (BaAB)

| | |
|---|---|
| përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit që rregullojnë veçoritë e institucioneve me status të veçantë.<br><br>Forma e organizimit të studimeve në programin BaAB respekton parimet themelore të autonomisë akademike dhe rregullat për ndarjen e ngarkesës mësimore sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS), në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.01.2018[73].<br><br>Programi është i akredituar dhe ofrohet nga një institucion që operon me status të veçantë, i njohur me vendim të Këshillit të Ministrave dhe i licencuar sipas procedurave të MAS.<br><br>Pranimi i studentëve në programin BaAB realizohet në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Udhëzimi Nr. 1, datë 23.01.2020, të MAS, mbi rregullat e pranimit në institucionet e arsimit të lartë jo publik dhe procedurat për regjistrim nëpërmjet sistemit të U-Albania. Politikat e pranimit, si dhe kriteret specifike për përzgjedhjen e kandidatëve, janë të përcaktuara në rregulloren e përgjithshme të TBU[74] .<br><br>Financimi i programit dhe mënyra e mbulimit të kostove të studimeve bëhet në bazë të kuotave të miratuara nga MAS dhe politikave të brendshme të institucionit, të cilat i nënshtrohen transparencës dhe publikohen rregullisht për çdo vit akademik. Këto kuota janë të detajuara në vendimet për tarifat e studimit dhe paketën informative për studentët[75].<br><br>Studentët përfitojnë gjithashtu bursa ose lehtësira bazuar në rezultate akademike ose status social, në përputhje me politikat e TBU dhe dispozitat ligjore në fuqi[76]. |
| **Kriteri 6.** Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. | Ky kriter parashikohet në Pikën 6, Neni 86: "Kodifikimi i programeve të studimit", të Ligjit 80/2015. Në zbatim të Nenit 86, Këshilli i Ministrave dhe Ministria përgjegjëse për arsimin kanë hartuar aktet nënligjore përkatëse dhe në bashkëpunim me Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH, ka finalizuar procesin e kodifikimit të programeve bazuar në ISCED-F 2013. Si rezultat i këtij procesi, vihet në zbatim kriteri ligjor që lidhet me përafrimin e programeve të fushave të ngjashme me të njëjtën emërtesë, duke patur si element dallues kodin përkatës (shiko kriterin 8 më poshtë). Por nga ana tjeter, edhe në ndërtimin e programit, apo në përmirësimin e tij, Departamenti i Biznesit dhe Financës mbështetet vazhdimisht në programe të ngashme, të institucioneve të ngjashme, brenda dhe jashtë vendit[77]. |

[73] 67.VKM Nr.41, datë 24.01.2018 Për elementet e programeve të studimit e ndryshuar.
[74] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"
[75] 61.1. Vendim për tarifat dhe bursat e studentëve për vitin 24-25; 61.2. Tarifat dhe bursat VA 2024-2025.
[76] 61.6. Skema e bursave sociale në TBU; 61.4. Kontratë dhurimi Mane Foundation dt.9.11.23; 61.5. Kontratë dhurimi Mane Foundation_TBU studenti Klejvi Pero 24-25
[77] 69.1. VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 Kodifikimi programeve qbz; 69.2. Ministria e Arsimit "Për afatet e kodifikimit të programeve të Studimit ofruar nga institucionet e Arsimit të Lartë"nr.prot.295 ,dt 16.01.2023; 69.3 Udhezim-Nr.31-date-15.11.2022-Kodifikimi-i-programeve-te-studimit-IAL-pdf; 69.4. Korrespondenca me MAS mbi kodifikimin e programeve te studimit; 69.5 Shkresa e MAS Nr. 7381/22, dt. 30.12.2024 për "Konfimimin e kodeve te programeve të studimit në Kolegjin Universitar Tirana Business University.

| | |
|---|---|
| **Kriteri 7.** Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. | Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznesi (BaAB) në TBU është i pajisur me kodin përkatës të fushës së studimit, në përputhje me klasifikimet dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, të përcaktuara në VKM nr. 310, datë 11.05.2022 dhe Udhëzimin nr. 31, datë 15.11.2022. Kodi i programit është përcaktuar në bazë të fushës "Ekonomi, Biznes dhe Administrim", që përkon me profilin akademik dhe përmbajtjen tematike të programit.<br><br>Ky kodifikim është i dokumentuar përmes shkresës zyrtare të MAS për njohjen e kodeve të programeve të ofruara në TBU[78], me kodet përkatëse 63BA0413S (profili Menaxhim), 63BA0414S (profili Marketing), 63BA0412S (profili Kontabilitet &Financë), si dhe të pasqyruar në dokumentet bazë të programit – përfshirë rregulloren, kurrikulën, broshurën informuese, dhe vendimet për miratimin e planit mësimor.<br><br>Më tej, në nivelin e brendshëm të programit, është zbatuar edhe kodifikimi i lëndëve, i cili i shoqëron të gjitha komponentët e planit mësimor sipas një sistemi të standardizuar brenda institucionit. Çdo lëndë e programit ka të përcaktuar kodin e vet unik, që reflektohet në syllabusin përkatës[79], në regjistrimet e lëndëve në sistemin akademik, si dhe në dokumentet e studentëve dhe transkriptet e notave.<br><br>Ky proces i dyfishtë i kodifikimit – në nivel të programit dhe të lëndëve – siguron transparencë akademike, identifikim të saktë të përmbajtjes dhe krahasueshmëri me institucionet e tjera, në përputhje me standardet kombëtare dhe praktikat më të mira të arsimit të lartë. |
| **Kriteri 8.** Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. | Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznesi (BaAB) në Tirana Business University (TBU) aktualisht nuk është një program i përbashkët studimi në kuptimin e bashkëpronësisë akademike dhe lëshimit të diplomës së përbashkët me institucione të tjera të arsimit të lartë, siç parashikohet në Ligjin nr. 80/2015 për arsimin e lartë dhe aktet përkatëse nënligjore.<br><br>Megjithatë, TBU ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë, kombëtare dhe ndërkombëtare[80], të cilat përfshijnë mobilitet të studentëve dhe stafit, shkëmbim përvoje akademike, si dhe pjesëmarrje në projekte të përbashkëta në kuadër të programeve si Erasmus+ dhe nisma të tjera ndërkombëtare. Këto marrëveshje përbëjnë një bazë të qëndrueshme bashkëpunimi akademik, dhe krijojnë terren të favorshëm për zhvillimin e mundshëm të programeve të përbashkëta në të ardhmen.<br><br>TBU është e hapur për të realizuar programe të përbashkëta studimi me një ose disa institucione të arsimit të lartë, publike ose jopublike, brenda ose jashtë |

[78] 69.5. Shkresa e MAS Nr. 738122, dt. 30.12.2024 për Konfimimin e kodeve te programeve të studimit në Kolegjin Universitar Tirana Business University; 69.4. Korrespondenca me MAS mbi kodifikimin e programeve te studimit; 69.3.Udhezim-Nr.31-date-15.11.2022-Kodifikimi-i-programeve-te-studimit-IAL-pdf
[79] 22.Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit – BaAB (shqip & anglisht)
[80] 47.3. Raporti në lidhje me mobilitetet e stafit dhe studentëve

| | |
|---|---|
| | vendit, në përputhje me kuadrin ligjor. Kjo qasje është në përputhje të plotë me Strategjinë e Zhvillimit të TBU 2024–2029[81], në të cilën theksohet ndërkombëtarizimi si një nga shtyllat kryesore për zhvillimin e mëtejshëm institucional dhe akademik. Në strategji parashikohet zgjerimi i bashkëpunimeve me universitete partnere me synimin për të ofruar, në faza të mëvonshme, edhe programe të përbashkëta ose të dyfishta studimi, veçanërisht në fushat prioritare të institucionit. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. | Fakulteti i Biznesit dhe Drejtësisë në TBU, si njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi (BaAB), përmbush plotësisht detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e njësive akademike në institucionet e arsimit të lartë, sipas kërkesave të Ligjit nr. 80/2015 dhe akteve nënligjore përkatëse.<br><br>Në përbërje të FBD-së janë tre njësi bazë:<br><br>• **Departamenti i Biznesit dhe Financës**, përgjegjës për administrimin dhe zhvillimin e programit BaAB,<br>• **Departamenti i Drejtesise** , dhe<br>• **Qendra per Kerkime e Studime Ekonomike dhe Juridike-QKSEJ.**<br><br>Struktura akademike e njësisë është e organizuar në përputhje me Vendimin e Senatit për riorganizimin e njësive[82] dhe strukturën organizative të miratuar nga TBU[83], ku përfshihet Departamenti i Biznesit dhe Financës si njësi bazë përgjegjëse për zhvillimin dhe mbikëqyrjen e programit BaAB.<br><br>Statuti i TBU[84] dhe Rregulloret përkatëse të Kolegjit, Fakultetit dhe Departamentit[85] përshkruajnë qartë kompetencat e secilës njësi dhe mënyrën e funksionimit të tyre në përputhje me kuadrin ligjor.<br><br>Stafi akademik që mbulon programin plotëson kërkesat e përcaktuara në ligj dhe standardet e akreditimit, duke përfshirë përqindjen e pedagogëve me gradë shkencore, tituj akademikë dhe eksperiencë profesionale në fushën |

[81] 3.1. Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029
[82] 2.1.1. Vendim Senati 7 dt.28.09. 2022 per riorganizmin e Fakulteteve FAB dhe FD
[83] 2.2. Struktura Organizative TBU
[84] 2.Statuti TBU
[85] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"; 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit dhe 7. Drejtësisë; Rregullore e Departamentit të Biznesit dhe Financës (FBD)

| | |
|---|---|
| | përkatëse[86]. Struktura e stafit është e pasqyruar në tabelat e përbërjes dhe ngarkesës mësimore, si dhe në CV-të[87] dhe kontratat e stafit, të cilat dëshmojnë për kualifikimet e nevojshme sipas ligjit.<br><br>Njësia kryesore realizon rregullisht procesin e vetëvlerësimit dhe përgatit dokumentacionin për akreditim[88], në bashkëpunim me strukturat institucionale të sigurimit të cilësisë, siç dëshmohet në raportet vjetore të departamentit dhe të fakultetit dhe planifikimet përkatëse të punës.<br><br>Po ashtu, merr pjesë aktivisht në procedurat e monitorimit të brendshëm të cilësisë , në përputhje me standardet e ASCAL dhe kërkesat e MAS[89]. |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. | Fakulteti i Biznesit dhe Drejtësisë, nëpërmjet Departamentit të Biznesit dhe Financës, përmbush detyrimet ligjore për angazhimin e personelit ndihmës akademik dhe administrativ në funksion të praktikave profesionale.<br><br>Në fillim të çdo viti akademik, përgjegjësi i departamentit propozon emrat e drejtuesve të praktikave dhe planin për realizimin e tyre në bashkëpunim me kompani, OJF dhe institucione të tjera pritëse, në përputhje me strukturën dhe objektivat e programit[90]<br><br>Procesi mbikëqyret nga pedagogu përgjegjës[91] dhe mbështetet nga strukturat ndihmëse, ndërsa përmbajtja dhe procedurat për realizimin e praktikës janë të rregulluara në Rregulloren e Praktikës Mësimore[92]. Po ashtu, në rregulloren e departamentit është përcaktuar qartë angazhimi për bashkëpunim me organizata për mbështetjen e praktikave dhe punësimin e studentëve[93].<br><br>Ky organizim siguron realizimin cilësor të praktikës dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe akademike të programit. |
| Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | Departamenti i Biznesit dhe Financës, si njësi bazë përgjegjëse për programin Bachelor në Administrim Biznesi (BaAB) në TBU, ka caktuar një koordinator programi, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe rregulloret e brendshme të institucionit.<br><br>Koordinatori i programit emërohet me vendim të Dekanit, me propozim të përgjegjësit të departamentit, dhe ka një rol kyç në mbikëqyrjen e zbatimit të programit, monitorimin e cilësisë së lëndëve, bashkëpunimin me stafin |

[86] 24. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse (Aneks Tabela no.1 & 2 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB ); 25.Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit BaAB për 3 vite 21-24 (Aneks Tabela 6,12,7,8 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB)
[87] 22. CV e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit
[88] 70. Vendim BA-ASCAL nr. 33. dt. 22.04.2022
[89] 53.Shkresa për akreditimin e programeve BaAB në ASCAL
[90] 37.3.Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & biznese në lidhje me programet e studimit (BaAB)
[91] 37.5. Vendimet për përcaktimin e Pedagogut-pedagogëvve Udhëheqës për Praktikat Mësimore për vitin 24-25 FBD
[92] 37. Rregullore e praktikës mësimore & dokumentat përkatëse
[93] 7. Rregullore e Departamentit të Biznesit dhe Financës (FBD)

| | |
|---|---|
| | pedagogjik dhe studentët, si dhe në ndjekjen e praktikave profesionale dhe përmbushjen e objektivave të programit[94].<br><br>Funksionet e koordinatorit janë të përshkruara në rregulloren e departamentit dhe në përgjegjësitë funksionale të personelit akademik, duke përfshirë: koordinimin e zhvillimit të planit mësimor, vlerësimin e zbatueshmërisë së kurrikulës, adresimin e problematikave akademike dhe administrative, si dhe komunikimin me strukturat e tjera institucionale, përfshirë zyrat e mbështetjes studentore dhe praktikat<br><br>Gjithashtu, Dekani i Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë përcakton edhe personat përgjegjës për zhvillimin e praktikave mësimore të studentëve[95] |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi II.3<br>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. | Departamenti i Biznesit dhe Financës, si njësi bazë përgjegjëse për programin Bachelor në Administrim Biznesi (BaAB), disponon të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet institucionale.<br><br>Ky informacion është i dokumentuar në formën e:<br><br>• Rregullores së programit[96], që përcakton objektivat, mënyrën e realizimit dhe detyrimet për përfundimin e studimeve;<br>• Kurrikulës dhe planit mësimor për secilin profil[97], ku paraqiten veprimtaritë formuese, shpërndarja e krediteve sipas kategorive A–E dhe strukturimi sipas viteve akademike;<br>• Syllabuseve të lëndëve[98], ku përshkruhen përmbajtjet tematike, objektivat mësimorë, rezultatet e të nxënit dhe ngarkesa në ECTS;<br>• Strategjisë së zhvillimit të programit dhe analizave vjetore të zbatimit[99], të hartuara nga departamenti për qëllime vetëvlerësimi dhe përmirësimi të vazhdueshëm.<br><br>Gjithashtu, informacioni mbi organizimin e programit është i publikuar dhe i aksesueshëm për studentët dhe aktorët e tjerë përmes faqes zyrtare të TBU, |

---

[94] 39. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit Ba AB
[95] 37.5. Vendimet për përcaktimin e Pedagogut-pedagogëvve Udhëheqës për Praktikat Mësimore për vitin 24-25 FBD.
[96] 9. Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi (shqip)
[97] 16.1.Kurrikula e programit Ba "Administrim Biznesi"(shqip); 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarise formuese -Ba "Administrim Biznesi"
[98] 22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit – BaAB (shqip & anglisht)
[99] 54.2. Raporti vjetor i DBF 23-24



TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| | broshurave informuese dhe platformave të komunikimit akademik të institucionit. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. | Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznesi (BaAB) në TBU shoqërohet me një plan mësimor të strukturuar në mënyrë të qartë, të ndarë sipas semestrave dhe të përshtatur për secilin nga tre profilet: Menaxhim, Marketing dhe Kontabilitet-Financë. Çdo profil përmban lëndë specifike që pasqyrojnë objektivat formues dhe kompetencat profesionale të fushës përkatëse, duke siguruar specializim të thelluar në vitet e fundit të studimit dhe orientim të qartë drejt tregut të punë.<br><br>Plani mësimor përcakton qartë strukturohet e lëndëve, shpërndarjen e tyre sipas kategorive A–E, si dhe ngarkesën përkatëse në kredite ECTS, në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.01.2018 dhe kërkesat e Sistemit Evropian të Krediteve. Për çdo lëndë, plani përmban të dhëna të plota mbi numrin e orëve në auditor dhe jashtë tij, si dhe përcaktime mbi ngarkesën mësimore totale dhe vendin e saj në strukturën e programit. Ky informacion është i dokumentuar në kurrikulën dhe planin mësimor për çdo profil[100] , si dhe i reflektuar në syllabuset përkatëse[101], duke garantuar transparencë dhe ndjekje të qartë të objektivave formuese.<br><br>Kjo strukturë ndihmon në monitorimin akademik, planifikimin e ngarkesës së studentit dhe ofron bazën për krahasueshmërinë me programe të ngjashme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Programi BaAB ofrohet me tre drejtime profilizuese: Menaxhim, Marketing dhe Kontabilitet-Financë, përmban të gjithë informacionin e nevojshëm për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, të cilat janë të përcaktuara në Rregulloren e përgjithshme të TBU-së[102], si dhe në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi[103].<br><br>Në këto dokumente janë të specifikuara qartë kriteret për pranimin në vitin e parë, për pranimet me transferim nga institucione të tjera, si dhe për ekuivalentimin e lëndëve dhe krediteve të mëparshme, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe legjislacionin në fuqi. Konkretisht, në rregulloren e programit përcaktohet se në këtë program studimi pranohen:<br><br>• Kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë dhe kanë përmbushur kriteret për regjistrim nëpërmjet platformës U-Albania; |

[100] 16.1.Kurrikula e programit Ba "Administrim Biznesi"(shqip); 16.3. Plani mësimor i programit të studimit Ba"Administrim Biznesi "(shqip).
[101] 22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit – BaAB (shqip & anglisht)
[102] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"
[103] 9. Rregullore e programit të studimit Bachelor në "Administrim Biznesi (shqip)



TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| | • Studentë të transferuar nga institucione të tjera të arsimit të lartë, publik ose jopublik, brenda ose jashtë vendit, sipas procedurave të brendshme të TBU-së;<br><br>Procedurat për transferimet dhe njohjen e krediteve realizohen nga Zyra e Çështjeve Studentore, në bashkëpunim me departamentin përkatës, përmes analizës së dokumentacionit dhe përmbajtjes së lëndëve. Vendimet për ekuivalentimet janë të dokumentuara dhe sigurojnë transparencë, objektivitet dhe trajtim të barabartë për të gjithë aplikantët. |
| Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznesi (BaAB) përmban të gjitha informacionet e nevojshme lidhur me programet lëndore (syllabuset), të cilat janë hartuar në përputhje me formatin zyrtar të miratuar sipas kërkesave të VKM nr. 41, datë 24.01.2018 (e ndryshuar).<br><br>Çdo syllabus përfshin:<br><br>• Pasqyrën informative të lëndës,<br>• Objektivat e të nxënit dhe rezultatet e pritshme,<br>• Temat javore të detajuara,<br>• Komponentët e vlerësimit (kontroll i vazhdueshëm, pjesëmarrje, detyra dhe provime),<br>• Ngarkesën në auditor dhe jashtë auditorit,<br>• Format e realizimit të praktikave, seminareve apo orëve aplikative,<br>• si dhe literaturën bazë dhe atë plotësuese për çdo temë.<br><br>Syllabuset janë pjesë integrale e strukturës së programit dhe pasqyrojnë të gjitha komponentët formues të nevojshëm për zhvillimin e kompetencave akademike dhe praktike të studentëve[104]. Këto dokumente janë të unifikuara dhe të standardizuara për të gjitha lëndët e programit, duke garantuar transparencë dhe koherencë në përmbajtjen mësimore. |
| **Kriteri 5.** Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. | Para fillimit të çdo viti akademik njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi (në bashkëpunim edhe me Departamentin e Drejtësisë që lidhet me të në lidhje me profilin E drejtë Biznesi) bëjnë propozimin për planet mësimore që do të zbatohen për atë vit akademik, duke bërë propozime konkrete për ndryshime, përmirësime apo përditësime. Këto ndryshime kanë të bëjnë me shtesë lëndësh të reja për t'ju përshtatur kërkesave të tregut të punes për njohuri dhe aftësim, kombinime lëndësh, që i shërbejnë më mirë formimit të studentëve, etj.<br><br>Departamenti propozon ndryshimet në kurrikulë dhe Zyra e Kurrikulave shqyrton propozimin nëse përmbush kriteret ligjore. Më pas propozimi kalohet në dekanat dhe miratohet në Senatin Akademik, si hallka fundore e procesit[105]. I gjithë procesi, duke filluar nga propozimi i njësisë bazë e deri në |

[104] 22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit – BaAB (shqip & anglisht), 23. Formati i Syllabusit (shqip-anglisht) – VKM 412018.

[105] 2. Statuti i TBU, neni 14; 6. Rregullore e Fakultetit te Biznesit dhe Drejtesise, Neni 10 & 7. Rregullore e Departamentit të Biznesit dhe Financës, Neni 4.

| | |
|---|---|
| | vendimmarjen përfundimtare nga Senati është i dokumentuar dhe arkivohet pranë departamentit përgjegjës për programin e studimit.[106] |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi II.4<br>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznesi (BaAB) në TBU është konceptuar dhe organizuar në mënyrë të tillë që të përmbushë objektivat e thellimit të njohurive teorike dhe zhvillimit të aftësive praktike të studentëve, në funksion të punësimit dhe vijimit të studimeve të mëtejshme.<br><br>Struktura e programit është ndërtuar mbi pesë kategori veprimtarish formuese (A–E), në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.01.2018 (e ndryshuar)[107], duke përfshirë:<br>• lëndë të formimit të përgjithshëm (A),<br>• lëndë karakterizuese të fushës (B),<br>• lëndë ndërdisiplinare/integruese ose profilizuese (C),<br>• lëndë plotësuese (D),<br>• si dhe detyrime përmbyllëse – praktikën profesionale dhe punimin e diplomës (E).<br><br>Plani mësimor dhe kurrikulat përkatëse për secilin profil[108] janë hartuar në mënyrë që të ndërthurin përmbajtjen teorike dhe praktike, të zhvillojnë kompetenca të transferueshme, dhe të orientojnë studentin drejt aftësimit profesional në fushat e Kontabilitet-Financës, Menaxhimit dhe Marketingut.<br><br>Gjatë viteve të para të studimeve, studentët marrin njohuri themelore dhe të përgjithshme në fushën e administrimit të biznesit, duke krijuar një bazë të fortë konceptuale dhe metodologjike. Në vitin e tretë, përmes lëndëve karakterizuese dhe atyre profilizuese, studentët thellojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre në drejtimin e përzgjedhur, duke u specializuar në njërin prej tre profileve: Menaxhim, Marketing ose Kontabilitet-Financë. Çdo profil ofron lëndë specifike që adresojnë thellësisht çështjet dhe praktikat kryesore të asaj |

[106] 16.6.Shkresa TBUNr.45,dt.27.03.2025 Per ndryshimin ne kurrikulat e programeve te studimit te TBU 25-26 (ndryshim brenda 20%); 16.7. Shkresa e MAS, Nr. 2109/3, Dt. 06/05/2025 per konfirmimin e ndryshimeve; Ndryshimet e kurrikulës BaAB (Aneks Tabela 11)

[107] 67.VKM Nr.41, datë 24.01.2018 Për elementet e programeve të studimit e ndryshuar; 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarise formuese -Ba "Administrim Biznesi".

[108] 16.1.Kurrikula e programit Ba "Administrim Biznesi"(shqip); 16.3. Plani mësimor i programit të studimit Ba"Administrim Biznesi "(shqip); 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarise formuese -Ba "Administrim Biznesi".

| | |
|---|---|
| | fushe. Praktika profesionale zhvillohet në vitin e tretë, dhe shoqërohet me punimin e diplomës, si detyrim përmbyllës i programit[109]<br><br>Kjo strukturë synon që studentët të aftësohen për tregun e punës gjatë apo menjëherë pas përfundimit të studimeve, si dhe të jenë të përgatitur për të ndjekur cikle më të larta të studimit. Ndërlidhja e fortë me biznesin (përmes bashkëpunimeve dhe rrjetit të kompanive partnere të TBU-së[110] mbështet objektivin e institucionit për të qenë një hapësirë ku studimi sjell punësim. |
| Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit. | Organizimi dhe përmbajtja e këtij programi është konceptuar në funksion të arritjes së objektivave formues të programit dhe zhvillimit të kompetencave të nevojshme për tregun e punës. Programi Bachelor në Administrim Biznesi ofrohet me tre profile të specializuara: Menaxhim, Marketing dhe Kontabilitet-Financë, ku përmes strukturës së tij akademike synohet pajisja e studentëve me njohuri të thelluara teorike dhe aftësi praktike të përshtatura sipas fushës së zgjedhur. Çdo profil përmban lëndë specifike që pasqyrojnë kërkesat profesionale të tregut, duke garantuar përgatitjen e studentëve për pozicione të ndryshme menaxheriale, analitike apo operacionale në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.<br><br>Shpërndarja e lëndëve në gjashtë semestra, përkatësisht përgjatë tre viteve akademike, është ndërtuar në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.01.2018 (e ndryshuar) dhe është reflektuar në planin mësimor dhe kurrikulën e programit[111]. Lëndët janë të organizuara sipas pesë kategorive A–E dhe përfshijnë komponentë teorikë dhe praktikë, me ngarkesë të përcaktuar qartë në kredite dhe orë mësimore, brenda dhe jashtë auditorit.<br><br>Syllabuset e lëndëve[112] përmbajnë objektivat e të nxënit dhe strukturën e vlerësimit, e cila përfshin:<br>– pjesëmarrjen aktive në auditor,<br>– detyra ose projekte gjatë semestrit,<br>– provimin e ndërmjetëm,<br>– dhe provimin përfundimtar,<br>duke mundësuar vlerësim të kombinuar të dijes, angazhimit dhe përparimit të studentit gjatë gjithë procesit mësimor.<br><br>Rezultatet e arritura për përmbushjen e objektivave formuese të programit të studimit Bachelor si në terma të mësimnxënies dhe atë të aftësimit profesional dhe punësimit të studentëve, evidentohen edhe në raportin të analizës periodike nga ana e departamentit përgjegjës[113]. |
| Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të | Programi ofrohet në tre profile të specializuara: Menaxhim, Marketing dhe Kontabilitet-Financë, ku çdo profil përmban lëndë specifike të fushës |

[109] 37. Rregullore e praktikës mësimore & dokumentat përkatëse

[110] 37.4. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit; 37.3 Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & biznese në lidhje me programet e studimit (BaAB)

[111] 16.1 Kurrikula e programit Ba "Administrim Biznesi"(shqip); 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarise formuese -Ba "Administrim Biznesi"

[112] 22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit – BaAB (shqip & anglisht)

[113] 41.Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit BaAB



TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. | përkatëse, të ndërtuara për të reflektuar kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimet bashkëkohore të disiplinës. Raporti mes përmbajtjes teorike dhe përvojës praktike është projektuar në mënyrë që studentët të marrin njohuri të thelluara konceptuale dhe të zhvillojnë njëkohësisht kompetenca të zbatueshme në mjediset reale të punës. Kjo reflektohet në:<br>• kombinimin e lëndëve karakterizuese dhe profilizuese me lëndët ndërdisiplinare dhe ato plotësuese[114]<br>• përfshirjen e praktikës profesionale dhe punimit të diplomës në semestrin e fundit[115]<br>• dhe në vlerësimin e vazhdueshëm të aftësive përmes detyrave praktike, projekteve dhe angazhimit të drejtpërdrejtë të studentëve me biznese partnere .<br><br>Struktura e programit është ndërtuar në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.01.2018 (e ndryshuar)[116] dhe është e krahasueshme me programe homologe të universiteteve evropiane, siç evidentohet në analizën e përputhshmërisë së kurrikulës dhe komponentëve të saj me programet ndërkombëtare të menaxhimit dhe administrimit të biznesit.<br><br>Kjo përputhje i jep programit vlerë krahasuese dhe njohje akademike, duke i mundësuar studentëve mobilitet horizontal apo vertikal, si dhe integrim më të lehtë në tregun ndërkombëtar të punës. |
| **Kriteri 4.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Forma dhe ndarja e veprimtarive formuese në programin Bachelor në Administrim Biznesi (BaAB) është ndërtuar në mënyrë që të garantojë një kombinim të balancuar të formimit teorik me aftësimin praktik, duke kontribuar drejtpërdrejt në përmbushjen e objektivave të programit dhe në përgatitjen e studentëve për tregun e punës dhe studimet e mëtejshme.<br><br>Struktura fleksibël e programit, e ndarë sipas kategorive A–E, siguron shpërndarje funksionale të lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinare dhe me zgjedhje, duke ofruar mundësi për profilizim dhe përshtatje të planit të studimeve sipas interesave akademike të studentëve. Ky fleksibilitet lehtëson gjithashtu transferimin e studimeve drejt apo nga TBU, në përputhje me rregulloret e brendshme dhe udhëzimet ligjore në fuqi[117].<br><br>Gjatë gjithë ciklit të studimeve, veçanërisht në vitin e fundit përmes praktikës profesionale dhe punimit të diplomës[118], studentët përgatiten për të hyrë në tregun e punës ose për të ndjekur studime në ciklin e dytë. Përmbajtja e programit dhe rezultatet e të nxënit janë të ndërtuara në funksion të punësimit të qëndrueshëm, zhvillimit të karrierës dhe mobilitetit[119] akademik |

114 16.1.Kurrikula e programit Ba "Administrim Biznesi"(shqip); 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarisë formuese -Ba "Administrim Biznesi".
115 37.Rregullore e praktikës mësimore & dokumentat përkatëse
116 67.VKM Nr.41, datë 24.01.2018 Për elementet e programeve të studimit e ndryshuar
117 33. Rregullore për Transferimin e studimeve
118 37. Rregullore e praktikës mësimore & dokumentat përkatëse
119 47.3. Raporti në lidhje me mobilitetet e stafit dhe studentëve

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| | ndërkombëtar, që përkrahet gjithashtu nga marrëveshjet e bashkëpunimit me universitete partnere dhe biznese[120] |
| **Kriteri 5.** Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit. | Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznesi (BaAB) në TBU siguron përditësimin e vazhdueshëm të syllabuseve të lëndëve/modulëve, në funksion të përputhjes me zhvillimet bashkëkohore të fushës dhe kërkesave të tregut të punës. Përditësimi realizohet çdo vit akademik, nëpërmjet propozimeve të Departamentit të Biznesit dhe Financës dhe shqyrtimit nga Zyra e Kurrikulave, me synimin për të përfshirë kompetenca të reja, qasje aplikative dhe literaturë të përditësuar. Kjo literaturë përfshin tekste bashkëkohore të autorëve ndërkombëtarë dhe burime praktike që ndihmojnë studentët të ndërtojnë një bazë të fortë njohurish dhe aftësish të transferueshme[121]. Ky proces i vazhdueshëm përmirësimi, i dokumentuar në raportet e analizës së programit nga departamenti përkatës[122] siguron që përmbajtja e programit të mbetet e përditësuar, relevante dhe e orientuar drejt punësimit dhe vijimit të studimeve në cikle të mëtejshme.<br><br>Përgjegjësit e grup-lëndëve dhe departamenti përkatës (Departamenti i Biznesit dhe Financës)[123] kryejnë kontroll të rregullt të syllabus në fillim të çdo semestri. Institucioni u kërkon pedagogëve përditësim periodik, duke vënë theksin te përfshirja e literaturës së viteve të fundit, si dhe e temave që pasqyrojnë zhvillimet më të reja të tregut të punës. Edhe pse në disa raste mund të evidentohet mungesë literature të re në disa fusha të veçanta, TBU ka ndërmarrë hapa për të lehtësuar përditësimin e literaturës përmes kërkesave të drejtpërdrejta nga stafi akademik dhe procedurës së blerjes së literaturës nga institucionet partnere. |
| **Kriteri 6.** Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. | Përmbajtja e këtij programi studimi në TBU është konceptuar për të garantuar përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave që synohen në përputhje me profilin akademik dhe profesional të programit, si dhe me kërkesat reale të tregut të punës.<br><br>Programi ofron një formim të plotë teorik dhe praktik, duke përfshirë lëndë bazë të fushës së administrimit dhe biznesit, lëndë profilizuese sipas specializimeve (Kontabilitet-Financë, Menaxhim, Marketing), si dhe një përmbajtje të pasur me shembuj konkretë, analiza tregu dhe raste studimore nga konteksti shqiptar dhe ndërkombëtar. Kjo i pajis studentët me njohuri të zbatueshme, si dhe me aftësi analitike e praktike të domosdoshme për zgjidhjen e problemeve reale në mjedisin e biznesit.<br><br>Në funksion të profilizimeve që ofron, programi Bachelor në Administrim Biznesi synon zhvillimin e një game të gjerë kompetencash profesionale të përshtatura me secilin drejtim. **Profili i Menaxhimit** synon të pajisë studentët me aftësi të avancuara në organizimin dhe drejtimin e burimeve njerëzore, |

[120] 46. Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit (Aneks Tabela 20
[121] 22.Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit – BaAB (shqip & anglisht)
[122] 54.2. Raporti vjetor i DBF 23-24
[123] 40.Formati i relacionit për monitorimin e syllabuseve



TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| | menaxhimin e proceseve operacionale, vendimmarrjen strategjike dhe menaxhimin e projekteve, në përputhje me nevojat e organizatave moderne. **Profili i Marketingut** fokusohet në zhvillimin e aftësive për analizën e tregut, ndërtimin e strategjive promovuese, menaxhimin e markës dhe digjitalizimin e komunikimit me klientin. Studentët në këtë drejtim formohen për të kuptuar sjelljen e konsumatorit dhe për të përdorur mjetet moderne të marketingut për të krijuar vlerë në treg. Ndërsa **profili i Kontabilitet-Financës** thekson përgatitjen e studentëve në përpunimin e të dhënave financiare, raportimin financiar sipas standardeve ndërkombëtare, planifikimin fiskal dhe analizën financiare për vendimmarrje. Këto kompetenca, të mbështetura në një bazë të fortë teorike dhe të përforcuara nga praktika profesionale, i bëjnë studentët të aftë të operojnë në pozicione kyçe në institucione publike dhe private, brenda dhe jashtë vendit.<br><br>Një veçanti e programit është ndërlidhja e ngushtë me tregun e punës, përmes praktikës profesionale që zhvillohet në vitin e tretë, si dhe bashkëpunimit të TBU me kompani të rëndësishme vendase e të huaja, përfshirë bizneset pjesë të grupit BALFIN[124] Ky rrjetëzim institucional siguron jo vetëm mundësi reale punësimi gjatë ose pas studimeve, por edhe zhvillim të karrierës në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | Bazuar në analizat e paraqitura në kriteret e mësipërme të këtij standardi, arrijmë në përfundimin se programi Bachelor në Administrim Biznesi (BaAB) i ofron studentëve njohuri të konsoliduara teorike dhe kompetenca të nevojshme praktike, të cilat përmbushin qëllimin formues të programit dhe i përgatisin ata si për vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë, ashtu edhe për punësim dhe zhvillim të qëndrueshëm profesional.<br><br>Programi krijon një bazë të fortë për ndjekjen e studimeve të mëtejshme, jo vetëm në fushën e administrimit të biznesit, por edhe në fusha të ndërlidhura si financë, menaxhim, drejtësi biznesi apo marketing, brenda dhe jashtë vendit. Në të njëjtën kohë, përmes praktikës profesionale të organizuar në vitin e tretë të programit[125] dhe përfshirjes së TBU në partneritete strategjike me kompani të grupit BALFIN dhe subjekte të tjera të rëndësishme të tregut[126] studentët përfitojnë përgatitje të drejtpërdrejtë për integrim në tregun e punës. Përvoja e tyre gjatë studimeve kontribuon në aftësimin e tyre për pozicione fillestare profesionale si: asistentë menaxherë, specialistë finance, ndihmës kontabilistë, koordinatorë marketingu, apo sipërmarrës të rinj, etj.<br><br>Këto veçori të programit sigurojnë që studentët, pas përfundimit të studimeve, të kenë alternativa reale për:<br><br>• vazhdimin e studimeve në ciklin Master, |

124 37. Rregullore e praktikës mësimore & dokumentat përkatëse; 37.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi( Aneks Tabela 5); 37.3.Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & biznese në lidhje me programet e studimit (BaAB

125 37. Rregullore e praktikës mësimore & dokumentat përkatëse

126 37.4. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit



TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| | • certifikime të mëtejshme profesionale (në fusha si kontabilitet, menaxhim apo analizë financiare),<br>• si dhe punësim të menjëhershëm ose zhvillim karriere në sektorë kyç të ekonomisë. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. | Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznesi (BaAB) në TBU përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme përmes konsultimeve të strukturuara dhe të dokumentuara me aktorë të brendshëm dhe të jashtëm, me qëllim që përmbajtja e tij të reflektojë zhvillimet në tregun e punës dhe të përmbushë objektivat e përcaktuara formuese.<br><br>TBU ndërmerr rishikim vjetor të përmbajtjes së programeve të studimit, proces që fillon para fillimit të çdo viti akademik nga Departamenti i Biznesit dhe Financës në bashkëpunim me Zyrën e Kurrikulave. Në këtë kuadër, organizohen diskutime të brendshme mes stafit akademik dhe, në vijim, zhvillohen takime të strukturuara me përfaqësues të kompanive, OJF-ve dhe institucioneve publike, me qëllim mbledhjen e propozimeve konkrete për përmbajtjen e kurrikulës, praktikën profesionale dhe rezultatet e të nxënit që kërkon tregu[127]. Këto konsultime përfshijnë në mënyrë të veçantë ekspertë dhe menaxherë nga sektorët kryesorë të "Balfin Group", por edhe partnerë të tjerë strategjikë nga fusha të ndryshme të biznesit dhe administrimit.<br><br>Për më tepër, TBU organizon takime periodike me Bordin e Tregut të Punës[128], në përbërje të të cilit janë përfshirë edhe studentë të diplomuar (alumni), me qëllim marrjen e feedback-ut mbi efektivitetin e kurrikulës dhe përshtatshmërinë e saj me tregun e punës.<br><br>Gjithashtu, përmirësimet në përmbajtjen e programit janë ndikuar pozitivisht edhe nga përvoja ndërkombëtare që TBU ka fituar përmes pjesëmarrjes në programet e mobilitetit Erasmus+ dhe bashkëpunimeve me universitete partnere jashtë vendit, duke integruar në kurrikulë praktika evropiane dhe standarde ndërkombëtare.[129] |

[127] 37.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi( Aneks Tabela 5); 37.2. Memorandum TIP_TBU_Subjekt; 37.3.Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & biznese në lidhje me programet e studimit (BaAB)
[128] 14.1. Vendim Dekanati për Bordin e Tregut të Punës FBD; 14.1.1. Axhenda e takimit me BTP 2023-2024
[129] 37.4. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.

| | |
|---|---|
| | Të gjitha këto inpute shqyrtohen në mënyrë të sistematizuar dhe pasqyrohen në raportet e analizës periodike të programit, të cilat dokumentojnë ecurinë e zhvillimit dhe ndikimin e sugjerimeve të marra në përmirësimet e realizuara. |
| **Kriteri 2.** Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. | Në nenin 42 të Statutit të TBU-së theksohet se: *"TBU mirëpret dhe garanton dëgjimin e mendimeve, vërejtjeve dhe propozimeve të këshillave studentorë për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm që lidhen me veprimtarinë mësimore-kërkimore siç janë: planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve... "*[130].<br><br>Në përputhje me këtë parim, studentët aktualë inkurajohen të marrin pjesë aktivisht në mbledhjet e hapura të departamentit, ku kanë mundësi të japin mendime dhe propozime konkrete për përmbajtjen e lëndëve dhe ecurinë e programit[131]. Ky angazhim institucionalizohet edhe përmes përfaqësuesve të tyre në strukturat drejtuese akademike.<br><br>Në të njëjtën linjë, TBU ruan kontakte të rregullta dhe zhvillon konsultime periodike me studentët e diplomuar (alumni), përmes sondazheve, takimeve me rrjetin alumni dhe përfshirjes së tyre në Bordin e Tregut të Punës[132]. Këta të diplomuar konsiderohen si burim i vyer informacioni mbi përputhjen e përgatitjes akademike me realitetin e tregut të punës, dhe sugjerimet e tyre reflektohen në rishikimin e kurrikulës dhe përmirësimin e përmbajtjes së programit. |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private. | Nisur nga fokusi strategjik i TBU në fushën e biznesit dhe administrimit, procesi i përmirësimit dhe përditësimit të programeve të studimit në këtë drejtim, përfshirë programin Bachelor në Administrim Biznesi (BaAB), zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me sektorin privat dhe rrjetet profesionale që lidhen me fushat përkatëse të programit.<br><br>Fakulteti i Biznesit dhe Drejtësisë, si njësi kryesore përgjegjëse për këtë program, ka ndërtuar një rrjet të gjerë partnerësh nga fusha e biznesit dhe administrimit, të cilët kontribuojnë me sugjerime dhe asistencë konkrete në rishikimin, përditësimin dhe përshtatjen e programeve, duke reflektuar nevojat e tregut të punës dhe prioritetet zhvillimore të sektorëve ekonomikë.[133] Këto partneritete nuk kufizohen vetëm në aspektin praktik të punësimit apo praktikës, por përfshijnë edhe bashkëpunimin në përshtatjen dhe riorganizimin e përmbajtjes së kurrikulës, për të siguruar që programi të jetë relevant dhe funksional në një mjedis dinamik biznesi dhe ekonomie. |

[130] 2. Statuti i TBU, neni 42, fq. 20
[131] 36.6.Formati i pyetësorit për vlerësimin e lëndës & pedagogut nga studentët; 36.7. Raporti i Fokus Grupeve
[132] 14.1. Vendim Dekanati për Bordin e Tregut të Punës FBD; 14.1.1. Axhenda e takimit me BTP 2023-2024
[133] 37.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi( Aneks Tabela 5; 37.2. Memorandum TIP_TBU_Subjekt; 37.3.Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & biznese në lidhje me programet e studimit (BaAB).

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Në të njëjtën kohë, TBU ka zgjeruar rrjetin e bashkëpunimeve akademike dhe shkencore me universitete partnere, brenda dhe jashtë vendit, përmes projekteve të mobilitetit si Erasmus+ dhe nismave të tjera ndërkombëtare, duke mundësuar shkëmbim përvojash dhe integrimin e standardeve europiane në përmbajtjen e programit[134]. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

[134] 37.4. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.

# III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton proçesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Në rregulloret përkatëse të TBU-së shprehen qartësisht format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive si: leksione, seminaret për çdo lëndë, ese/detyra e kursit, praktika profesionale, etj.[135] Njëkohësisht në formë më të detajuar edhe në planin mësimor të programit paraqiten veprimtaritë formuese të tij.[136]<br><br>Programi i Studimit Bachelor në Administrim Biznesi për të tre profilet është program i ciklit të Parë me kohëzgjatje normale 3 (tre) vite akademike dhe me 180 kredite (ECTS). Forma e studimit është me kohë të plotë. Programi mësimor është parashikuar të realizohet në 4.500 orë, nga të cilat 1.515 orë janë orë studimi në auditor dhe 2,985 janë orë studimi individual.<br><br>Leksionet dhe seminaret zgjasin për 30 javë mësimore (semestri) dhe deri ne 4 javë të parashikuara për sesionet normale të provimeve,[137] Në fund të semestrit studentët dorëzojnë detyrat e kursit/ esetë në lëndët e zhvilluara. Studenti kryen jo me pak se 4 javë praktike në profilin e studimeve të tij. Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies qartësisht janë të përshtatshme për realizimin e programit të studimit. Kontrolli i dijeve është i vazhdueshëm, përgjatë gjithë semestrit, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të identifikojnë mangësitë dhe t'i plotësojnë ato përpara përfundimit të semestrit. Gjithashtu, në bashkëpunim me tregun e punës, Departamenti ka zhvilluar leksione të hapura me ekspertë të fushës së menaxhimit dhe marketingut.[138] |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. | Format, mënyrat dhe metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies janë të specifikuara në syllabusin e lëndës, i cili ndërtohet në përgjigje të nevojave të lëndës dhe studentëve, dhe përmban rubrika si: "Metoda pedagogjike e përdorur në |

[135] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU; 7. Rregullore e Departamentit te Biznesit dhe Finances; 9. Rregullore e programit të studimit Bachelor "Administrim Biznesi"(shqip); 56. Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies

[136] 16.3. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor "Administrim Biznesi"(shqip);16.5.Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – Bachelor "Adminstrim Biznesi ".

[137] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU; 9. Rregullore e programit të studimit Bachelor "Administrim Biznesi"(shqip).

[138] 19. Studimi për tregun e punës 14.3.Aktivitetet të realizuara nga ZCS për studentët BA; 14.4 Aktivitete bashkëpunime me biznesin për studentët; 54.2 Raporti vjetor i DBF 23-24 fq 18 Lista e Leksioneve te hapura

| | |
|---|---|
| | seminarin e radhës", "Literaturë bazë e detyrueshme", "Literaturë e rekomanduar", etj.[139]<br><br>Në zhvillimin e lëndëve në auditor përdoren gjerësisht edhe mjete ndihmëse si tabela, kompjuter, projektori, etj.[140] Metoda të tjera për t'iu përgjigjur diversitetit përfshijnë diskutime dhe punë në grupe me studentët, analiza e rasteve të studimit, organizimi i diskutimeve që nxisin mendimin kritik, ekspertët e ftuar në auditor, forumet me grupe specialistësh, apo personalitete.[141] |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. | Stafi akademik qëndron gjithnjë i gatshëm për të përqafuar qasjet më të reja të kompetencave didaktike duke ofruar kështu mësimdhënie në nivel bashkëkohor.[142] Gjithashtu, personeli akademik ka mundësi të përfitojë nga programet e shkëmbimit të stafit me universitetet partnere perëndimore, për të shkëmbyer eksperiencë dhe për t'u njohur me praktikat e mira ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijes.[143]<br><br>Një drejtim i rëndësishëm për sigurimin e brendshëm të cilësisë lidhet me trajnimin e pedagogëve, si për freskimin e njohurive të tyre mbi metodikën e mësidhënies. Kujdes më i veçantë i kushtohet trajnimit të pedagogëve të jashtëm, duke vënë theksin në njohjen e specifikave të rregulloreve të TBU-së, si edhe në aspekte metodike dhe të organizimit të mësimit.[144] |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është koBacheloretent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.<br><br>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie përzgjidhet me kujdes. Kështu, Përgjegjësi i Departamentit së bashku me drejtues të tjerë të IAL-së, është i përfshirë si në proçesin e rekrutimit[145] të personelit akademik të njësisë së tij (saj), ashtu edhe në vlerësimin periodik të performancës të personelit akademik të njësisë. Kriteret kryesore mbi të cilat mbështetet vlerësimi/rekrutimi i kandidaturave, janë treguesit e performancës së kandidatëve, si psh. përvoja në mësimdhënie në nivel universitar, karriera profesionale jashtë auditorit, kualifikimet, titujt dhe gradat shkencore, etj.[146] TBU ka një kuadër rregullativ të brendshëm mbi të cilin mbështetet proçesi i punësimit të personelit akademik efektiv dhe me kohë |

[139] 16.1/16.2 Kurrikulat e programit BA "Administrim Biznesi" (shqip & anglisht)
[140] 44. Raporti i MAS për inspektimin e kapaciteteve; 44.2. Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Aneks Tabela 16)
[141] 56. Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies
[142] 56. Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies; 43.3.Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit të programeve të studimit BaAB (Aneks Tabela 19)
[143] 47.3. Raporti ne lidhje me mobilitetet e stafit dhe studenteve
[144] 38.1 Politika për zhvillimin professional të stafit; 38.1.1. Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin; 36.8. Formulari i vleresimit te pedagogut nga eprori-kolegu
[145] 13. Rregullore për punësimin, largimin nga puna dhe vlerësimin e personelit; 13.3. Politika e BNJ ne TBU
[146] 13.2 Politika e BNJ ne TBU; 13.3. Format dosje staf akademik; 13.4 Praktika e rekrutimit te stafit

| | |
|---|---|
| | të pjesshme. Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs.[147]<br><br>Githashtu, metodat e mësimdhënies të përdorura nga stafi akademik, përshkruhen në silabusin e secilës prej lëndëve/moduleve të programit të studimit. Seksioni "Metoda pedagogjike e përdorur në seminarin e radhës", është një element i rëndësishëm në formatin e miratuar për syllabuset[148] e lëndëve të programit të studimit, duke përshkruar materialet për diskutim dhe rastet studimore për secilën prej temave. Në këtë program studimi përdorimi i metodave interaktive dhe diskutimit në mësimdhënie nuk kufizohet vetëm për orët e seminareve, por zgjerohet edhe në orët e leksioneve, ku pedogogët përfshijnë edhe materiale audivizuale, që krijojnë situata diskutimesh, duke mundësuar zhvillimin e leksioneve interaktive, duke i bërë ato më tërheqëse dhe duke i shtuar ndërveprimin gjatë zhvillimit të tyre. Zhvillimi i orëve interaktive, të cilat ndërthurin shpjegimet teoriko-aplikative, duke u fokusuar te ndërveprimi i vazhdueshëm pedagog – student, garantojnë zhvillimin intensiv të proçesit të angazhimit të studentëve. Diskutimet, rastet studimore, puna në grupe dhe prezantimet janë disa nga instrumentet kryesore që garantojnë ndërveprimin dhe angazhimin e studentëve.<br><br>Nëpërmjet literaturës së rekomanduar,[149] ose artikujve shkencorë të dhënë për t'u studiuar në mënyrë të pavarur, nxitet zgjerimi i konsiderueshëm i të nxënit të studentit jashtë auditorit. Për të kultivuar bashkëpunimin midis studentëve, detyrat e kursit në programet bachelor zhvillohen përmes prezantimeve në grup të studentëve. Kjo formë vlerëson jo vetëm dijet e studentëve, por edhe aftësitë e punës në grup, si edhe bën që studentët të shkëmbejnë eksperiencat me njëri-tjetrin, dhe të nxisë të menduarit kritik te studentët. |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proçes dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | Përfshirja e studentëve dhe marrja e mendimit të tyre në kuadër të përmirësimit të cilësisë së personelit akademik dhe metodave të mësimdhënies është në qendër të vëmendjes së TBU. Studentët angazhohen për të dhënë mendimet e sugjerimet e tyre. Mësimdhënia bashkëkohore kërkon planifikim të mirëfilltë të materialit mësimor, metodologjisë mësimore dhe teknikave që do të përdoren për të arritur objektivat mësimore. Personeli akademik përmirëson format e metodat e mësimdhënies falë angazhimit të studentëve në këtë proçes.[150] |

[147] 13. Rregullore për punësimin, largimin nga puna dhe vlerësimin e personelit; 13.1. Shembull njoftim për vend vacant për staf akademik në website; 13.2. Politika e BNJ ne TBU; 13.3. Format dosje staf akademik; 13.4 Praktika e rekrutimit te stafit

[148] 16.1/16.2 Kurrikula e programit BA "Administrim Biznesi" (shqip & anglisht)

[149] 16.1/16.2 Kurrikula e programit BA "Administrim Biznesi" (shqip & anglisht)

[150] 36.4. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e pyetesorit nga studentet; 36.5. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e fokus grupeve; 36.6. Formati i pyetësorit për vlerësimin e lëndës & pedagogut nga studentët; 36.7.Raporti i Fokus Grupeve; 56. Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies

| | |
|---|---|
| **Kriteri 6.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. | Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC),[151] ngrihet në nivel institucional. Anëtarët e saj propozohen nga Rektori dhe miratohen nga Senati i Universitetit.[152]<br><br>NJSBC është një strukturë autonome, e përhershme në strukturën organizative të universitetit. Ajo vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, si dhe propozon ndryshime për përmirësime të nevojshme, mbështetur në udhëzimet e sigurimit të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë dhe legjislacionit ne fuqi.[153]. Në bashkëpunim me Komisionet e Cilësisë, kjo njësi propozon masa për përmirësimin e programeve akademike dhe garanton që institucionet të respektojnë standardet e akreditimit kombëtar dhe ndërkombëtar.[154] Gjithashtu, NJSBC bashkëpunon me njësitë kryesore dhe bazë dhe realizon një sërë aktivitetesh të parashikuara në planin e saj të veprimit, në funksion të monitorimit dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.[155]<br><br>Strukturat dhe njësitë përgjegjëse përgjithësisht janë të hapura dhe mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Falë përkrahjes nga këto struktura bëhet e mundur përcjellja e dijeve konform teknikave me të reja dhe bashkëkohore, ku studenti mund të përvetësojë më lehtë infomacionin e përcjellë. Personeli akademik nëpërmjet literaturës që përzgjedh, temave që përdor, shembujve me të cilët i ilustron, formave të mësimdhënies që përdor, të cilat pasqyrohen në syllabusin e lëndës, dhe që përmirësohen në çdo semester, kontribuon në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Gjithashtu, personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik është pjesë e trajnimeve të vazhdueshme, dhe kërkimit shkencor me qëllim kualifikimin dhe avancimin e qasjes së tij kundrejt mësimdhënies apo kërkimit shkencor në nivele më të avancuara[156]. Përmirësimi i mësimdhënies dhe implementimi i metodave të reja mundësohet edhe nëpërmjet zhvillimit të leksioneve të hapura; vlerësimit nga studentë dhe fokus-grup me studentët; vlerësimit të Dekanit dhe/ose Përgjegjësit të Departamentit, etj. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|

[151] 36.1.Rregullore e NJSBC;
[152] 36.2. Procedura e zgjedhjes së NJSBC 24-25; 36.1.2. Plan pune i NJSBC 2024-2025; 36.1.3. Raporti vjetor i NJSBC 23-24
[153] 2. Statuti TBU, Neni 27 & 28; 36.1.Rregullore e NJSBC
[154] 36.3.2.Plani pune i KSC FBD 24-25; 36.3.3. Raporti vjetor i KSC FBD 23-24
[155] 36.1.Rregullore e NJSBC; 36.1.2. Plan pune i NJSBC 2024-2025
[156] 38.1 Politika për zhvillimin professional të stafit; 38.1.1. Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin; 36.8. Formulari i vleresimit te pedagogut nga eprori-kolegu; 16.1/16.2. Kurrikula e programeve BA "Administrim Biznesi"(shqip & anglisht);

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi III.2<br>**Institucioni harton rregullore dhe proçedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Format e kontrollit të dijeve përcaktohen në mënyrë shumë të qartë në rregulloren e TBU-së, Rregulloren e Fakultetit, Rregulloren e Departamentit dhe Rregulloren e Programit të Studimit.[157] Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e dijeve që studenti ka përvetësuar gjatë zhvillimit të kursit të programit bachelor janë: aktivizimet në orët e seminareve, provimi i ndërmjetëm/detyrat e kursit apo projektet dhe testimi final. Të gjitha këto elemente i bëhen të ditur studenteve.[158]<br>Në Rregulloren e Programit të Studimit përcaktohet kontrolli i dijeve. Gjithashtu këto kritere dhe mënyra bëhen publike për studentin në formatin e syllabusit të lëndës që i prezantohet studentit që në fillim të lëndës. |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Mënyrat e vlerësimit të njohurive përcaktohen në programin/sillabusin e modulit dhe planit mësimor të studimeve dhe i bëhen të njohura studentit të programit Bachelor në fillim të proçesit mësimor. Studentët informohen nga pedagogu përkatës mbi programin e modulit, detyrimet që kanë ndaj proçesit mësimor, mënyrën e vlerësimit të dijeve që në orën e parë të mësimit. Në fillim të çdo semestri për çdo vit akademik, prezantohet nga pedagogu i lëndës silabusi i lëndës. Një pjesë shumë e rëndësishme është që studentët që në fillim njihen me detyrimet e lëndës dhe forma e organizimit të tyre, koha e shlyerjes së tyre përgjatë semestrit. Studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe koherente marrin informacione përkatëse lidhur me rezultatet e vlerësimit, si dhe diskutohen në mënyrë transparente këto rezultate. Çdo pedagog ka të publikuar në portalin LMS Sillabusin që përmban formën e vlerësimit dhe leksionet.[159] |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | Gjatë gjithë vitit studentët janë në një proçes të pandërprerë të mësuarit dhe vlerësimit nëpërmjet provimeve të ndërmjetme, detyrave të kursit, projekteve, rasteve të studimit dhe provimit përfundimtar. Detyrat e kursit janë një pjesë e rëndësishme dhe elementë vlerësimi për studentët e nivelit bachelor Detyrimet e lëndës janë të përcaktuara në Rregulloren e programit të studimit. Vlerësimi i vazhdueshëm lejon studentët në këtë mënyrë të kenë mundësinë që të përgatiten mbi lëndën gjatë gjithë semestrit. Mënyrat e kontrollit të dijeve përcaktohen në syllabusin/modulin dhe planin mësimor të studimeve dhe i bëhen të njohura studentit në fillim të proçesit mësimor të studimeve të tij |

[157] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU ; 6. Rregullore e Fakultetit te Biznesit dhe Drejtesise; 7. Rregullore e Departamentit te Biznesit dhe Finances; 9./9.1Rregullore e programit të studimit Bachelor"Administrim Biznesi" 180 (shqip dhe anglisht)

[158] 9/9.1Rregullore e programit të studimit Bachelor "Administrim Biznesi"(shqip & anglisht); 16.1/16.2. Kurrikulat e programi BA „Administrim Biznesi" (shqip & anglisht)

[159]16.1/16.2. Kurrikulat e programi BA"Administrim Biznesi" (shqip & anglisht); 45.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS.



TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| | bachelor. Në këtë program organizohet Provimi i Përgjithshëm me shkrim.[160] |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.3**<br>**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe proçsin e ankimimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Në Rregulloren e Kolegjit Universitar TBU, Rregulloren e Fakultetit te Biznesit dhe Drejtësisë, si dhe Rregulloren e Programit të Studimit bachelor në Administrim Biznesi 180 ECTS përcaktohet qartë mënyra e vlerësimit të studentëve. Provimet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare zhvillohen brenda afatit të caktuar në Kalendarin Akademik. Si rregull, provimet e ndërmjetme zhvillohen në javën e 7-të semestrit me kohëzgjatje normale, ndërsa provimet përfundimtare në fund të semestrit. Shpërndarja e komponentëve të vlerësimit është në formën: provim të ndërmjetëm, detyrë kursi, niveli i diskutimit në seminar apo detyrat praktike, provim përfundimtar. Provimet zhvillohen me proçedurë sekretimi, ku secilit student i përcaktohet një numër sekretimi i cili përkon me emrin dhe numrin e ID. Sekretimi i tezave ofron sekretim të identitetit të studentit dhe paanshmëri të vlerësimit. Në fillim të çdo moduli, pedagogët përkatës në shpjegimin e silabusit, informojnë studentët edhe për afatet e parashikuara të vlerësimit Vlerësimi i studentit mbi njohuritë, dijet e përfituara apo dhe aftësitë kontrollohet sistematikisht nga pedagogu i lëndës dhe vlerësimi i tyre përfshihet në vlerësimin përfundimtar të lëndës. Studenti që tejkalon numrin e lejuar të mungesave, humbet të drejtën për të hyrë në provimin përfundimtar përkatës dhe është i detyruar ta rindjekë lëndën kundrejt pagimit të një tarife, sipas parashikimeve të Kontratës së lidhur mes Studentit dhe TBU-së.[161] |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | TBU në këtë Program Studimi të Ciklit të Parë bachelor, por edhe në programe të tjera, në situatë të zakonshme është mbështetur në Rregulloren e Programit të Studimit mbi zbatimin e formave të testimit dhe vlerësimit të dijeve.<br>TBU për vlerësimin dhe testimin e dijeve të studentit është shprehur qartësisht në Rregulloren e Përgjithshme të TBU-së, si dhe Rregulloren e Programit të Studimit mbi mënyrat e vlerësimit dhe testimit të njohurive të marra në modulet e zhvilluar për programet e studimit në |

[160] 9. Rregullore e programit të studimit Bachelor "Administrim Biznesi" (shqip); 16.1/16.2. Kurrikulat e programi Ba "Administrim Biznesi"(shqip & anglisht); 16.3/16.4. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor "Administrim Biznesi"(shqip & anglisht)

[161] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, Neni 21-30. 6. Rregullore e Fakultetit te Biznesit dhe Drejtesise, Neni 25-29 9. Rregullore e programit të studimit Bachelor"Administrim Biznesi "(shqip) Neni 11; 16.1/16.2. Kurrikulat e programi BaAB(shqip & anglisht); 8. Rregullore për Sekretarinë Mësimore; 12.1.Kalendari akademik 2024-2025; 12.2. Kalendari akademik 2022-2023; 12.3. Kalendari akademik 2024-2025

| | |
|---|---|
| | bachelor Administrim Biznesi.[162] Komunikimi i pikëve dhe vlerësimi i vazhduar i komunikohet studentëve në auditor, në mënyrë që studentët të kenë informacionin e plotë përpara zhvillimit të testimit final. |
| **Kriteri 3.** Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. | Mënyrat e vlerësimit të njohurive përcaktohen në programin/syllabusin e modulit dhe planit mësimor të studimeve dhe i bëhen të njohura studentit të programit bachelor në fillim të proçesit mësimor. Studentët informohen nga pedagogu përkatës mbi programin e modulit, detyrimet që kanë ndaj proçesit mësimor, mënyrën e vlerësimit të dijeve që në orën e parë të mësimit. Në secilin prej lëndëve/moduleve të programit të studimit bachelor, studentët në fillim të çdo semestri për çdo vit akademik, prezantohen nga pedagogu i lëndës me silabusin e lëndës dhe përmbajtjen e tij.[163]<br>Një pjesë shumë e rëndësishme është që studentët që në fillim njihen me detyrimet e lëndës dhe forma e organizimit të tyre, koha e shlyerjes së tyre përgjatë semestrit. Studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe koherente marrin informacione përkatëse lidhur me rezultatet e vlerësimit, si dhe diskutohen në mënyrë transparente këto rezultate. Çdo pedagog ka të publikuar në sitin personal në portalin e TBU-së (LMS) programet e lëndëve ku paraqitet një informacion i plotë mbi këto lëndë dhe përqindja e pikëve. Pra studentëve u bëhet e ditur struktura e lëndëve dhe përqindjet e pikëve për të gjithë elementët.[164] |
| **Kriteri 4.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi proçesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Në korrigjimin që i bëhet tezave të provimit pedagogu komenton dhe evidenton të gjitha plotësimin/mosplotësimin që lidhen me trajtimin e tezës së realizuar nga çdo student dhe vlerësimi nga ana e tij kryhet për çdo pyetje për të dalë me tej në vlerësimin përfundimtar. Pedagogu komunikon individualisht me studentin për rezultatet dhe mangësitë. Vetëm pas kësaj proçedure të dhënat dërgohen në sekretari.[165] Po kështu realizohet dhe korrigjimi i testeve dhe detyrave të kurseve në kuadrin e vlerësimit të vazhduar duke u evidentuar mangësitë dhe pikat e dobta të çdo studenti. |
| **Kriteri 5.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | Proçesi mësimor dhe testimi i njohurive të studentëve është realizuar në auditor nga pedagogu i lëndës. Pedagogu shmang mundësinë e pajisjeve kopjuese dhe monitorojnë vazhdimisht sallën e provimit për të shmangur komunikimin ndërmjet studentëve. Gjithashtu studentit nuk i lejohet të hyje në sallë pa mjet identifikimi si dhe nuk i lejohet mbajtja dhe përdorimi i aparatit telefonik. Një rëndësi të veçantë si nga stafi akademik por dhe përgjegjësi e departamentit i është vënë hartimit të tezave të reja në çdo sezon provimi dhe në disa variante. Mbështetur në Rregulloren e programit, në kalendarin e mbikëqyrjes së çdo sezoni provimi, të gjitha strukturat përgjegjëse në TBU mbi këtë proçes, angazhohen që të sigurojnë një klimë të qetë dhe bashkëpunuese gjatë zhvillimi të provimeve. Pedagogu përgjegjës i lëndës në mënyrë sistematike angazhohet të mos tolerojë dhe evitojë në maksimum |

[162] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU Neni 21-30. 9.Rregullore e programit të studimit bachelor "Administrim Biznesi"(shqip)

[163] 9. Rregullore e programit të studimit Bachelor "Administrim Biznesi"(shqip) Neni 11; 16.1/16.2. Kurrikulat e programi BA "Administrim Biznesi"(shqip & anglisht);

[164] 16.1/16.2. Kurrikulat e programi Ba "Administrim Biznesi" (shqip & anglisht); 45.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS.

[165] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, Neni 27; 9. Rregullore e programit të studimit Bachelor"Administrim Biznesi"(shqip)



TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE TBU

| | |
|---|---|
| | kopjimin në provime, plagjiaturën në detyra kursi, punime të përbashkëta mes studentëve dhe të jenë sa më origjinal në perfomancën semestrale[166] |
| **Kriteri 6.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Kontrolli i dijeve është një proçes i vazhdueshëm i veprimtarisë akademike. Natyrisht ky element i rëndesishëm është institucionalisht i përcaktuar pasi në çdo fund semestri ka sezonin përkatës të provimeve. Provimi është testi përfundimtar që lidh ecurinë, teorike e praktike të studentit përgjatë lëndës, por ai është në të njëjtën kohë vazhdim dhe lidhje organike me testimin e fundit që studenti i nënshtrohet proçedurës së provimit apo mbrojtjes së mikrotezës.[167] Studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij ose të ankimojë rezultatin brënda 3 ditëve nga data e komunikimit të rezultatit. Kjo proçedurë është e sanksionuar në statut, rregullore dhe proçedurat e provimeve. Pedagogu u komunikon studentëve rezultatet e fituara nga gjithsecili prej tyre përgjatë semestrit, veçmas për secilin element vlerësues dhe në totalin e këtyre elementeve. Kjo proçedurë është e sanksionuar plotësisht në Rregulloren e TBU-së.[168] |
| **Kriteri 7.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe Proçedurat e vlerësimit. | Mbështetur në Rregulloren e TBU-së: "Ankimimi i Studentëve", parashikon gjithë proçedurën e punës që ndiqet nëse ngrihet një ankimim nga student në Sekretarinë e IAL-së.[169] |
| **Kriteri 8.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Proçedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet. | Studenti ka të drejtë të ankohet për çdo vlerësim të bërë. Ankimi bëhet në sekretari. Pedagogu përkatës i departamentit i rishqyrton kërkesat dhe i komunikon sekretarisë qëndrimin dhe vlerësimin për ankimimin duke u shprehur për rezultatin. Kur student sërisht nuk është dakord, kjo ankesë përcillet në departament, i cili kërkon shqyrtim nga komisionet e ngritura posaçërisht. Komisioni përcakton nëse kërkesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës. Ky vendim është i formës së prerë. Kur ankesa është e drejtë njoftohet pedagogu i lëndës i cili e rimerr në provim ose në të kundërt nga shefi i departamentit ngrihet një komision për të rimarre në provim. Kopja e praktikës së ankesës së studentit dhe vendimet e komisionit për rivlerësimin e provimit, depozitohen në sekretarinë e fakultetit të ekonomisë dhe drejtësisë dhe një kopje drejtuesit të njësisë kryesore.[170] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Standardi III.4**

166 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, Neni 23-25 & Neni 29; 9. Rregullore e programit të studimit Bachelor "Administrim Biznesi" (shqip)

167 11.Udhezim per pergatitjen e temes se diplomes

168 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU Neni 27; 6. Rregullore e Fakultetit te Biznesit dhe Drejtesise, Neni 28; 9. Rregullore e programit të studimit Bachelor "Administrim Biznesi "(shqip);

169 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, Neni 28

170 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, Neni 28

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve. | Programi i studimit të bachelor është hartuar në atë mënyrë që të ofrojë për studentët njohuritë dhe kulturën e domosdoshme, të mjaftueshme për mundësinë e studimeve të mëtejme. dhe thellimin e dijeve në jetë profesionale në mënyrë të pavarur. Kurrikula e programit në përputhje me VKM Nr 41, datë 24.01,2018 dhe 185 /25.03.2021 është hartuar duke mbajtur në konsideratë zhvillimet bashkëkohore në fushën e administrimit të biznesit, aftësimin e studentëve me njohuri aplikative dhe praktike, në funksion të përmbushjes së kërkesave dhe nevojave të tregut të punës, si në nivel kombëtar dhe rajonal.[171] TBU ofron periodikisht edhe kurse afatshkurtra, disa javore kualifikimi në fusha dhe sektorë të veçantë të ekonomisë, kontabilitetit, financës, IT, etj.[172] |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara. Studentët përgatiten me njohuri bazë aplikative në këtë fushë si dhe nëndisiplinat përkatëse, duke synuar formimin e specialistëve me kompetenca të zgjeruara praktike. Një ndër objektivat e këtij programi është të plotësojë nevojat dhe kërkesat e studentëve për njohuri dhe aftësi praktike në drejtime të ndryshme të administrimit të një biznesi si: menaxhimit strategjik, lidershipit në organizata, menaxhimit financiar, menaxhimit te burimeve njerëzore, etj.[173] |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse. | Në programin e studimit të bachelor personeli akademik kujdeset që të zbatojë me rigorozitet dhe përgjegjshmëri të gjitha detyrimet e syllabusit të lëndës që mbulon ku evidentohen kompetencat respektive qe studenti merr perkatesisht sipas profilit te studimit ne kontabilitet-finnace, menaxhim apo marketing. Pedagoget Format e kontrollit të zotërimit të aftësive të studentit në përfundim të lëndës, prezantohen që në fillim të modulit nga pedagogu dhe monitorohen në proçes që ato të përmbushen nga studentët si: detyra kursi, teste të ndërmjetme, angazhime në seminare, apo edhe projekte të përbashkëta grupi nëse ka. Studenti orientohet që gjithë kohën të grumbullojë informacionin e duhur që të jetë i përgatitur për detyrimet përmbyllëse me punim diplome.Pedagoget angazhohen ne seanca mentorimi, orientimi dhe pergatitjeje per provimin perfundimtar[174] |
| **Kriteri 4.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli | Metodologjia e hartimit të syllabuseve të çdo lënde realizohet në mënyrë që t'u japë studentëve aftësi të materializimit të leksioneve të marra nëpërmjet seminareve të bëra në mënyrë interactive, ku përfshihen detyra kursi, raste praktike, debate të ndryshme etj. TBU i jep një vëmendje të veçantë përgatitjes praktike të studentit, kjo me qëllim që |

[171] 9. Rregullore e programit të studimit Bachelor "Administrim Biznesi"(shqip); 16. Kurrikula e programit Bachelor "Administrim Biznesi (shqip); 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – Bachelor "Administrim Biznesi ";

[172] 38.1.1. Të dhëna për trajnimet profesionale për studentët dhe stafin

[173] 16.1/16.2. Kurrikula e programit Bachelor "Administrim Biznesi" (shqip & anglisht); 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – Bachelor "Adminstrim Biznesi "

[174] 22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit – BaAB (shqip & anglisht)

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | studentët të jenë kandidatë potencial për punësim direkt pas përfundimit të studimeve. Falë bashkëpunimit që TBU ka me aktorë vendas dhe të huaj nga fusha e ekonomisë, bizneseve në industri të ndryshme, bëjnë të mundur dhe realizimin e praktikave të ndryshme profesionale të studentëve.[175] Gjatë zhvillimit të këtyre vizitave studimore, studentët kanë mundësinë të njihen me elementët më të rëndësishme dhe të nevojshme për formimin e tyre profesional. Ndërthurja e teorisë me praktikën është një sukses i garantuar për studentët e së nesërmes në tregun e punës. Studentët e TBU të cilët kanë qenë pjesë e këtyre praktikave profesionale sot janë të punësuar në pozicione të profilit të tyre të studimit[176] |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. | TBU pjesë të strukturës organizative të tij ka Zyrën e Studentit e cila, organizon një sërë eventesh që janë në mbështetje të edukimit kurrikular dhe ekstrakurrikular si: trajnime, workshop-e, leksione të hapura, etj. Pjesë e këtyre eventeve kanë qënë gjithmonë: stafi pedagogjik i brendshëm dhe/ose i jashtëm i TBU, partnerë, personalitete, të ftuar të cilët kanë kontribute të vyera në fushën e tyre profesionale dhe ndajnë me studentët e TBU eksperiencat/përvojat më të mira në jetën e tyre profesional.[177] |
| **Kriteri 6.** Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. | TBU i mbështet studentët për zhvillimin e ideve dhe studimeve të tyre. Përmes ofrimit të programeve të studimit të përshtatura me nevojat e tregut dhe përmes partneritetit me industrinë dhe komunitetin e biznesit, TBU synon të edukojë një brez të ri profesionistësh, të cilët do të jenë të përgatitur për sfidat dhe mundësitë e një tregu global. Kjo përputhet me nevojat e zhvillimit të vazhdueshëm të ekonomisë shqiptare dhe me kërkesat e një shoqërie moderne, të integruar në tregun ndërkombëtar. Si pjesë integrale e Balfin Group, TBU ka mundësinë të përfitojë nga një sërë avantazhesh dhe sinergjish, si:[178]<br>• *Mundësi për Bashkëpunim dhe Zhvillim:* TBU mund të përfitojë nga përvoja dhe burimet e Balfin Group, për të zhvilluar programe dhe projekte novative në fushën e arsimit dhe zhvillimit të biznesit e teknologjisë së informacionit.<br>• *Akses në Rrjetin e Biznesit dhe Industri:* Nëpërmjet Balfin Group, TBU ka mundësi për të ndërtuar lidhje të forta me industrinë dhe bizneset, duke siguruar mundësi praktike për studentët dhe shkëmbim informacioni për fusha të ndryshme të biznesit dhe teknologjisë së informacionit.<br>• *Burimet dhe Mbështetja Financiare afatgjatë:* Balfin Group mund të ofrojë mbështetje financiare dhe burime për zhvillimin e infrastrukturës, programeve akademike dhe projekteve novative të TBU-së.<br>• *Përfitim nga Ekspertiza e Grupit:* TBU mund të përfitojë nga ekspertiza dhe përvoja e Balfin Group në fusha të ndryshme të biznesit dhe teknologjisë së informacionit, duke e bërë atë një institucion akademik më të përshtatshëm me kërkesat e tregut të punës. |

[175] 37.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi (Aneks Tabela 5); 37.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programin e studimit (bachelor BA180); 37.4. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit

[176] 35. Të dhëna për punësimin real të studentëve 20-23 (Aneks Tabela 23)

[177] 14.3. Aktivitete të realizuara nga zyra për studentët; 14.4. Aktivitete bashkëpunime me biznesin për studentët; 14.Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore

[178] 3.1. Strategjia e Zhvillimit te TBU 24-29; 3.1.1. Strategjia e Zhvillimit te TBU 18-23



TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| | • *Mundësi për Programe të Përbashkëta dhe Shkëmbim Kulturor:* Balfin Group dhe TBU mund të zhvillojnë programe të përbashkëta, shkëmbime studentore, dhe veprimtari të tjera, kombëtare dhe rajonale, që promovojnë shkëmbimin kulturor dhe arsimor.<br><br>Grupi Balfin është një nga mbështetësit kryesorë për praktikat dhe mundësitë e punësimit për studentët e TBU, duke ofruar mundësi reale për t'u përfshirë në sektorin e biznesit dhe të zhvillimit profesional. Menaxherët e këtij grupi, të cilët kanë përvojë të pasur në menaxhimin e bizneseve dhe industrive të ndryshme, zhvillojnë shpesh biseda, trajnime dhe leksione për studentët, duke i mundësuar atyre të zhvillojnë aftësi të vlefshme, njohuri të thelluara dhe lidhje profesionale që do t'i ndihmojnë në karrierën e tyre të ardhshme. Kjo mbështetje e vazhdueshme e Grupit Balfin krijon një mundësi të pasur për studentët e TBU-së për t'u integruar në tregun e punës dhe për t'u shndërruar në liderë të ardhshëm në industrinë e biznesit dhe teknologjisë.[179] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike. | Institucioni harton proçedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike, që në fillim të semestrit.[180] Diplomimi për programet e ciklit të Parë të studimeve "bachelor" sipas L-AL bëhet nëpërmjet një provimi përfundimtar formimi, ose përgatitjes dhe mbrojtjes së një punimi diplome në fushën e arsimimit të kryer.[181] |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse. | Diplomimi për programet e ciklit të Parë të studimeve "Bachelor" sipas L-AL bëhet nëpërmjet një provimi përfundimtar formimi, ose përgatitjes dhe mbrojtjes së një punimi diplome në fushën e arsimimit të kryer. Oret e orientimit te studenteve per pergatitjen e diplomes apo provimit perfundimtar konsiderohen si ore seminaresh, nje ore ne jave sipas nje kalendari te paracaktuar. Pergjate ketyre oreve orientuese pedagoget udheheqes fokusohen ne orientimin e studenteve qofte nga aspekti strukturor i pergatitjes se diplomes, qofte dhe ne permbajtjen e punimit. Ne te njejten logjike mentorohen dhe orientohen edhe studentet qe diplomohen me test perfundimtar, duke u fokusuar ne permbledhjen e njohurive ne tematikat baze te lendeve te cilat jane te perfshira ne listen e kontrollit te dijeve nepermjet testit perfundimtar.[182] |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final | Në programin Bachelor në Administrim Biznesi (kohëzgjatje 3 vite akademike) me 3 profile, duke qënë se fokusi i programit janë |

[179] 37.4. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit

[180] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, Neni 35-37; 9. Rregullore e programit të studimit Bachelor "Administrim Biznesi" 180 (shqip); 12.1. Kalendari akademik 2021-2022; 12.2. Kalendari akademik 2022-2023; 12.3. Kalendari akademik 2023-2024

[181] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, Neni 35

[182] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, Neni 35; 11.Udhëzim për përgatitjen e temës së diplomës fq 3,4.

| | |
|---|---|
| bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | përvetësimi i aftësive praktike profesionale nga ana e studentit, edhe provimi përfundimtar si detyrim përmbyllës, synon të testojë pikërisht aftësitë e studentëve për të aplikuar njohuritë e përfituara nga programi i studimit në format e rasteve studimore apo simulimeve të realitetit të bizneseve. Studentet me mesatare mbi 7 gezojne te drejten per punim diplome ne permbyllje te studimeve bachelor ose te provimit perfundimtar. Studentet nen kete mesatare jane te detyruar te permbyllin studimet nepermjet provimit perfundimtar. Studenteve qe zgjedhin punim teme diplome, ju asociohet pedagogu perkates me background ne fushen e temes se perzgjedhur nga studenti me te cilin vijohen seancat e orientimit, instruksioneve, monitorimit dhe kontrollit te progresit te punimit te temes deri ne dorezimin e saj. Per vleresimin e temave ngrihet komisioni i vleresimit me 3-5 anetare dhe kryetar eshte anetari me graden me te larte shkencore akademike nderkohe qe anetaret e komisionit jane me te drejta te barabarta vleresimi. [183] |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Studenti që realizon mbrojtjen e diplomës me temë duhet të respektojë kërkesat e "Udhëzimit për Proçedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes se diplomës në TBU". Çdo student gjatë përgatitjes së punimit ka një udhëheqës i cili në vijimësi ka raportuar në departament mbi ecurinë e punës për përgatitjen e punimit sipas standardeve të kërkuara dhe udhëzimit përkatës.[184]<br>Departamenti, gjatë shqyrtimit të propozimeve të studentëve për temën e tezës bachelor, garanton që udhëheqësi i propozuar nga studentët të jetë në përputhje me fushën e programit të studimit dhe temën e propozuar. Nëse nuk konstatohet përputhshmëri, atëherë Departamenti cakton një pedagog udhëheqës që i përmbush këto kritere. Studentët njoftohen për listën e miratuar me temat dhe pedagogët udhëheqës.<br>Udhëheqësi kur bindet që punimi është me cilësinë e kërkuar dhe veçanërisht shmang plagjaturën jep miratimin për ta mbrojtur atë. Në rast të kunder mbrojtja shtyhet në një sezon tjetër. Në përfundim të punimit të temës së diplomës së studentit, pedagogu udhëheqëes plotëson Formularin e Vlerësimit Individual për çdo student që e ka nën udhëheqje, në të cilin shpreh mendimin e tij objektiv dhe të pavarur.[185] |
| **Kriteri 5.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | Pedagogu udhëheqës gjatë seancave metodologjike trajton çështje të tilla si: sqarimin e aspekteve metodologjike, përpunimin e të dhënave me metoda sasiore dhe cilësore; punën në terren, planifikimin, implementimin, raportimin e gjetjeve/të dhënave, etj[186] |
| **Kriteri 6.** Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Siç përmendet edhe më sipër studentët mbyllin detyrimet e bachelor me një provim të përgjithshëm përfundimtar vlerësuar me një total 100 pikë. Konvertimi i rezultatit me pike në notë përfundimtare, bëhet sipas sistemit të vlerësimit në fuqi në TBU.[187] Në rastet e studentëve Bachelor që mbyllin detyrimet e studimit me temë diplome, vlerësimi kryhet si vijon: Kryetari i Komisionit plotëson formatin përkatës dhe bën |

[183] 11.Udhëzim për përgatitjen e temës së diplomës fq 5,6, 15,16
[184] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, Neni 35; 11. Udhëzim për përgatitjen e temës së diplomës
[185] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, Neni 35;11.Udhëzim për përgatitjen e temës së diplomës,Shtojca 4
[186] 11. Udhëzim për përgatitjen e temës së diplomës, Shtojca 2
[187] 10.Formati i tezës së provimit përfundimtar; 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, Neni 21



TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| | mbledhjen e pikëve të vlerësimit të udhëheqësit, oponentit dhe të secilit anëtar të Komisionit, e përpjesëton atë me numrin e vlerësuesve dhe bën konvertimin e rezultatit në notë përfundimtare, sipas sistemit të vlerësimit në fuqi në TBU. Në rastet kur udhëheqësi dhe/ose oponenti i temës janë edhe anëtarë të Komisionit, vlerësimi i tyre llogaritet vetëm një herë. Rezultati përfundimtar shënohet në proçess-verbal dhe bëhet publik në fund të çdo seance të mbrojtjes së diplomave, në prani të diplomantëve.[188] |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Në përfundim të studimeve të ciklit të Parë Bachelor studenti pajiset me diplomën dhe suplementin përkatës të programit bachelor. Studenti në suplimentin e diplomës ka programin e zhvilluar me kreditet dhe vlerësimin përkatës gjatë 3 viteve akademike sipas standardeve Evropiane me 180 kredite.[189]<br>Studentët mund të pajisen edhe me syllabuset të shkurtuara përkatëse të lëndeve të zhvilluara sipas programit në bazë të një kërkese të depozituar në sekretarinë mësimore.[190] |
| **Kriteri 8.** Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. | Dokumentacioni i studentit në momentin e regjistrimit dhe në vijim dorëzohet dhe ndiqet nga sekretaria mësimore.[191] Kjo dosje transferohet në zyrën e arkivit të TBU-së kur studenti diplomohet/ transferohet/crregjistrohet. Dosjet individuale të studentëve pasi diplomohen/transferohen/crregjistrohen arkivohen duke u bashkangjitur edhe fotokopje e diplomës dhe suplementit në dosjen e tij. TBU ruan dhe arkivon sipas Ligjit Nr.9154 datë 06.11.2003 "Për Arkivat" dhe Rregullores mbi funksionimin e arkivit në TBU të gjitha të dhënat e tjera në lidhje me regjistrin e amzës, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistri i tërheqjes së diplomave të lëshuar nga QSHA. Sekretaria e ushtron detyrën bazuar në Rregulloren për Sekretarinë Mësimore dhe kryen një sërë shërbimesh si: regjistrimi i studentëve, marrja e kërkesave dhe dokumentimi dhe bashkëpunimi dhe mbajtja e dosjes për proçesin e transferimeve të studentëve, përditësimi i informacionit për portalin e TBU-së, përgatitja dhe dhënia e vërtetimeve të ndryshme gjatë studimeve dhe pas përfundimeve të cikleve të studimeve, konfirmimi i përfundimit të ciklit të studimeve, përgatitja dhe dhënia e vërtetimeve sipas kërkesave të studentëve si: ( vërtetime si student, listë pjesore të notave,vërtetime diplomimi, etj.) përgatitja dhe dhënia e diplomës dhe suplementit të diplomës, konfirmimi i vërtetësisë së diplomës, përgatitja dhe dhënia e listës së notave, përgatitja dhe dhënia e vërtetimeve të diplomës, përgatitja dhe dhënia e programeve të studimit. Informacion më i detajuar në lidhje me planin mësimor dhe ngarkesën orët në auditor mund të gjendet në format të shkruar dhe është i aksesueshëm me kërkesë të çdo studenti në sekretarinë përkatëse apo pranë zyrës së arkivit të institucionit.[192] |

188 11. Udhëzim për përgatitjen e temës së diplomës, fq.18; 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, Neni 21
189 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, Neni 38; 17.1. Modeli i diplomës_Modeli i Suplementit të Diplomës_për secilin profil per BaAB; 17.2. Forma e re e propozuar e diplomës dhe suplementit_për secilin profil per Bachelor BA180
190 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, Neni 38
191 8. Rregullore për Sekretarinë Mësimore
192 8. Rregullore për Sekretarinë Mësimore; 57. Rregullore e Arkivës

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| Shkalla e përmbushjes sëstandardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi III.6<br>Në rastin e programit të studimit në "bachelor" institucioni ndjek një proçedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përftimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale. | Departamenti i Biznesit dhe Financës dhe strukturat përkatëse, përmes bashkëpunimit me aktorë të rëndësishëm të tregut të punës, garantojnë mundësitë e nevojshme për realizimin e praktikës profesionale pranë institucioneve pritëse.[193]<br><br>Nga ana tjetër, infrastruktura në dispozicion të zhvillimit të procesit mësimor plotëson standardet dhe kriteret e cilësisë. Auditorët e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura secili me desktop, projektorë, akses ne internet me kabëll dhe mjete të tjera didaktike.<br><br>Në të gjitha mjediset e TBU-së është e mundur lidhja e paisjeve kompjuterike me internetin nëpërmjet wifi. Kjo bën të mundur realizimin gjatë proçesit mësimor të lidhjes me faqe të ndryshme web-i për ti ardhur në ndihmë stafit akademik të ilustrojnë me shembuj konkretë tematika të caktuara. TBU ka integruar disa sisteme të rëndësishme IT për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies. Këto sisteme përfshijnë: një Sistem të Menaxhimit të Mësimit (LMS) të bazuar në Moodle, Office 365 për studentët dhe stafin akademik, dhe SharePoint për menaxhimin e skedarëve dhe informacionit dokumentar. Interneti sigurohet nga ISP-ja Tring Albania.[194] Këto sisteme jo vetëm që rrisin efikasitetin dhe produktivitetin, por gjithashtu përmirësojnë përvojën e përgjithshme të studentëve dhe stafit akademik. Përdorimi i Moodle, Office 365, SharePoint dhe një lidhje të besueshme interneti nga Tring Albania krijon një mjedis mësimor dhe administrativ që nxit inovacionin, bashkëpunimin dhe suksesin akademik.[195] |
| **Kriteri 2.** Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin | Studentëve u mundësohet kryerja e praktikës në institucione të ndryshme me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi. Në këto institucione ata njihen me format dhe teknologjitë më të fundit dhe bashkëkohore, me qëllim përfitimin sa më të mirë të njohurive dhe |

[193] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, Neni 33 & 34; 37.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi (Aneks Tabela 5); 37.2. Memorandum TIP_TBU_Subjekt; 37.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programin e studimit (bachelor BA180); 37.4. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit; 37.5. Vendimet për përcaktimin e Pedagogut-pedagogëvve Udhëheqës për Praktikat Mësimore për vitin 24-25 FBD

[194] 45.1 Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, pika 5 fq. 5; 49. Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Aneks Tabela 17); 45.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS; 45.3. Guidë për studentët për përdorimin e LMS

[195] 45.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, pika 5 fq. 6-8

| | |
|---|---|
| më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale. | kompetencave profesionale që lidhen me këtë fushë në të cilën ata po studiojnë.[196] Gjithashtu, Zyra e Çështjeve Studentore mbështet studentët gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve, duke ofruar konsulencë për aplikime dhe shpërndarë informacion për mundësitë e punësimit, apo mundësitë për vazhdimin e specializimeve brenda ose jashtë vendit me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.[197] |
| **Kriteri 3.** Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës. | Praktika Profesionale për programet Bachelor në Administrim Biznesi me 3 profile (me 180 kredite) ka 15 kredite; pra një detyrim prej 375 orë punë për studentin, e cila realizohet e shpërndarë në 3 vite. Përpara se studenti të futet në proçesin e vlerësimit për praktikën e realizuar, dorëzon raportin e praktikës te pedagogu përgjegjës. Zyra e Çështjeve Studentore, në bashkëpunim me pedagogun përgjegjës për praktikën, përgatisin dosjen e studentit (formulari aplikimi i praktikës, formular miratimi i praktikës, formular i vlerësimit të studentit nga mbikëqyrësi në institucion/organizatë/kompani, dhe raportin përfundimtar të praktikës të përgatitur nga studenti sipas formatit përkatës) dhe më pas i kalohet komisionit vlerësues. Vlerësimi përfundimtar i studentit bëhet përpara një komisioni duke ndjekur një proçedurë të caktuar. Komisioni përbëhet nga tre pedagogë me titullin Dr. Kryetari dhe dy anëtarë të cilët vlerësojnë praktikën e studentit, mbi bazën e raportit të zhvillimit të praktikës mësimore dhe formularit të vlerësimit të studentit praktikant.[198] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

[196] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU; 37. Rregullore e praktikës mësimore & dokumentat përkatëse; 37.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi (Aneks Tabela 5); 37.2. Memorandum TIP_TBU_Subjekt; 37.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programin e studimit (bachelor BA180); 37.4. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit; 37.5.. Vendimet për përcaktimin e Pedagogut-pedagogëvve Udhëheqës për Praktikat Mësimore për vitin 24-25 FBD

[197] 14. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore; 14.2. Panairi i punës 2024 (ftese); 14.3. Aktivitete të realizuara nga zyra për studentët; 14.4. Aktivitete bashkëpunime me biznesin për studentët

[198] 16.3/16.4Plani mësimor i programit të studimit bachelor "Administrim Biznesi"(shqip & anglisht); 37. Rregullore e praktikës mësimore & dokumentat përkatëse Neni 6 & fq.5-15; 37.5. Vendimet për përcaktimin e Pedagogut-pedagogëvve Udhëheqës për Praktikat Mësimore për vitin 24-25 FBD

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| Standardi IV.1<br>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. | Personeli akademik, i angazhuar me kohë të plotë dhe të pjesshme në programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi, është në përputhje me kërkesat e L-AL 80/2015. Ai përfshin pedagogë me kualifikime të përshtatshme akademike, tituj dhe grada, duke përfshirë lektorë, ndihmës lektorë dhe specialistë të fushës përkatëse. Detyrat dhe rolet e tyre janë të përcaktuara qartë, gjithmonë në përputhje me objektivat dhe qëllimet e programit.[199]<br><br>Personeli akademik angazhohet në mësimdhënie sipas fushave të tyre të diplomimit dhe specializimit. Niveli i kualifikimit dhe fusha kërkimore e çdo anëtari të stafit janë të përputhshme me programin e studimit. Modulet mësimore shpërndahen bazuar në përvojën kërkimore dhe praktike të pedagogëve.<br><br>Grada minimale për stafin akademik të përfshirë në mësimdhënie është "Master i Shkencave". Ngarkesa mësimore shpërndahet në përputhje me gradën shkencore dhe titullin akademik, duke respektuar normat e përcaktuara nga Senati Akademik.<br><br>Zyra për Burimet Njerëzore (ZBNJ) siguron që kontratat e punësimit të përcaktohen sipas kategorisë së personelit akademik, në përputhje me LAL 80/2015, Statutin dhe Rregulloret e TBU-së. Çdo modul mbulohet nga personel akademik me kualifikimin e duhur dhe profil studimi të përpuethshëm me fushën formuese dhe kërkimore të modulit.[200] |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. | Personeli akademik efektiv mbulon mbi 70% të ngarkesës mësimore. Gjithë stafi akademik i TBU sipas fushës së kualifikimit që ka, angazhohet në programet e studimit të Ciklit të Parë dhe për këtë arsye ata kanë një ngarkesë të vlerësuar në këto programe studimi. TBU ka plotesuar kete kriter duke filluar nga viti akademik 2023-2024 e ne vazhdim me plotesimin e organogrames me stafin perkates sipas kerkesave te kredencialeve akademike |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e | Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi demonstron qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi në proçesin mësimor në TBU. Një pjesë e mirë e personelit akademik rezulton të ketë vite pune në TBU. Si rezultat, ata kanë ndërtuar një klimë bashkëpunuese me studentët, |

[199] 43.3. Të dhëna mbi kerkimin shkencor te stafit akademik në programin studimit BaAB; 29. Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik, të angazhuar në programin e studimit BaAB (Aneks Tabela 4); 24. CV e stafit akademik të angazhuar në programet e studimit
[200] 13. Rregullore për punësimin, largimin nga puna dhe vlerësimin e personelit; 13.2. Politika e BNJ ne TBU; 13.3. Format Dosje staf akademik (administrohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore, sipas PAK/PAE)

| | |
|---|---|
| akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. | kolegët dhe punëdhënësit, e cila reflektohet në të gjithë mjediset e institucionit.[201]<br><br>Marrëdhënia e punësimit të stafit akademik bazohet në kontrata individuale pune, ndërsa Zyra e Financës garanton përmbushjen e detyrimeve ekonomike dhe financiare, në përputhje me këto kontrata dhe legjislacionin në fuqi mbi pagat dhe pagesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore mujore. |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek proçedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Marrëdhëniet e punës në TBU bazohen në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, L-AL Nr.80/2015, Statutin, Rregulloren e Punës, si dhe rregullore të tjera bazë. TBU ndjek një politikë të hapur dhe transparente në punësimin dhe rekrutimin e stafit akademik.[202] Në Rregulloren e Punësimit përcaktohen parimet themelore, rregullat, kriteret, standardet dhe proçedurat për marrëdhëniet e punës në TBU, përfshirë rekrutimin e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Institucioni i kushton vëmendje të veçantë përzgjedhjes dhe punësimit të stafit akademik, duke synuar përputhjen e kualifikimeve të tyre me programet e studimit që ofrohen.[203] Për rekrutimin e personelit, TBU ndjek një proçedurë transparente, duke publikuar pozicionet vakante në seksionin e njoftimeve në faqen zyrtare të IAL-së dhe rrjetet sociale.[204] Faqja zyrtare e IAL-së është: www.tbu.edu.al. Pas aplikimeve, kandidatët vlerësohen dhe renditen me pikë, duke siguruar transparencë në proçes. Vlerësimi dhe përzgjedhja bëhen nga një Komision , duke u bazuar fillimisht në dokumentacionin e dorëzuar dhe më pas në intervista. Kandidati me numrin më të lartë të pikëve vazhdon më tej me intervistën përfundimtare, e cila çon në përzgjedhjen dhe nënshkrimin e kontratës së punës nga Rektori i TBU. Në të njëjtën kohë, publikohet edhe Urdhri i Emërimit. E gjithë kjo proçedurë është plotësisht transparente, duke garantuar përzgjedhjen më të përshtatshme për çdo pozicion akademik. |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | Institucioni ka siguruar dhe garantuar angazhimin e personelit akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike të programit të studimit, si dhe ofrimin e mjediseve moderne të institucionit me aparatura, mjete dhe programe aplikative të nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e standardeve sasiore dhe cilësore për zhvillimin e proçesit mësimor, aftësimin teorik e praktik. TBU është treguar dhe tregohet i kujdesshëm për mirëmbajtjen e laboratorëve dhe pajisjeve të tyre. Institucioni angazhon staf të dedikuar për të garantuar funksionimin e duhur të infrastrukturës akademike, duke krijuar një |

[201] 27. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse (Aneks Tabela no.1 & 2); 28. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit BaAB (Aneks Tabela 6,12,7 & 8); 29. Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik, të angazhuar në programin e studimit bachelor AB180 (Aneks Tabela 4); 24. CV e stafit akademik të angazhuar në programet e studimit

[202] 13. Rregullore për punësimin, largimin nga puna dhe vlerësimin e personelit; 13.1. Shembull njoftim për vend vacant për staf akademik në website; 13.2. Politika e BNJ ne TBU.

[203] 13. Rregullore për punësimin, largimin nga puna dhe vlerësimin e personelit

[204] 13.1. Shembull njoftim për vend vacant për staf akademik në website



TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| | mjedis të përshtatshëm për zhvillimin cilësor të proçesit mësimor dhe kërkimor.[205] |
| **Kriteri 6.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ. | Në zbatim të L-AL 80/2015, Neni 3, Pika 4, gërma ç, Rregullores së Përgjithshme të TBU, si dhe Rregullores e Punësimit në TBU, Zyra e Burimeve Njerëzore, e TBU-së administron në mënyrë të strukturuar dokumentacionin e punonjësve në aspektin proçedural dhe dokumentar. Kjo zyrë është përgjegjëse për:[206]<br><br>• Shpalljen e vendeve të lira të punës,<br>• Administrimin e formularëve të vlerësimit të performancës,<br>• Mbajtjen dhe përditësimin e dosjeve të pedagogëve me kohë të plotë dhe të pjesshme,<br>• Ruajtjen e lidhjeve të ngushta me personelin,<br>• Ndjekjen e të gjitha procedurave për rekrutimin e stafit akademik dhe administrativ.<br><br>TBU, nëpërmjet ZBNJ-së, siguron që për të gjithë personelin akademik të angazhuar në proçesin e mësimdhënies dhe në këtë program studimi, të plotësohet dokumentacioni i nevojshëm për stafin me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Zyra e Burimeve Njerëzore në TBU disponon një listë të plotë të stafit akademik dhe administrativ të institucionit, e detajuar sipas njësive kryesore, njësive bazë dhe programeve të studimit.[207] Kjo listë pasqyron ndarjen e stafit me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, të organizuar sipas viteve akademike.[208] |
| **Kriteri 7.** Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | TBU, e ka në praktikën e punës së tij që në kuadrin e marrëveshjeve me subjektet e ndryshme private dhe IAL të tjera, përcakton staf akademik me eksperiencë për të ndjekur nga afër studentët në praktiken profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike për programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi me 3 profile.[209] Në varësi të numrit të studentëve që zhvillojnë praktikën, departamenti përcakton edhe numrin e pedagogëve mbikëqyrës. Personeli akademik i angazhuar në mbikëqyrjet e praktikave është njëkohësisht edhe në përbërje të Komisionit që departamenti ngre për mbrojtjen e praktikës nga studentët. |
| **Kriter 8.** Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në | Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, ndihmon studentët në |

[205] 44. Raporti i MAS për inspektimin e kapaciteteve (22-23); 44.1 Raporti i MAS për inspektimin e kapaciteteve (2024); 44.2. Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Aneks Tabela 16)
[206] 13. Rregullore për punësimin, largimin nga puna dhe vlerësimin e personelit; 13.2. Politika e BNJ ne TBU.
[207] 27 Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse (Aneks Tabela no.1 & 2 ); 28.Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit BaAB (Aneks Tabela 6,12,7 & 8)
[208] 13. Rregullore për punësimin, largimin nga puna dhe vlerësimin e personelit; 13.2. Politika e BNJ ne TBU; 13.3.Format Dosje staf akademik (administrohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore, sipas PAK/PAE)
[209] 37.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi; 37.3.Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programin e studimit BaAB; 37.5. Vendimet për përcaktimin e Pedagogut-pedagogëve Udhëheqës për Praktikat Mësimore për vitin 24-25 FBD

| | |
|---|---|
| realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në proçsin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. | përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të merr pjesë në proçesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.[210] Siç është shpjeguar edhe në kriteret e mësipërme,, Praktika Profesionale për programin Bachelor në Administrim Biznesi me 3 profile ka një detyrim prej 375 orë punë individuale për studentin të shpërndara respektivisht vitin e parë 75 orë (3 kredite); vitin e dytë 100 orë (4 kredite) dhe 200 orë (8 kredite). TBU garanton se zotëron kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të praktikës mësimore.[211] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | TBU garanton sigurimin dhe funksionalitetin e infrastrukturës laboratorike dhe shërbimeve mbështetëse për programet e studimit, duke krijuar një mjedis optimal për zhvillimin e aftësive praktike të studentëve. Institucioni ofron pajisje moderne laboratorike dhe lehtëson kryerjen e matjeve, analizave dhe testeve, si brenda ambienteve të institucionit ashtu edhe jashtë tij, në përputhje me temat e praktikave profesionale dhe fushën e studimit.[212]<br><br>Në kuadër të këtij angazhimi, TBU siguron staf ndihmës akademik të kualifikuar për mbështetjen e studentëve gjatë orëve laboratorike, duke garantuar një proces mësimor efektiv dhe të sigurt. Gjithashtu, institucioni merr masa të vazhdueshme për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e laboratorëve dhe ambienteve të tjera didaktike, duke i përshtatur ato sipas nevojave specifike të programeve të studimit dhe standardeve akademike. |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Auditorët, sallat dhe mjediset e tjera ofrojnë te gjithë komoditetin e nevojshëm për studim, pune shkencore dhe individuale, si për studentet dhe stafin akademik. TBU, ka një infrastrukture specifike të prekshme dhe shumë funksionale në varësi të përmbajtjes së programeve të studimeve. Në TBU, studentët dhe stafi akademik kanë qasje në një gamë të gjerë të pajisjeve kompjuterike për të mbështetur nevojat e tyre akademike dhe administrative. Konkretisht, në TBU ka dy laboratorë kompjjuterikë: i pari është i pajisur me 30 kompjuterë HP të fuqizuar nga proçesori Intel Core i5 6100 CPU @3.7 GHz, 8 GB RAM dhe sistem operativ Windows 10 Pro 64-bit, ndërsa laboratori është i pajisur me 60 kompjuterë Fujitsu të fuqizuar nga proçesori Intel Core i3-9100 CPU |

[210] 37. Rregullore e praktikës mësimore & dokumentat përkatëse Neni 6 & fq.5-15
[211] 16.3/16.4. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor "Administrim Biznesi "shqip & anglisht)
[212] 44. Raporti i MAS për inspektimin e kapaciteteve (22-23); 44.1. Raporti i MAS për inspektimin e kapaciteteve (2024); 44.2. Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Aneks Tabela 16)

| | |
|---|---|
| | @3.6 GhZ, 8 GB RAM dhe sistem operativ: Windows 11 Pro 64-bit si dhe 2 projektor të lidhur paralel Epson EB-W42. Këto pajisje të përditësuara ofrojnë performancë të lartë dhe stabilitet, duke u mundësuar përdoruesve të kryejnë detyra komplekse dhe të përdorin softuerë të avancuar pa vonesa.[213]<br>Gjithashtu, TBU disponon 10 salla të pajisura me nga një kompjuter HP me Intel Core i3 6100 CPU @3.7 GHz, 8 GB RAM dhe sistem operativ Windows 10 Pro 64-bit. Secila nga këto salla është gjithashtu e pajisur me një projektor ACER X1226AH DLP, duke lejuar prezantime dhe leksione interaktive me cilësi të lartë vizuale.[214]<br>Për pedagogët dhe stafin administrativ, TBU ka në dispozicion 20 njësi kompjuterike HP me Intel Core i3 6100 CPU @3.7 GHz, 8 GB RAM, 64-bit, Windows 10 Pro, dhe 5 njësi me HP EliteDesk të pajisura me Intel Core i7 6700 CPU dhe 16 GB RAM. Këto pajisje të fuqishme sigurojnë që stafi të mund të kryejë detyrat e tyre me efikasitet të lartë dhe me mbështetje teknologjike të avancuar.[215] |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | TBU ka dy laboratorë kompjuterikë, i pari është i pajisur me 30 kompjuterë HP të fuqizuar nga proçesori Intel Core i5 6100 CPU @3.7 GHz, 8 GB RAM dhe sistem operativ Windows 10 Pro 64-bit, ndërsa laboratori është i pajisur me 60 kompjuterë Fujitsu të fuqizuar nga procesori Intel Core i3-9100 CPU @3.6 GhZ, 8 GB RAM dhe sistem operativ: Windows 11 Pro 64-bit si dhe 2 projektor të lidhur paralel Epson EB-W42. Këto pajisje të përditësuara ofrojnë performancë të lartë dhe stabilitet, duke u mundësuar përdoruesve të kryejnë detyra komplekse dhe të përdorin softuerë të avancuar pa vonesa.[216]<br>Laboratorët e Informatikës kanë kapacitet të mjaftueshëm për plotësimin e nevojave të TBU-së për programet që zhvillon. Në këto laboratorë zhvillohen leksione, seminare, praktika pune. |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | Siç përmendet në Kriterin 1 & 2, më sipër, TBU ofron për studentët 2 laboratorë të Informatikës të cilët janë të lidhur në rrjet dhe në internet non stop. Në to janë instaluar edhe Programe/Softe aplikative. Në këto laboratorë zhvillojnë mësim studentët që ndjekin programet e studimit Bachelor dhe Master në Informatikë Ekonomike, Inxhinieri Softwerike si dhe Inxhinieri Kompjuterike.[217] |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e | TBU zotëron kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të praktikës mësimore.[218] Praktika zhvillohet në institucione dhe kompani të ndryshme, në kuadër të bashkëpunimeve të vendosura nga institucioni me institucione të tjera të larta arsimore, biznese, organizata, qendra zhvillimi etj. TBU ka krijuar një rrjet të gjerë partneritetesh me kompani dhe institucione të ndryshme, duke synuar të lehtësojë integrimin e studentëve në tregun e punës. Bashkëpunimi me kompani prestigjioze si BALFIN Group, bankat kryesore në Shqipëri (Tirana Bank, Raiffeisen |

[213] 45.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU
[214] 45.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU
[215] 45.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU
[216] 45.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU
[217] 45.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU
[218] 16.3/16.4. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor "Administrim Biznesi " (shqip&anglisht)

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme. | Bank, OTP Bank, etj.), si dhe organizata si: Albanian Microfinance Association, i ofron studentëve mundësi të shumta për punësim dhe zhvillim profesional.[219] Nëpërmjet këtyre partneriteteve, studentët e TBU-së kanë akses në zhvillimin e praktikës profesionale në kompani të ndryshme, duke u mundësuar atyre të fitojnë përvojë praktike në sektorët përkatës.[220] | | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** | |
| | | | | **X** | |

| **Standardi IV.3**<br>**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | TBU disponon literaturë fizike dhe digjitale që ndihmon studentin në përvetësimin e dijeve dhe njohurive sipas programit dhe lëndëve mësimore përkatëse. Programi i studimit ka literaturë të mjaftueshme digjitale dhe fizike. Literatura përkatëse e përcaktuar në silabuset e lëndëve të programit mësimor, është literaturë lehtësisht e disponueshme në Bibliotekën e TBU-së, e cila ka mbi 419 tituj në fushën e menaxhimit, kontabilitetit, financës, auditit dhe marketingut[221]. Gjithashtu, TBU është impenjuar gjithmonë në pasurimin e bibliotekës me tekstet më të fundit.[222] |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. | Institucioni parashikon fonde për pasurimin e literaturës dhe teksteve në bibliotekë. Drejtuesit e njësisë bazë në bashkëpunim me drejtuesit e njësive kryesore dhe pedagogët e lëndëve, bashkëpunojnë për të shtuar literaturën e bibliotekës çdo vit akademik, duke e pasuruar atë me materiale cilësore dhe bashkëkohore në ndihmë të studentëve dhe stafit për një mësimdhënie dhe mësimnxënie sa më cilësore në kolegj.[223] |
| **Kriteri 3.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | Për realizimin e programit të studimit funksionon dhe është biblioteka e TBU e cila luan një rol të rëndësishëm në shërbim të procesit mësimor dhe formimit profesional të studentëve, stafit akademik dhe administrativ. Qëllimi i përdorimit të saj është ofrimi i shërbimeve dhe informimi nëpërmjet burimeve të informacionit dhe mjediseve për të mbështetur kërkimin shkencor, të mësuarit dhe mësimdhënien e TBU- |

[219] 37.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi (Aneks Tabela 5); 37.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programin e studimit BaAB 37.4. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.

[220] 37.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi (Aneks Tabela 5); 37.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programin e studimit BaAB

[221] 48. Rregullore e bibliotekës; 48.1. Inventari i teksteve ne Bibilotekë për fushën e programit të studimit BaAB

[222] 48.2. Proçedura e miratimit të Dokumentit Mbi Proçedurën e Blerjes së Literaturës në TBU

[223] 48.Rregullore e Biblotekës; 48.2. Procedura e miratimit të Dokumentit Mbi Proçedurën e Blerjes së Literaturës në TBU

| | |
|---|---|
| | së.[224] Të gjitha tekstet mësimore ose leksione të shkruara, të cilat zhvillohen në të gjitha programet e studimit gjenden në Bibliotekën e TBU-së. Në funksion të mbështetjes së programeve mësimore, TBU ju garanton studentëve për disiplinat formuese, tekste, skripte, leksione të shkruara si dhe informacion të konfiguruar në ppt në sitet e çdo pedagogu ne LMS.[225] |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Biblioteka gjatë funksionimit të saj është e domosdoshme të ruajë specifikat që kërkohen në përdorimin e literaturës që përbën fondin e saj. Ajo përmban në fondin e saj literaturë nga fusha e së drejtës, ekonomisë dhe shkencave shoqërore e teknike, me qëllim që të plotësojë kërkesat e studentëve për secilin program studimi.[226] Biblioteka është njësi ndihmëse e institucionit dhe ushtron aktivitetin e saj brenda hapësirës së TBU-së. Ajo është në shërbim të procesit mësimor, edukativ, formimit profesional dhe veprimtarisë shkencore të përdoruesve të saj. Biblioteka është në katin I dhe është e shtrirë në një sipërfaqe të mjaftueshme dhe lehtësisht e aksesueshme nga studentët, brenda hapësirës së TBU-së. Biblioteka është e pajisur me fond te caktuar, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të përshtatshme sipas natyrës e specifikës së programeve të studimit. Biblioteka vendos në shërbim të përdoruesve materiale në përshtatje me kërkesat akademike, shkencore për studentët, personelin mësimdhënës akademik dhe administrativ (libra,fjalor,internet). TBU gjithashtu ka te aksesueshme dhe bibliotekën online e cila u vjen në ndihmë studentëve dhe pedagogëve me titujt e shumtë në dispozicion.[227] Salla e bibliotekës në TBU u vjen në ndihmë studentëve jo vetëm për studim, por edhe për fotokopje ose printime të materialeve të ndryshme si: detyra kursi, leksione etj. Biblioteka është pasuruar edhe me revista shkencore në fushën e drejtësisë. Pasurimi i literaturës në përputhje me kurrikulat mësimore është proces i vazhdueshëm, që kryhet nëpërmjet blerjeve të planifikuara, dhurimeve, artikujve shkencore, tezave të diplomave. Biblioteka gjithashtu ka një punonjës të ngarkuar për menaxhimin e saj. |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. | Institucioni ofron literaturë bazë dhe ndihmëse për studentët përmes aksesit në burime akademike të njohura. Biblioteka online EBSCO, e cila ka qenë e disponueshme për studentët e TBU deri në dhjetor 2022, ka siguruar qasje në artikuj shkencorë, revista, libra dhe materiale kërkimore nga fusha të ndryshme studimi. Aktualisht, institucioni po punon për të rinovuar këtë shërbim për vitin akademik 2024-2025 dhe po shqyrton mundësinë e abonimit në bazën e të dhënave Scopus Research. Këto iniciativa dëshmojnë angazhimin e institucionit për të mbështetur |

[224] 49. Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Aneks Tabela 17); 48.1. Inventari i teksteve ne Bibilotekë për fushën e programit të studimit BaAB
[225] 48.1. Inventari i teksteve ne Bibilotekë për fushën e programit të studimit BaAB; 45.3 Guidë për studentët për përdorimin e LMS
[226] 48.1. Inventari i teksteve ne Bibilotekë për fushën e programit të studimit BaAB;
[227] 48.Rregullore e Biblotekes 49. Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Aneks Tabela 17)

| | |
|---|---|
| | studentët me literaturë cilësore dhe të përditësuar, duke lehtësuar proçsin e tyre akademik dhe kërkimor.[228] |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe koBachelorjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. | Biblioteka e TBU-së ka një sallë studimi për studentët e cila ka një kapacitet të mjaftueshëm për të pritur studentët. Biblioteka është e pajisur me kompjutera që kanë internet falas gjithë kohën, kështu që studentët mund ta shfrytëzojnë gjatë gjithë proçeseve në ambjentet e IAL-së. Biblioteka ndodhet në katin e parë të godinës.[229] |
| **Kriteri 7.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | Shërbimi i bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit, përfshirë programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi, me 3 profile. Ky shërbim ofrohet në pesë ditë të javës. Orari i bibliotekës për ditët e Hënë - E Premte është 9.00-20.00. Gjatë sezonit të provimeve shërbimi i bibliotekës është me orar të zgjatur. Me qëllim organizimin dhe mirëfunksionimin e bibliotekës TBU ka edhe një rregullore për këtë qëllim të miratuar nga Senati Akademik i tij.[230] |
| **Kriteri 8.** Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik. | Biblioteka dhe njësia përgjegjëse e programit raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online, përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit sallat e leximit, përpjekjet për pasurimin e fondit fizik dhe atij online etj. Institucioni kryen blerje të reja të literaturës moderne, të teksteve që përdor stafi akademik për lëndën përkatëse, por dhe libra të cilët shërbejnë si literaturë studimore plotësuese e rekomanduar, që në të shumtën e rasteve janë autorë të huaj që janë personalitete të fushës. Këto nevoja përpilohen nga vetë pedagogët e lëndës dhe TBU bën blerjen e tyre.[231] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë | TBU ka të ngritur një sistem të konsoliduar të menaxhimit të institucionit, për të administruar informacionin që lidhet me studentin, |

[228] 45.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, fq.12-13

[229] 44.1 Raporti i MAS për inspektimin e kapaciteteve (2024); 45.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU

[230] 48.Rregullore e Biblotekes

[231] 48.Rregullore e Biblotekes; 49. Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Aneks Tabela 17); 48.2.Procedura e miratimit të Dokumentit Mbi Procedurën e Blerjes së Literaturës në TBU



TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | nga dita e kontaktit me TBU, marrje informacionit, ditën e regjistrimit, sekretarinë mësimore, fillimin e proçesit mësimor, struktura organizative e TBU dhe stafi akademik, informacion mbi programin, zhvillimin dhe vlerësimin e ecurisë nga pedagogu i lëndës, deri te provimet përmbyllëse e diplomimin, komisionin e vlerësimit dhe autoriteti i përfaqësimit të diplomës. Për çdo hallkë të këtij zinxhiri ka strukturë organizative përkatëse që veprimtarinë e vet e ka të ligjëruar me aktet administrative, rregullore, urdhëra e udhëzime të institucionit.[232]<br>Sistemi Pitagora, i zhvilluar nga Rrjeti Akademik Shqiptar (RASH), ofron një zgjidhje të avancuar për menaxhimin e të dhënave akademike dhe administrative në TBU. Ai mundëson regjistrimin dhe administrimin e rezultateve të studentëve, përfshirë notat, mesataret dhe transkriptet akademike, duke automatizuar proceset e sekretarisë mësimore si regjistrimi i studentëve, planifikimi i provimeve dhe lëshimi i diplomave. Në aspektin financiar, Pitagora ndihmon në monitorimin e pagesave të studentëve, faturimin dhe krijimin e raporteve financiare, duke lehtësuar menaxhimin e detyrimeve akademike. Gjithashtu, sistemi mbështet administrimin e burimeve njerëzore, duke përfshirë regjistrimin e stafit akademik, m dhe prodhimin e dokumenteve të punës.[233] Përmes automatizimit të proceseve, transparencës dhe raportimit të avancuar, TBU do të përmirësojë ndjeshëm efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve ndaj studentëve dhe stafit akademik. Me Pitagora, TBU do të ketë një sistem të centralizuar, të sigurt dhe të lehtë për menaxhim, duke modernizuar administrimin akademik dhe financiar në përputhje me standardet më të larta[234] |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | SharePoint është një platformë për menaxhimin e dokumenteve dhe bashkëpunimin që lehtëson ndarjen e informacionit brenda organizatës. Kjo platformë mundëson krijimin e faqeve të brendshme të internetit (intranets), bibliotekave të dokumenteve dhe portaleve të projektit që ndihmojnë në menaxhimin e informacionit dhe proçeset e punës. SharePoint është i integruar me Office 365, duke lehtësuar krijimin dhe ndarjen e dokumenteve nga aplikacionet e njohura të Microsoft-it. Personeli akademik dhe administrative nëpërmjet SharePoint mund të aksesojë në kohë reale të dhëna lidhur me strategjitë, rregulloret, urdhërat administrativ, standartet si dhe çdo informacion apo dokumentacion tjetër lidhur me aktivitetin e personelit akademik, ndihmës akademik dhe partnerët e angazhuar në realizimin e programit.[235]<br>Përsa i përket aktivitetit të personelit akademik dhe ndihmës akademik në sistemin TBU LMS, aty integrohen të dhëna në lidhje me veprimtarinë mësimore si materialet e leksioneve dhe seminareve, detyrat e kursit/esetë, tezat e provimit, rezultatet e vlerësimit etj. Gjithashtu, mbahet komunikim me studentët përmes e-mail, forum/chat etj.[236] |

[232] 49.Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj; 45.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS; 45.3. Guidë për studentët për përdorimin e LMS; 45.4. Trajnime mbi sistemin LMS; 45.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU

[233] 45.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU

[234] 45.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU

[235] 45.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU

[236] 45.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU

TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | Sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit ofron akses të dedikuar dhe informacion lidhur me çdo hap të procesit mësimor. Studentët dhe personeli akademik mund të ruajnë, ndajnë dhe bashkëpunojnë në dokumente në mënyrë të sigurtë. SharePoint ofron një qendër të centralizuar ku mund të aksesohen të gjitha dokumentet e rëndësishme, duke përfshirë manualet, politikët, Proçedurat dhe materialet mësimore. Ndërsa administrata mund të menaxhojnë dokumentet dhe proceset administrative më lehtë dhe më efektivisht. SharePoint mundëson automatizimin e shumë proceseve administrative, duke përfshirë aprovimet dhe rrjedhat e punës.[237] Gjithashtu, studentët kanë akses mbi informacionin e programit të studimit për lëndët përkatëse në të cilat rregjistrohen në platformën TBU LMS.[238]<br>Të gjithë pedagogët dhe stafi administrativ i TBU zotëron dhe menaxhon një adresë e-mail, të unifikuar nën domainin e TBU-së. Kjo postë elektronike, ndër të tjera, shërben si një mjet i brendshëm efektiv komunikimi. Përmes automatizimit të proceseve, transparencës dhe raportimit të avancuar, TBU do të përmirësojë ndjeshëm efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve ndaj studentëve dhe stafit akademik. Me Pitagora, universiteti do të ketë një sistem të centralizuar, të sigurt dhe të lehtë për menaxhim, duke modernizuar administrimin akademik dhe financiar në përputhje me standardet më të larta.[239] |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. | Personeli akademik dhe studentët mund të komunikojnë virtualisht nëpërmjet platformës së posaçme TBU LMS, por gjithashtu edhe nëpërmjet emailit. Në secilin rast, studentëve u vihet në dispozicion çdo lloj materiali lidhur me lëndët e programit të studimit dhe çdo informacion lidhur me përmbushjen e detyrimeve akademike.[240]<br>Për njohjen dhe aftësimin në përdorimin e platformës TBU LMS, vijnë në ndihmë guidat përkatëse të hartuara nga Zyra e IT-së: guidë për pedagogun dhe guidë për studentët si dhe trajnimet e realizuara.[241]<br>Pra, e gjithë kjo platformë shërben si nje mjet komunikimi i brendshëm efikas mes pedagogëve.[242] |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. | Në kuadër të analizës së cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimit ndaj studentëve në TBU, analizohet aktivizimi i çdo pedagogu në platformën interaktive TBU LMS, për lëndët dhe grupet e veta. Me Pitagora, TBU do të ketë një sistem të centralizuar, të sigurt dhe të lehtë për menaxhim, duke modernizuar administrimin akademik dhe financiar në përputhje me standardet më të larta.[243] |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në | Faqja zyrtare e TBU: http://tbu.edu.al është dy gjuhëshe, në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Në të mund të gjenden informacione për kolegjin, programet e studimit, kurrikulën e studimit për çdo program, personelin |

237 45.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU

238 45.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, fq. 2-3; 45.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS; 45.3. Guidë për studentët për përdorimin e LMS; 45.4. Trajnime mbi sistemin LMS;

239 45.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, fq. 13

240 45.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, fq. 2-3

241 45.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS; 45.3. Guidë për studentët për përdorimin e LMS; 45.4. Trajnime mbi sistemin LMS;

242 45.2 Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS

243 45.1. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, fq. 13



TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. | akademik dhe joakademik, aktivitete dhe njoftime të ndryshme. Gjithashtu, dokumentet kryesore dhe materiale të rëndësishme gjenden në web në gjuhën angleze si: Statuti, Rregullore e Përgjithshme e TBU, Raporti Vjetor të Institucionit, e shumë materiale të tjera për ngjarje dhe evente të ndryshme të Institucionit. Informacioni i përgjithshëm bazik i TBU përcillet nëpërmjet të gjitha kanaleve të informimit dhe social media si: Web, Instagram, Linkedin. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| | |
|---|---|
| **Standardi IV.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | TBU, mbështetur në L-AL Nr. 80/2015 Neni 2, 3, 49 dhe Kreu XI, në Kodin dhe Standardet e Cilësisë në Arsimin e Lartë në RSH, në Statutin e TBU-së dhe Rregullores së tij në vijimësi merr të gjitha masat për të siguruar financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për proçesin mësimor-kërkimor për institucionin dhe realizimin e programeve të studimit të tij. TBU, në mbështetje të Ligjit Nr.25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe Standardeve Kontabël Kombëtare, përgatit çdo vit Pasqyrat Financiare (PF) Vjetore.[244] Këto Pasqyra Financiare sigurojnë informacione të rëndësishme dhe të hollësishme për aktivet dhe detyrimet (Pasqyra e Bilancit) e TBU-së, Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve, Pasqyra e Ndryshimeve të Kapitalit, Pasqyra Cash Flow e tjera. Në këto pasqyra dhe informacionet shoqëruese të tyre identifikohen të ardhurat nga tarifat e shkollimit dhe nga burime të tjera, si ato nga studimet dhe projektet, nga trajnime të ndryshme, nga shërbimet, të ardhura nga shërbimet administrative, si dhe nga burime të tjera. Ndërkohë, jepen të plota dhe të detajuara informacionet për drejtimet se ku janë kryer shpenzimet, duke siguruar kostot sipas zërave kryesore të shpenzimeve dhe kryesisht: Kosto e Punës, Kosto e Qirave, Kosto për Kërkimin Shkencor, Kosto e reklamës dhe publicitetit, për mirëmbajtje e riparime, kancelari, amortizimet e tjera.[245] |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën | TBU për çdo vit harton Planin Buxhetor Vjetor dhe afatmesëm (3-vjeçar). Shpërndarja e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre në nivel institucioni dhe sipas njësive kryesore dhe bazë, bëhet mbështetur në kërkesat e LAL nr. 80/2015, Kreu XI. Shpenzimet në buxhet, strukturohen sipas kërkesave dhe parashikimeve të LAL, duke i detajuar përveç në nivel institucioni edhe sipas njësive kryesore dhe njësive bazë të tyre. Shpenzimet e buxhetit të TBU parashikohen të ndara, për një proces mësimor cilësor, për trajtimin ekonomik të stafit, duke mos |

[244] 51.3. Pasqyrat Financiare 2021_2022_2023

[245] 51.1. Të dhëna mbi koston për student (Aneks Tabela 18.1); 51.2. Të ardhura dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2); 51.3. Pasqyrat Financiare 2021_2022_2023; 51.4. Raport auditimi 2021_2022_2023

| | |
|---|---|
| dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë | harruar këtu edhe zbatimin e politikës së institucionit, i cili bën çdo vit përmirësimet e nevojshme të nivelit te pagave për punonjesit e stafit që përmirësojnë nivelin e kualifikimit shkencor, që kanë shënuar arritje në performancën e tyre, ose për shkak të vjetërsisë në punë në TBU për zgjidhjen e nevojave për kryerjen e praktikave mësimore e profesionale të studentëve.[246] |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. | Në TBU, është ngritur dhe funksionon një Sistem Kontrolli i Brendshëm, mbështetur në një sistem dokumentacioni sipas kërkesave të L-AL 80/2015, akteve në zbatim të tij, të Ligjit "Për Kontabilitetin dhe Raportimin Financiar" dhe standardeve kontabël të zbatueshme në zbatim të tij. TBU me persona të specializuar kryen herë pas here Auditime të brendshme, për sektorë dhe problematika me risk.[247] Raportet e auditimit për pjesën e pasqyrave financiare për vitet fiskale 2021,2022 janë kryer nga auditi i pavarur Kreston Albania, ndërsa për vitin 2023 jane kryer nga auditi i pavarur Nexia Albania.[248] |
| **Kriteri 4.** Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. | TBU, për çdo vit akademik në një mbledhje të hapur, të përbashkët, Senati Akademik (SA) dhe Bordi Administrimit, prezanton dhe analizon një përmbledhje me informacionet e Pasqyrave Financiare Vjetore të saj, shoqëruar me raportin e lëshuar nga audituesi i pavarur. Në takim marrin pjesë përfaqësues nga stafi akademik, administrativ dhe studentët. SA, pasi njihet dhe i analizon treguesit dhe rezultatet financiare të paraqitura për vitin buxhetor e fiskal, i miraton me vendim të posaçëm. Përmbledhja e informacioneve të Pasqyrave Financiare Vjetore, shoqëruar me raportin e lëshuar nga Audituesi i pavarur dhe me Vendimin e SA, diskutohen dhe miratohen me Vendim të BA dhe te ortakeve. Pas këtij momenti Pasqyrat Financiare pasi miratohen edhe nga BA dhe ortakët e shoqërisë, dërgohen në Zyrat e Tatimeve dhe Qendrën Kombëtare të Bizneseve (QKB), dhe publikohen. Në Relacionin e PF dhe në Raportin e auditimit financiar, jepen informacione të dedikuara lidhur me politikat dhe masën e tarifave që arkëtohen nga studentët, mënyra dhe drejtimet e përdorimit të tyre, duke i dhënë mundësinë për të gjykuar se burimet financiare përdoren në mbështetje dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimeve të tjera për studentët dhe trajtimin e stafit akademik. Mbështetur në informacionet e 3 viteve të fundit të PF, Zyra e Financës dhe Administratori përgatisin si pjesë e Relacionit të realizimit të treguesve financiarë të vitit edhe një Tabelë të posaçme me të dhënat e detajuara lidhur me të gjithë elementet e shpenzimeve të 3 viteve të fundit dhe planin për vitin në vijim.[249]<br>Nëpërmjet këtyre informacioneve bëhet e mundur dhe vlerësimi i realizimit të programit te studimit, efektiviteti i tij dhe përcaktohen ndërhyrjet e nevojshme për sigurimin e vijimësisë së zhvillimit të |

[246] 51.5. Procedura e miratimit të buxhetit 2023 dhe planit buxhetor 24-27

[247] 51.2. Të ardhura dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2); 51.3. Pasqyrat Financiare 2021_2022_2023; 51.4. Raport auditimi 2021_2022_2023

[248] 51.4.Raport auditimi 2021_2022_2023

[249] 51.4. Raport auditimi 2021_2022_2023; 41. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit BaAB



TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| | programit në të ardhmen dhe garantimin e mbarëvajtjes financiare të tij.[250] |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. | TBU disponon burime financiare sistematike dhe të qëndrueshme që sigurohen nga tarifat dhe pagesat e studentëve. Ndërkohë, investitori grupi Balfin ka financuar sa herë lind nevoja për situatat e krijuara për diferencat midis të ardhurave e shpenzimeve, apo nevojave për të kryer investime, që sigurojnë standardet e nevojshme për realizimin e proçesit mësimor në kushte sa më normale. Burime të dyta modeste janë ato që realizohen nga Projektet që në mënyrë modeste realizon TBU me stafin e tij gjatë veprimtarisë së tij. Në përfundim, duhet nënvizuar se TBU, në vijimësi, ka siguruar një qëndrueshmëri financiare konstante, për sigurinë e realizimit të veprimtarisë akademike.[251] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

[250] 51.3. Pasqyrat Financiare 2021_2022_2023
[251] 53.2. Të ardhura dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2)

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| Standardi V.1<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | TBU ka ndërtuar një sistem të mirëstrukturuar politikash dhe procedurash që mbulojnë të gjithë ciklin akademik të studentëve, duke filluar nga pranimi, ndjekja e programit të studimeve, mbështetja gjatë qëndrimit në institucion, deri në përfundimin e suksesshëm të studimeve dhe diplomimin. Këto politika janë në përputhje të plotë me Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",[252] si dhe me aktet rregullative të brendshme të TBU.[253]<br>Procedura e pranimit të studentëve në programet e ciklit të parë në TBU është e përshkruar në mënyrë të detajuar në dokumentin "Procedura e Pranimit të Studentëve në TBU",[254]<br>Të gjitha informacionet mbi proceset akademike publikohen në faqen zyrtare të institucionit, në materialet informuese të fushatave të promovimit si dhe në mbledhje orientuese për studentët e rinj.<br>Politikat dhe procedurat synojnë të sigurojnë barazi, transparencë dhe trajtim të drejtë për të gjithë studentët, duke u mbështetur në parimin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë në arsimin e lartë. |
| Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | TBU garanton zbatimin e parimit të barazisë dhe të drejtave të barabarta për të gjithë kandidatët dhe studentët.<br>Politikat dhe procedurat përkatëse janë të përshkruara në Statutin e institucionit, Rregulloren e përgjithshme të TBU-së, Rregulloren e programeve të studimit, si dhe në Procedurën e Pranimit të Studentëve. Këto dokumente përcaktojnë qartë detyrimet dhe të drejtat e studentëve, duke siguruar një trajtim të barabartë për të gjithë, mbështetje akademike dhe administrative gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve, si dhe akses të njëjtë në shërbime universitare.[255] |
| Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura | Kriteret dhe kuotat e pranimit i dërgohen zyrtarisht Ministrisë së Arsimit dhe Sportit rreth gjashtë muaj përpara fillimit të vitit akademik, në përputhje me afatet ligjore dhe për të garantuar një proces pranimi të mirëorganizuar dhe transparent. |

[252] 62. Ligji 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH"
[253] 2.Statuti i TBU, 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, 6. Rregullore e Fakultetit te Biznesit dhe Drejtesise, 7. Rregullore e Departamentit te Biznesit dhe Finances, 9. Rregullore e programit të studimit Ba "Administrim Biznesi" (shqip)
[254] 32. Procedura e Pranimit të Studentëve në TBU (Shkëputur nga Rregullore. eTBU)
32.1. Procedura e ndjekur për pranimin e studentëve Ne TBU (Ba AB-IE-IS-IK)
[255] 2.Statuti i TBU, 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, 6. Rregullore e Fakultetit te Biznesit dhe Drejtesise, 7. Rregullore e Departamentit te Biznesit dhe Finances, 9. Rregullore e programit të studimit Ba "Administrim Biznesi" (shqip)
32. Procedura e Pranimit të Studentëve në TBU (Shkëputur nga Rregullore. eTBU)
32.1. Procedura e ndjekur për pranimin e studentëve Ne TBU (Ba AB-IE-IS-IK

| | |
|---|---|
| në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj. | TBU bashkëpunon ngushtë me strukturat shtetërore përgjegjëse për administrimin e Maturës Shtetërore, në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 dhe udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Ky bashkëpunim garanton respektimin e procedurave zyrtare dhe harmonizimin e proceseve të pranimit me sistemin kombëtar të arsimit të lartë.[256]<br><br>Procesi i pranimit në TBU mbështetet në dokumente zyrtare që përcaktojnë qartë numrin e kuotave të pranimit dhe mënyrën e menaxhimit të tyre. Tabela e kuotave sipas trojeve dhe transferimeve përcakton ndarjen e kuotave për çdo program studimi dhe profil të ofruar nga institucioni, në përputhje me vendimet përkatëse të autoriteteve shtetërore.[257]<br><br>Gjithashtu, Procedura për rialokimin e kuotave të pranimit përshkruan mënyrën se si institucioni vepron në rastet kur kuotat e mbetura ose të paplotësuara kalojnë në një fazë të dytë pranimi ose ri-shpërndarjeje, në përputhje me aktet nënligjore dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.[258] |
| Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | TBU zbaton një politikë të qartë dhe transparente për pranimin e studentëve, duke hartuar kritere të veçanta për pranimin, të cilat i dorëzon në Ministrinë e Arsimit dhe i publikon në faqen zyrtare të institucionit. Kuotat e pranimit janë të kufizuara dhe përzgjedhja e kandidatëve realizohet përmes një procesi konkurrues, ku në qendër është cilësia dhe përgatitja e aplikantit.<br><br>Për të informuar në mënyrë sa më gjithëpërfshirëse kandidatët, TBU organizon takime të drejtpërdrejta me maturantë dhe studentë të interesuar, si dhe shpërndan informacion të detajuar në faqen zyrtare të internetit dhe rrjetet sociale.[259]<br><br>Përveç mesatares së ciklit të mëparshëm të studimeve, një rëndësi të veçantë zë niveli i motivimit, njohjes dhe angazhimit të kandidatëve për t'u përballur me kërkesat akademike të TBU. Këto elementë vlerësohen përmes intervistave individuale me stafin akademik dhe përfaqësues të kompanive partnere.[260]<br><br>Përzgjedhja e studentëve të rinj nuk mbështetet vetëm në notat e mëparshme, por edhe në përgatitjen e tyre për të ndjekur një program sfidues, me fokus në zhvillimin profesional dhe përfshirjen në një mjedis dinamik dhe praktik të të nxënit.[261] |

[256] 62. Ligji 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH"
[257] 72.Tabela e kuotave sipas troje, transferime_2024-2025
[258] 72.1. Procedura per rialokimin e kuotave të pranimit 24-25
[259] 32. Procedura e Pranimit të Studentëve në TBU (Shkëputur nga Rregullore. eTBU), 32.1. Procedura e ndjekur për pranimin e studentëve Ne TBU (Ba AB-IE-IS-IK)
[260] 32. Procedura e Pranimit të Studentëve në TBU (Shkëputur nga Rregullore. eTBU), 32.1. Procedura e ndjekur për pranimin e studentëve Ne TBU (Ba AB-IE-IS-IK)
[261] 32. Procedura e Pranimit të Studentëve në TBU (Shkëputur nga Rregullore. eTBU), 32.1. Procedura e ndjekur për pranimin e studentëve Ne TBU (Ba AB-IE-IS-IK)

| | |
|---|---|
| Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | I gjithë procesi i regjistrimit të studentëve në programin e studimit Bachelor në Administrim-Biznes është i standardizuar dhe i ndjekur me përpikëri, duke nisur nga përcaktimi i kritereve të përgjithshme të pranimit, të cilat TBU i harton në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Pas hartimit, kriteret specifike i dërgohen zyrtarisht MAS-it dhe bëhen publike për kandidatët. Procesi i regjistrimit zbatohet në të gjitha fazat e tij në përputhje të plotë me legjislacionin dhe udhëzimet në fuqi, duke garantuar transparencë dhe trajtim të barabartë për të gjithë aplikantët.[262] |
| Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara. | Tirana Business University College (TBU) zbaton një politikë të qartë dhe gjithëpërfshirëse për pranimin e kandidatëve nga grupe të ndryshme shoqërore, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, pakicat dhe shtresat e margjinalizuara. Institucioni garanton akses të barabartë në arsim dhe siguron mbështetje të vazhdueshme për integrimin e tyre të plotë në jetën akademike dhe sociale të universitetit. Çdo vit, TBU harton dhe publikon kritere të veçanta pranimi, të cilat bëhen të aksesueshme përmes faqes zyrtare të institucionit dhe dokumentacionit rregullator përkatës. Kuotat dhe kriteret specifike dërgohen zyrtarisht në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret në fuqi. Përtej procedurave të pranimit, TBU ofron mbështetje akademike, infrastrukturore dhe sociale për të garantuar një përvojë të barabartë studimi për të gjithë studentët, duke reflektuar angazhimin e vazhdueshëm të institucionit ndaj barazisë dhe gjithëpërfshirjes në arsimin e lartë.[263] |
| Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. | Tirana Business University ndjek një politikë të qartë, transparente dhe gjithëpërfshirëse për pranimin e studentëve nga shtete të tjera, duke përcaktuar kritere të posaçme për këtë kategori aplikantësh. Këto kritere përditësohen dhe publikohen çdo vit në faqen zyrtare të institucionit dhe në dokumentet përkatëse rregullatore.[264]<br><br>Kuotat dhe procedurat specifike për pranimin e kandidatëve të huaj i dërgohen zyrtarisht Ministrisë së Arsimit, në përputhje të plotë me legjislacionin dhe aktet nënligjore në fuqi. Procesi i pranimit përfshin verifikimin e diplomave të mëparshme, njohjen e krediteve të fituara më herët dhe plotësimin e kritereve gjuhësore e akademike të përcaktuara nga TBU.[265]<br><br>Për të lehtësuar integrimin e studentëve të huaj në jetën akademike dhe sociale, institucioni ofron mbështetje të vazhdueshme administrative dhe akademike, duke krijuar një mjedis mikpritës dhe të orientuar drejt suksesit të tyre personal e profesional. |
| Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në | TBU zbaton politika të qarta dhe të strukturuara për mbështetjen financiare të studentëve nga shtresa në nevojë, duke garantuar akses të barabartë në arsim |

[262] 32. Procedura e Pranimit të Studentëve në TBU (Shkëputur nga Rregullore e TBU), 14. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore, 14.5. Ditët informuese në TBU, 14.6. Urdhër Rektori për planin e gjimnaz tour 24-25, 50.Politika e Marketingut të TBU për programet e studimit

[263] 72.Tabela e kuotave sipas troje, transferime_2024-2025, 72.1. Procedura per rialokimin e kuotave të pranimit 24-25

[264] 32. Procedura e Pranimit të Studentëve në TBU (Shkëputur nga Rregullore. eTBU), 32.1. Procedura e ndjekur për pranimin e studentëve Ne TBU (Ba AB-IE-IS-IK)

[265] 72.1. Procedura per rialokimin e kuotave të pranimit 24-25, 72. Tabela e kuotave sipas troje, transferime_2024-2025

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. | përmes bursave dhe lehtësirave të posaçme. Këto skema mbështesin si përparësitë sociale, ashtu edhe programet me rëndësi strategjike për institucionin dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Bursat përcaktohen dhe publikohen çdo vit, bazuar në kritere akademike dhe sociale, në përputhje me udhëzimet e MAS. Në bashkëpunim me partnerë publikë e privatë, TBU krijon mundësi shtesë financimi për studentët më të mirë dhe ata në kushte të vështira.[266] |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.** | |
|---|---|
| Kriteret | Vlerësimi |
| Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | TBU siguron informacion të qartë dhe të detajuar mbi kriteret dhe procedurat që lidhen me përparimin akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit studimi në tjetrin. Ky informacion përfshihet në rregulloren mësimore të programit përkatës si dhe në aktet e tjera rregullatore të institucionit.[267]<br>Në fillim të çdo viti akademik, stafi akademik i TBU organizon sesione informuese për të orientuar studentët mbi rregullat dhe kriteret akademike. Gjatë gjithë vitit, stafi akademik dhe administrativ qëndron i gatshëm për të ofruar mbështetje dhe sqarime për çdo paqartësi. Studentët kanë akses të vazhdueshëm në rezultatet dhe progresin e tyre përmes platformës online LMS.[268]<br>Studentët kanë gjithmonë mundësi të kërkojnë këshillim ose informacion nga stafi akademik, administrativ apo këshilltari akademik[269] në lidhje me rregullat dhe procedurat përkatëse. |
| Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | Kriteret dhe procedurat për njohjen e kualifikimeve të mëparshme apo të studimeve të pjesshme janë të përshkruara në mënyrë të qartë dhe të strukturuar në dokumentet rregullatore të TBU-së. Procesi i njohjes bazohet në vlerësimin e përputhshmërisë së njësive mësimore, krediteve dhe rezultateve të të nxënit me kurrikulat e TBU-së, duke garantuar transparencë, objektivitet dhe barazi për të gjithë aplikantët.[270]<br>Zyra e Çështjeve Studentore, në bashkëpunim me departamentet akademike përkatëse, informon studentët në mënyrë të vazhdueshme mbi kriteret dhe procedurat për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve. Studentëve që shprehin interes për transferim u ofrohet mbështetje individuale dhe informacion i detajuar mbi dokumentacionin e nevojshëm, kriteret e pranimit |

[266] 61.1. Vendim për tarifat dhe bursat e studentëve për vitin 24-25, 61.2. Tarifat dhe bursat VA 2024-2025, 61.3. Të dhëna për shpërndarjen e bursave ndër vite, 61.4. Kontratë dhurimi Mane Foundation dt.9.11.23, 61.5. Kontratë dhurimi Mane Foundation_TBU studenti Klejvi Pero 24-25, 61.6. Skema e bursave sociale në TBU

[267] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU , 6. Rregullore e Fakultetit te Biznesit dhe Drejtesise, 7. Rregullore e Departamentit te Biznesit dhe Finances

[268] 45.1 Udhëzues për përdorimin e teknologjisë të informacionit

[269] 14.7.1 Plan Pune Këshilltari Akademik FBD-FTI, 14.7. Rrregullore e Këshillimit Akademik

[270] 33. Rregullore per Transferimin e studimeve



TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| | dhe hapat për formalizimin e procesit, duke siguruar transparencë dhe udhëzim të qartë gjatë gjithë procedurës.[271] |
| Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Për të siguruar kuptueshmëri dhe akses, TBU organizon në fillim të vitit sesione informuese mbi metodologjinë e vlerësimit, testimet dhe kriteret e provimeve. Studentët marrin mbështetje nga stafi akademik dhe administrativ gjatë gjithë vitit, veçanërisht në periudhën e provimeve. Procesi i vlerësimit zbatohet në përputhje me rregulloret institucionale dhe udhëzimet e MAS, duke garantuar standardizim, transparencë dhe objektivitet. TBU garanton informim të qartë dhe transparent për studentët mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit, të cilat janë të përcaktuara në Rregulloren e Programeve të Studimit dhe të aksesueshme në faqen zyrtare të institucionit.[272] |
| Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | TBU u garanton studentëve transparencë dhe akses të vazhdueshëm në lidhje me të gjitha kriteret dhe procedurat që lidhen me përgatitjen e punimit të diplomës dhe procesin e diplomimit. Këto janë të përfshira në rregulloret përkatëse të institucionit dhe të programit të studimit. Në funksion të informimit të plotë, organizohen takime dedikuara nga stafi akademik, ku studentët udhëzohen mbi hapat, afatet dhe kërkesat akademike që duhet të përmbushin. Për çdo paqartësi, stafi akademik dhe administrativ qëndron në dispozicion përgjatë gjithë vitit akademik.[273] |
| Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | Gjatë gjithë vitit, TBU zhvillon aktivitete promovuese dhe informuese për t'i ndihmuar maturantët dhe studentët e ardhshëm të marrin vendime të informuara për zgjedhjen e studimeve. Në këtë kuadër, universiteti formon grupe pune me pedagogë dhe studentë që marrin pjesë në evente dhe aktivitete në qytete të ndryshme të vendit, përfshirë Panairin Work & Study. Në këto aktivitete prezantohen programet akademike, kushtet dhe shërbimet për studentët, me qëllim sigurimin e një informacioni të plotë dhe të qartë, i cili ndihmon maturantët të zgjedhin në mënyrë të përgjegjshme dhe të ndërgjegjshme.[274]<br>TBU organizon edhe evente të posaçme ku maturantët mund të vizitojnë institucionin, të ndjekin orë mësimi dhe të njihen më nga afër me ambientin akademik.[275]<br>Gjatë regjistrimeve, TBU ofron grupe pedagogësh për secilin fakultet që informojnë mbi programet, kohëzgjatjen, rregulloren, mundësitë e punësimit dhe transferimet. Universiteti bashkëpunon ngushtë me partnerët e biznesit për të promovuar programet dhe ofron informacion të detajuar në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

**Standardi V.3**

---

[271] 14. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore

[272] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU , 6. Rregullore e Fakultetit te Biznesit dhe Drejtesise, 7. Rregullore e Departamentit te Biznesit dhe Finances

[273] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, 10. Formati i tezës së provimit përfundimtar, 11. Udhëzim për përgatitjen e temës së diplomës

[274] 50. Politika e Marketingut të TBU për programet e studimit, 14. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore, 14.5. Ditët informuese në TBU, 14.6 Urdhër Rektori për planin e gjimnaz tour 24-25

[275] 14.5. Ditët informuese në TBU

| Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit. | |
|---|---|
| Kriteret | Vlerësimi |
| Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. | Studentët marrin informacion të detajuar mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programeve të studimit përmes disa kanalesh zyrtare dhe të besueshme, që sigurojnë qartësi dhe transparencë gjatë gjithë ciklit të studimeve. Këto përfshijnë:<br>• Këshillimin individual me stafin akademik në momentin që shprehin interes për një program të caktuar;[276]<br>• Mbështetjen dhe informacionin e ofruar nga Zyra e Çështjeve Studentore, e cila asiston gjatë gjithë procesit të orientimit dhe regjistrimit;[277]<br>• Rregulloren akademike të programit, ku përcaktohen në mënyrë të qartë struktura e kurrikulës, llojet e moduleve, vlerësimi dhe kriteret e përfundimit të studimeve;[278]<br>• Kontratën e studimit, e cila nënshkruhet në momentin e regjistrimit dhe përmban të gjitha të drejtat dhe detyrimet e studentit dhe institucionit. |
| Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | Programi i studimit, së bashku me strukturën e lëndëve dhe moduleve përkatëse, i vihet në dispozicion studentëve që në momentin e regjistrimit dhe mbetet i aksesueshëm në faqen zyrtare të TBU. Në fillim të çdo semestri, studentët pajisen me programet mësimore të lëndëve që do të ndjekin, të cilat përmbajnë informacion të detajuar mbi ngarkesën mësimore, temat javore, literaturën bazë dhe shtesë, format e vlerësimit, si dhe kriteret e frekuentimit të detyrueshëm.[279]<br><br>Përmes platformës elektronike LMS, studentët kanë akses të vazhdueshëm në materialet mësimore, temat, detyrat dhe diskutimet akademike, duke mundësuar ndjekjen aktive të procesit mësimor. Gjithashtu, gjatë përzgjedhjes së lëndëve me zgjedhje në vitin e dytë, pedagogët përgjegjës ofrojnë sqarime shtesë mbi përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të secilës lëndë, për të ndihmuar studentët në marrjen e një vendimi të informuar.<br><br>Gjithashtu, në silabuset e secilës lëndë janë të përcaktuara në mënyrë të qartë ngarkesa mësimore, temat javore, literatura bazë dhe e rekomanduar, format e vlerësimit si dhe kriteret e frekuentimit të detyrueshëm, duke u ofruar |

[276] 14.5. Ditët informuese në TBU
[277] 14. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore
[278] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU , 6. Rregullore e Fakultetit te Biznesit dhe Drejtesise, 7. Rregullore e Departamentit te Biznesit dhe Finances
[279] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU , 6. Rregullore e Fakultetit te Biznesit dhe Drejtesise, 7. Rregullore e Departamentit te Biznesit dhe Finances

| | |
|---|---|
| | studentëve një udhëzues të plotë për ndjekjen e lëndës dhe arritjen e objektivave mësimore.[280] |
| Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | Zyra e Çështjeve Studentore në TBU luan një rol kyç në informimin dhe orientimin e studentëve lidhur me mundësitë e punësimit dhe zhvillimit të karrierës. Ajo vepron si urë lidhëse mes studentëve dhe punëdhënësve me të cilët universiteti ka marrëveshje bashkëpunimi, duke promovuar mundësi për praktika profesionale, punësim të drejtpërdrejtë apo avancim në karrierë për studentët që tashmë janë të punësuar.[281]<br><br>Zyra mban kontakte të vazhdueshme me partnerët e biznesit dhe institucionet bashkëpunëtore për të identifikuar dhe shpërndarë mundësi aktuale për studentët. Për më tepër, TBU organizon rregullisht panaire pune dhe aktivitete dedikuar karrierës, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga sektori privat dhe publik, për të ndihmuar studentët të lidhen drejtpërdrejt me tregun e punës.[282]<br><br>Informimi bëhet në mënyrë të vazhdueshme përmes njoftimeve, komunikimeve zyrtare dhe eventeve të dedikuara. Treguesit pozitivë të punësimit të studentëve të këtij programi, të pasqyruar në pjesë të tjera të këtij raporti, janë dëshmi e angazhimit të TBU për mbështetjen e vazhdueshme të studentëve në integrimin e tyre profesional.[283] |
| Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | Që në momentin e regjistrimit, studentët pajisen me informacion të plotë, të përditësuar dhe të aksesueshëm mbi organizimin e procesit mësimor, infrastrukturën dhe shërbimet mbështetëse që ofron TBU. Sekretaria e Studentëve[284] mban komunikim të vazhdueshëm me studentët përmes email-it dhe kontaktit telefonik, duke i informuar mbi përmbajtjen e programit të studimit, lëndët, modulet, oraret dhe aktivitetet akademike. Çdo ndryshim në organizim apo në ecurinë e procesit mësimor njoftohet në mënyrë zyrtare dhe në kohë reale nga kjo zyrë.<br><br>Gjithashtu, informacioni mbi kalendarin akademik[285] dhe zhvillimet e tjera akademike shpërndahet rregullisht përmes postës elektronike dhe platformës LMS [286], duke garantuar transparencë dhe akses të lehtë për të gjithë studentët.<br><br>Përveç informimit të vazhdueshëm, studentët njihen me ambientet, logjistikën dhe shërbimet mbështetëse të universitetit edhe përpara fillimit të |

[280] 22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit – BaAB (shqip & anglisht)
[281] 37. Rregullore e praktikës mësimore & dokumentat përkatëse, 37.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi (Aneks Tabela 5), 37.5. Vendimet për përcaktimin e Pedagogut-pedagogëvve Udhëheqës për Praktikat Mësimore për vitin 24-25 FBD
[282] 14.2. Panairi i punës 2024 (ftese), 37.2 Memorandum TIP_TBU_Subjekt, 37.4 Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit
[283] 35. Të dhëna për punësimin real të studentëve 22-24 (Aneks Tabela 23)
[284] 8. Rregullore për Sekretarinë Mësimore
[285] 12.1. Kalendari akademik 2022-2023, 12.2. Kalendari akademik 2023-2024, 12.3. Kalendari akademik 2024-2025
[286] 45.1. Udhëzues për përdorimin e teknologjisë të informacionit, 45.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS, 45.3. Guidë për studentët për përdorimin e LMS, 45.4. Trajnime mbi sistemin LMS



TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| | vitit akademik, nëpërmjet takimeve informuese dhe një sesioni të dedikuar mirëseardhjeje që organizohet posaçërisht në fillim të çdo viti akademik. |
| **Kriteri 5.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | Në momentin e regjistrimit, studentët e TBU-së pajisen nga Zyra e IT me një adresë zyrtare e-maili institucionale, përmes së cilës marrin të gjitha komunikimet zyrtare nga sekretaria dhe strukturat akademike. Paralelisht, përmes platformës LMS, studentët sigurojnë akses të menjëhershëm në orarin personal, materialet mësimore dhe njoftimet përkatëse nga pedagogët. Platforma gjithashtu u mundëson komunikim të strukturuar dhe efikas me stafin akademik duke mbështetur organizimin dhe ndjekjen e procesit mësimor në mënyrë të vazhdueshme.[287] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. | Lista emërore e studentëve të TBU-së ruhet në format elektronik në sekretarinë mësimore dhe është e ndarë sipas viteve akademike dhe profileve të studimit. Të dhënat përditësohen rregullisht dhe shërbejnë si bazë për përpilimin e statistikave vjetore për çdo program studimi, duke përfshirë numrin e studentëve të regjistruar, të diplomuar dhe të punësuar gjatë apo pas përfundimit të studimeve. Këto statistika janë të detajuara sipas profileve dhe analizohen për të vlerësuar cilësinë dhe progresin akademik të studentëve. Treguesit përkatës përfshihen në raportet vjetore të TBU dhe përdoren për qëllime të monitorimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm.[288] |
| **Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | TBU mbledh dhe administron në mënyrë të vazhdueshme të dhëna të detajuara mbi ecurinë e studentëve për çdo program studimi, duke përfshirë regjistrimet, transferimet, çregjistrimet, nivelin e kalueshmërisë, cilësinë në hyrje dhe dalje, si dhe shkallën e punësimit pas diplomimit. Këto të dhëna përditësohen rregullisht dhe shërbejnë si bazë për analiza që synojnë monitorimin dhe përmirësimin e progresit akademik dhe zhvillimit profesional të studentëve. Sekretaria mësimore është në gjendje të prodhojë në çdo moment raportime të personalizuara për arritjet e studentëve, sipas kërkesës së tyre apo të strukturave përkatëse. Informacioni i agreguar për regjistrimet, diplomimet, punësimin dhe rezultatet akademike për secilin program përfshihet gjithashtu në raportet vjetore të institucionit.[289] |

[287] 45.1. Udhëzues për përdorimin e teknologjisë të informacionit
[288] 55.1. Raporti vjetor institucional 2021-2022, 55.2. Raporti vjetor institucional 2022-2023, 55.3. Raporti vjetor institucional 2023-2024, 35. Të dhëna për punësimin real të studentëve 22-24 (Aneks Tabela 23), 31. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin (Aneks Tabela 21 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB)
54.2. Raporti vjetor i DBF 23-24
[289] 55.1. Raporti vjetor institucional 2021-2022, 55.2. Raporti vjetor institucional 2022-2023, 55.3. Raporti vjetor institucional 2023-2024, 35. Të dhëna për punësimin real të studentëve 22-24 (Aneks Tabela 23), 31. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin (Aneks Tabela 21 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB), 54.2. Raporti vjetor i DBF 23-24

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | Çdo student në TBU ka një dosje individuale, ku ruhen të gjitha të dhënat që nga momenti i regjistrimit deri në përfundim të studimeve. Këto të dhëna administrohen në mënyrë të dyfishtë: në sistemin elektronik të menaxhimit të studentëve dhe në regjistrat fizikë të përditësuar nga stafi administrativ. Dosjet përmbajnë informacion mbi regjistrimet, notat, frekuentimin, transferimet dhe diplomimin. Administrimi i të dhënave kryhet nga Sekretaria Mësimore dhe Zyra e Regjistrimit, duke garantuar përditësim të vazhdueshëm, verifikueshmëri dhe siguri sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Akses në këto të dhëna kanë vetëm personat e autorizuar. Me kërkesë të studentit apo të strukturave akademike, informacioni mbi ecurinë individuale mund të gjenerohet në çdo kohë për qëllime raportimi ose vlerësimi.[290] |
| **Kriteri 4.** Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. | Të dhënat statistikore për secilin student, nga momenti i regjistrimit deri në diplomim, ruhen në format elektronik dhe në regjistrat përkatës të Sekretarisë Mësimore. Institucioni ka në funksion një sistem të strukturuar monitorimi dhe vlerësimi të dokumentacionit dhe informacionit që lidhet me aktivitetin akademik të studentëve.<br><br>Kontrolle të rregullta realizohen, sipas akteve të brendshme, mbi funksionimin e njësive përgjegjëse, përfshirë sekretaritë mësimore dhe sistemin e menaxhimit të informacionit. Këto auditime garantojnë integritetin, përditësimin dhe sigurinë e të dhënave, si në formatin elektronik, ashtu edhe në atë fizik. Aksesin në të dhëna e kanë vetëm personat e autorizuar, në përputhje me standardet e transparencës, sigurisë dhe kërkesave ligjore në fuqi.[291] |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | Departamenti kryen në mënyrë të vazhdueshme analiza mbi cilësinë e studentëve, si në hyrje ashtu edhe në dalje nga programet e studimit, me qëllim vlerësimin e arritjes së objektivave formues të përcaktuara për secilin program. Këto analiza pasqyrohen në raporte të strukturuara që shqyrtojnë rezultatet e të nxënit dhe përgatitjen profesionale të studentëve, duke nxjerrë në pah prirjet dhe sfidat e evidentuara gjatë ciklit akademik. Gjetjet përfshihen në raportet vjetore të departamentit [292]dhe të TBU-së[293], dhe shërbejnë si bazë për vendimmarrje në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së ofrimit të programeve. |

[290] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU , 8. Rregullore për Sekretarinë Mësimore, 57. Rregullore e Arkivës
[291] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU , 8. Rregullore për Sekretarinë Mësimore, 57. Rregullore e Arkivës
[292] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU , 8. Rregullore për Sekretarinë Mësimore, 57. Rregullore e Arkivës
[293] 31. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin (Aneks Tabela 21 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB) , 54.2. Raporti vjetor i DBF 23-24, 55.1. Raporti vjetor institucional 2021-2022, 55.2. Raporti vjetor institucional 2022-2023, 55.3. Raporti vjetor institucional 2023-2024.

| | |
|---|---|
| | Në bazë të këtyre analizave, hartohen propozime konkrete për ndërhyrje dhe përmirësime që synojnë rritjen e cilësisë së programeve të studimit dhe përafrimin e tyre me kërkesat aktuale dhe të ardhshme të tregut të punës.[294] |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi V.5<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. | TBU nxit përfshirjen aktive të studentëve në vendimmarrje dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të mjedisit akademik. Në përputhje me Statutin e TBU-së[295], studentët kanë përfaqesuesit e tyre në disa organe kolegjiale dhe njësi të TBU: në Senatin Akademik, në Komisionin e Cilësisë në Nivel Institucional dhe në Komisionin e Cilesisë në nivel njësie kryesore, në Komisionin për Marrëdhëniet me studentët në nivel Institucioni dhe Komisionin për Marrëdhëniet me studentet në nivel njësie kryesore dhe në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC)[296] |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | TBU garanton që përfshirja e studentëve në vendimmarrje, këshillim dhe vlerësimin e procesit akademik të jetë reale, konkrete dhe e matshme, përmes mekanizmave efektivë që mundësojnë rezultate të verifikueshme dhe ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimet institucionale.[297]<br>Në përfundim të çdo semestri, studentët kryejnë vlerësimin anonim të pedagogëve me të cilët kanë ndjekur lëndët përkatëse. Të dhënat e mbledhura nga pyetësorët analizohen dhe përdoren si instrument i rëndësishëm për identifikimin e fushave me nevojë për përmirësim dhe për rritjen e cilësisë së procesit mësimor.[298]<br>Përveç vlerësimit elektronik, një instrument plotësues dhe efektiv janë grupet e fokusit (Focus Groups), nëpërmjet të cilave studentë të programeve përkatëse diskutojnë në mënyrë të strukturuar shqetësimet, përvojat dhe pritshmëritë e tyre në lidhje me aspektet akademike dhe administrative të TBU-së.[299]<br>Përveç pjesëmarrjes së studentëve në organet vendimarrëse të përmendura në kriterin 1më sipër, studentët kanë zë të fuqishëm për çdo element që ka lidhje me mësimdhënien. Përfaqesuesit e studentëve në çdo rast dhe në çdo kohë mund të kontaktojnë lehtësisht përfaqësues të autoriteteve vendimarrëse në TBU për të shprehur shqetësimet e tyre, apo për të dhënë këshilla në lidhje me problemet që i shqetësojnë. Të dhënat e mbledhura nga këto instrumente |

[294] 54.1. Plani vjetor i DBF 23-24, 54.2. Raporti vjetor i DBF 23-24
[295] 2. Statuti i TBU
[296] 60.1. Perfshirja e studenteve ne qeverisjen e TBU
[297] 60.1. Perfshirja e studenteve ne qeverisjen e TBU
[298] 36.4..Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e pyetesorit nga studentet, 36.6. Formati i pyetësorit për vlerësimin e lëndës & pedagogut nga studentët
[299] 36.5. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e fokus grupeve, 36.7. Raporti i Fokus Grupeve

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| | analizohen dhe diskutohen në nivel drejtues të institucionit, duke mundësuar identifikimin e sfidave dhe marrjen e masave për përmirësim të vazhdueshëm.[300] |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj. | Programi i studimit Bachelor në Administrim Biznesi, me një ngarkesë totale prej 180 ECTS, është konceptuar për t'u përshtatur me ritmin dhe kapacitetin e studentëve. Mësimi zhvillohet përmes metodave të ndryshme dhe fleksibile, duke ofruar mundësi për adaptim në aspektin kurrikular, metodologjik dhe kohor. Kjo qasje synon të mbështesë arritjen e qëllimeve individuale dhe zhvillimin efektiv të njohurive dhe aftësive të studentëve.[301]Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen aktive të studentëve në zhvillimin, rishikimin dhe avancimin e programeve të studimit në mënyrë të vazhdueshme dhe të organizuar. Ky bashkëpunim realizohet përmes disa mënyrave, duke u siguruar që idetë dhe kontributet e tyre të pasqyrohen në përmirësimin e standardeve akademike:[302]<br><br>• **Pyetësorë periodikë**[303] – zhvillohen në fund të çdo semestri për të gjitha programet, ciklet, lëndët dhe mësimdhënësit. Studentët vlerësojnë përmbajtjen, qartësinë dhe aktualizimin e silabuseve, metodat e mësimdhënies si dhe mbështetjen nga pedagogët.<br>• **Grupet fokus** – krijohen për të diskutuar më në detaje përvojat akademike të studentëve, sfidat që ata hasin dhe propozimet për përmirësim.[304]<br>• **Mbledhje të hapura të departamenteve** – ofrojnë mundësi për dialog të drejtpërdrejtë midis studentëve dhe stafit akademik, duke lehtësuar identifikimin dhe zgjidhjen e çështjeve që kanë lidhje me programet e studimit.<br><br>Të dhënat dhe rekomandimet e mbledhura përpunohen dhe diskutohen në organet akademike vendimmarrëse, duke mundësuar përmirësime konkrete dhe të matshme në programet e studimit, në funksion të rritjes së cilësisë dhe përputhshmërisë me nevojat e tregut të punës.[305] |
| **Kriteri 4.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | Procesi i vlerësimit dhe kontrollit të dijeve bazohet në parimet e transparencës, ndershmërisë dhe barazisë, duke garantuar të drejtën e studentëve për të shprehur mendimin e tyre dhe për të kërkuar rishikim të rezultateve. Rregullat e këtij procesi përcaktohen qartë në rregulloret e brendshme dhe në silabuset e secilës lëndë, për të siguruar qartësi dhe parashikueshmëri në çdo fazë. |

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

300 36.1.3 Raporti vjetor i NJSBC 24-25, 36.3.3. Raporti vjetor i KSC FBD 23-24

301 16.1. Kurrikula e programit Ba "Administrim Biznesi" (shqip), 16.2. Kurrikula e programit Ba "Administrim Biznesi" (anglisht), 16.3. Plani mësimor i programit të studimit Ba "Administrim Biznesi "(shqip), 16.4. Plani mësimor i programit të studimit Ba "Administrim Biznesi"(anglisht), 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – Ba "Administrim Biznesi "

302 36.4. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e pyetesorit nga studentet

303 36.6. Formati i pyetësorit për vlerësimin e lëndës & pedagogut nga studentët

304 36.5. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e fokus grupeve, 36.7. Raporti i Fokus Grupeve

305 36.7. Raporti i Fokus Grupeve, 36.1.3. Raporti vjetor i NJSBC 23-24, 36.3.3 Raporti vjetor i KSC FBD 24-25

| | |
|---|---|
| | Në mënyrë që të ruhet anonimiteti dhe objektiviteti, provimet zhvillohen me procedura sekretimi, ndërsa pedagogu argumenton vlerësimin e dhënë përmes komenteve dhe shpjegimeve mbi kriteret e aplikuara. Për më tepër, organizohen seanca informuese që ndihmojnë studentët të kuptojnë në detaje rezultatet e tyre.<br><br>Studentët kanë të drejtë të parashtrojnë ankim dhe të kërkojnë rivlerësim përmes një komisioni të posaçëm, i cili shqyrton me kujdes kërkesat dhe rezultatet e provimeve. Për të siguruar një proces të drejtë dhe të transparencë, kërkesat e studentëve trajtohen në mënyrë të organizuar, përmes plotësimit të formularëve përkatës, duke krijuar një sistem të besueshëm dhe të kontrollueshëm për të gjithë.[306] |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi V.6<br>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. | Tbu ka ngritur struktura të dedikuara dhe procedura të mirëpërcaktuara për informimin dhe mbështetjen e studentëve, duke filluar nga Sekretaria Mësimore e deri te njësitë kryesore dhe bazë akademike, të cilat veprojnë në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe janë gjithmonë në shërbim të studentëve. Çdo njësi bazë, që mbulon programin e studimit, ndjek në mënyrë të vazhdueshme e sistematike ecurinë akademike të studentëve që nga momenti i regjistrimit deri në diplomim, duke garantuar që mbështetja të jetë e vazhdueshme dhe e përshtatur me nevojat e tyre individuale.Studentët kanë mundësi të kërkojnë informacion dhe këshillim për çështje të ndryshme që lidhen me programin e studimit ose me aspekte të tjera të përfshirjes së tyre akademike dhe institucionale, duke iu drejtuar lirshëm çdo anëtari të stafit akademik që ata e konsiderojnë të përshtatshëm. Përtej këtyre mekanizmave, Tbu ka ndërtuar edhe strukturën e këshilltarit akademik, si një hallkë kyçe për orientimin dhe ndjekjen e studentëve gjatë gjithë periudhës së studimeve. Është caktuar një këshilltar akademik nga fakulteti, të cilit mund t'i drejtohet në çdo kohë për çështje që lidhen me planifikimin e studimeve, përzgjedhjen e lëndëve, vështirësitë akademike, si dhe për këshillim të përgjithshëm që ndihmon në përmirësimin e përvojës së tyre studentore.[307] |

[306] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, 6. Rregullore e Fakultetit te Biznesit dhe Drejtesise, 7. Rregullore e Departamentit te Biznesit dhe Finances, 8. Rregullore për Sekretarinë Mësimore, 22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit – BaAB (shqip & anglisht)

[307] 14.7. Rrregullore e Këshillimit Akademik



TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| | Kjo strukturë synon të forcojë komunikimin dhe lidhjen ndërmjet studentit dhe stafit akademik, duke siguruar një mbështetje të vazhdueshme, të personalizuar dhe të aksesueshme për të gjithë.[308] |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | TBU ka vendosur në funksion një sistem të strukturuar dhe efikas për informimin[309], këshillimin dhe ndjekjen e vazhdueshme të përparimit akademik të studentëve. Ky sistem operon nëpërmjet zyrave administrative[310] dhe strukturave specifike brenda çdo departamenti, duke siguruar një mbështetje të plotë dhe të koordinuar për të gjitha aspektet që lidhen me procesin mësimor dhe zhvillimin akademik të studentit.[311]<br><br>Në kushtet e një numri të moderuar studentësh, Tirana Business University (TBU) ofron një qasje të personalizuar dhe të individualizuar për secilin student, çka i mundëson institucionit të jetë më afër nevojave konkrete të tyre. Studentëve u ofrohet asistencë e vazhdueshme në çdo hap të rrugëtimit të tyre akademik përmes mekanizmave të qartë, të thjeshtë në përdorim dhe të aksesueshëm, duke kontribuar në një përvojë studimore gjithëpërfshirëse, të orientuar drejt rezultateve dhe suksesit personal e profesional. |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | TBU ka zhvilluar dhe vënë në funksion një sistem të integruar këshillimi për karrierën, i cili zbatohet nëpërmjet Zyrës së Çështjeve Studentore[312] dhe strukturave përkatëse brenda secilit departament akademik. Kjo zyrë luan një rol qendror në ofrimin e asistencës për studentët, duke i orientuar ata drejt mundësive të punësimit, praktikave profesionale dhe përfshirjes në aktivitete akademike dhe ekstrakurrikulare brenda dhe jashtë vendit.<br><br>Në bashkëpunim të ngushtë me rrjetin e partnerëve institucionalë dhe të biznesit të TBU-së, Zyra e Çështjeve Studentore ndjek procesin e identifikimit dhe përshtatjes së studentëve me pozicionet më të përshtatshme, që nga faza e praktikave profesionale e deri në integrimin e tyre në tregun e punës. Gjithashtu, ajo mbështet studentët në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për aplikime, në ndërtimin e profilit profesional dhe në navigimin e mundësive të karrierës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.<br><br>Në kuadër të këtij angazhimi, TBU organizon panaire punësimi [313]dhe forume ndërveprimi me aktorë të tregut të punës, duke krijuar një hapësirë dinamike për ndërmjetësimin mes studentëve dhe punëdhënësve potencialë.[314]<br><br>Në mënyrë të veçantë, Fakulteti i Biznesit dhe Drejtësisë ka emëruar gjithashtu një Këshilltar Akademik, i cili luan një rol të rëndësishëm në mbështetjen e studentëve gjatë gjithë ciklit të tyre të studimeve. Ky këshilltar |

[308] 14.7.1. Plan Pune Këshilltari Akademik FBD-FTI
[309] 14. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore
[310] 8. Rregullore për Sekretarinë Mësimore
[311] 14.7. Rrregullore e Këshillimit Akademik. 14.7.1. Plan Pune Këshilltari Akademik FBD-FTI
[312] 14. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore
[313] 14.2. Panairi i punës 2024 (ftese)
[314] 14.3. Aktivitete të realizuara nga ZÇS për studentët Ba, 14.4. Aktivitete bashkëpunime me biznesin për studentët Ba

| | |
|---|---|
| | ofron orientim në lidhje me strukturën e programit, përzgjedhjen e lëndëve, ndjekjen e ecurisë akademike dhe zgjidhjen e çështjeve që lidhen me përmbajtjen dhe zhvillimin e studimeve universitare. Studentët mund t'i drejtohen këtij këshilltari në çdo moment për të marrë udhëzime të qarta dhe të personalizuara, çka e bën këtë rol një hallkë kyçe në forcimin e përvojës akademike dhe në rritjen e suksesit të tyre në studime.[315] |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | Zyra e Çështjeve Studentore mban lidhje të vazhdueshme me të diplomuarit, duke ndërtuar dhe përditësuar një bazë të dhënash të strukturuar mbi statusin e tyre të punësimit apo ndjekjen e studimeve pasuniversitare, brenda dhe jashtë vendit. Kjo bazë të dhënash shërben si instrument për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave mbi shkallën dhe cilësinë e integrimit profesional të ish-studentëve, duke ofruar informacion të vlefshëm për studentët aktualë, stafin akademik dhe strukturat drejtuese të institucionit. Tirana Business University ka krijuar një rrjet aktiv Alumni, i cili kontribuon në ndërtimin e një urë komunikimi ndërmjet përvojave të ish-studentëve dhe nevojave të zhvillimit të programeve të studimit. Alumni përfshihen në mënyrë të strukturuar në Bordet e Tregut të Punës pranë Departamenteve, duke ofruar input të drejtpërdrejtë mbi përputhshmërinë e kurrikulave me kërkesat e tregut të punës dhe trendet më të fundit profesionale. Kjo përfshirje siguron që ofertat akademike të institucionit të jenë gjithmonë në përmirësim të vazhdueshëm dhe në linjë me zhvillimet bashkëkohore.[316] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

[315] 14.7. Rrregullore e Këshillimit Akademik, 14.7.1 Plan Pune Këshilltari Akademik FBD-FTI

[316] 14.1. Vendim Dekanati për Bordin e Tregut të Punës FBD, 14.1.1. Axhenda e Takimit me BTP 2023-2024, 14.1.2. FBD - PROTOKOLL - Mbledhje BTP

# VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

| **Standardi VI.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | Në përputhje me Nenin 103 të Ligjit nr. 80/2015 [317]"Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe me Statutin e TBU-së[318], institucioni ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), si struktura përgjegjëse për garantimin dhe përmirësimin e cilësisë në të gjitha programet e studimit. Kjo njësi përbëhet nga anëtarë të zgjedhur nga Senati Akademik dhe funksionon me autonomi operative, duke pasur akses të plotë në të dhënat institucionale dhe duke raportuar drejtpërdrejt pranë Senatit Akademik.<br><br>Në këtë kuadër ligjor dhe institucional, në TBU janë krijuar dhe funksionojnë gjithashtu Komisionet e Përhershme të Cilësisë, si në nivelin institucional, ashtu edhe në nivelin e njësive kryesore akademike. Funksionimi i tyre rregullohet nga akte të veçanta, të cilat përcaktojnë në mënyrë të qartë procedurat dhe kompetencat përkatëse, duke garantuar një proces të qëndrueshëm, transparent dhe të monitorueshëm të vlerësimit të cilësisë.<br><br>Rregullorja e funksionimit të NJSBC-së[319] përcakton qartë procedurat dhe mekanizmat e sigurimit të cilësisë, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë. Kjo njësi është gjithashtu përgjegjëse për hartimin e standardeve të brendshme të cilësisë, në përputhje me Kodin e Cilësisë dhe me objektivin e Tbu-së për përmirësim të vazhdueshëm.<br><br>Ndërkohë, Komisionet e Përhershme të Cilësisë[320] veprojnë në përputhje me Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Organeve Kolegiale[321] të TBU-së, duke luajtur një rol thelbësor në garantimin e standardeve akademike dhe në zhvillimin e vazhdueshëm të cilësisë në proceset mësimore dhe administrative. |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. | Vlerësimi i procesit të mësimdhënies realizohet në mënyrë periodike, si gjatë zhvillimit të semestrit ashtu edhe në përfundim të tij, me synimin për të garantuar cilësinë dhe për të nxitur përmirësimin e vazhdueshëm të metodologjive të mësimdhënies. Ky vlerësim bazohet në një kombinim të mekanizmave të ndryshëm, duke përfshirë si metoda të drejtpërdrejta (si vlerësimet nga studentët dhe vetëvlerësimet nga pedagogët), ashtu edhe |

[317] 62. Ligji 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH"
[318] 2. Statuti i TBU
[319] 36.1.3. Raporti vjetor i NJSBC 23-24, 36.1. Rregullore e NJSBC, 36.2. Procedura e zgjedhjes së NJSBC 24-25, 36.1.2. Plan pune i NJSBC 2024-2025
[320] 36.3.2. Plani pune i KSC FBD 24-25,36.3.3 Raporti vjetor i KSC FBD 23-24
[321] 20. Rregullore për Funksionimin e Organeve Kolegjiale

| | |
|---|---|
| | metoda të tërthorta (si analiza e të dhënave të performancës akademike dhe observimet nga strukturat përgjegjëse).[322]<br>Në këtë kuadër, studentët kontribuojnë në procesin e vlerësimit të cilësisë përmes pjesëmarrjes në anketime anonime, të realizuara me pyetësorë të strukturuar. Këto instrumente shërbejnë për të mbledhur mendimet dhe perceptimet e tyre mbi cilësinë e mësimdhënies dhe efektivitetin e metodave pedagogjike të aplikuara. Përveç kësaj, organizohen edhe focus-grupe me studentë, të cilat mundësojnë një analizë më të thelluar dhe cilësore të përvojës së tyre akademike, duke nxjerrë në pah aspekte të rëndësishme për përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor.[323]<br>Një tjetër mekanizëm thelbësor është monitorimi dhe vlerësimi i procesit të mësimdhënies nga drejtuesit e departamenteve apo profesorë të fushës, të cilët ofrojnë feedback profesional për performancën pedagogjike dhe mundësitë për përmirësim. Ky proces përfshin të gjitha lëndët dhe personelin akademik, duke synuar ruajtjen e standardeve të larta dhe nxitjen e inovacionit në mësimdhënie.[324] |
| **Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | Tirana Business University (TBU) synon të garantojë përvetësimin sa më të plotë të njohurive nga studentët, si dhe të nxisë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së procesit mësimor. Në funksion të këtij qëllimi, TBU promovon përfshirjen aktive të studentëve në proceset e vlerësimit periodik të metodave të mësimdhënies dhe të procedurave të vlerësimit të njohurive. Këto mekanizma kontribuojnë në identifikimin e nevojave për përmirësim dhe në zhvillimin e një mjedisi akademik të përqendruar te studentët, i orientuar drejt cilësisë dhe rezultateve konkrete të të nxënit.[325]<br>Ky vlerësim realizohet periodikisht në përfundim të çdo semestri përmes platformës së menaxhimit të të nxënit (Learning Management System – LMS), duke garantuar anonimatin e studentëve dhe objektivitetin në mbledhjen dhe analizën e të dhënave. Për të plotësuar këtë proces me input më të detajuar, organizohen gjithashtu focus-grupe që mundësojnë një vlerësim më të thelluar të përvojës studentore, veçanërisht në lidhje me cilësinë e mësimdhënies dhe sfidat e identifikuara.[326]Gjithashtu, studentët kanë mundësinë të adresojnë komentet, sugjerimet dhe shqetësimet e tyre edhe pranë këshilltarit akademik, i cili shërben si urë lidhëse mes tyre dhe strukturave akademike, duke ndihmuar në përmirësimin e përvojës studentore dhe zgjidhjen e çështjeve që ndikojnë në mbarëvajtjen e studimeve.[327] |

[322] 36.1. Rregullore e NJSBC; 36.3. Politika per Sigurimin e Cilesise; 36.3.1. Rregullore e Komisionit te Sigurimit te Cilesise

[323]36.1.2 Plan pune i NJSBC 2024-2025, 36.3.2 Plani pune i KSC FBD 24-25, 36.1.3. Raporti vjetor i NJSBC 23-24, 36.3.3. Raporti vjetor i KSC FBD 23-24, 36.4. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e pyetesorit nga studentet, 36.5. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e fokus grupeve, 36.6. Formati i pyetësorit për vlerësimin e lëndës & pedagogut nga studentët, 36.7. Raporti i Fokus Grupeve

[324] 36.8. Formulari i vleresimit te pedagogut nga eprori-kolegu, 36.9. Praktike e vlerësimit total të performances të pedagogut

[325] 36.4. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e pyetesorit nga studentet; 36.5. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e fokus grupeve; 36.6. Formati i pyetësorit për vlerësimin e lëndës & pedagogut nga studentët; 36.7. Raporti i Fokus Grupeve

[326] 36.4. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e pyetesorit nga studentet, 36.5. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e fokus grupeve, 36.6. Formati i pyetësorit për vlerësimin e lëndës & pedagogut nga studentët

[327] 14.7. Rrregullore e Këshillimit Akademik, 14.7.1. Plan Pune Këshilltari Akademik FBD-FTI

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | Rezultatet e vlerësimeve të studentëve, pasi përpunohen nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) ose nga Zyra e IT në rastet kur vlerësimi realizohet në mënyrë elektronike, u përcillen autoriteteve drejtuese të TBU-së dhe stafit akademik përkatës, nëpërmjet Drejtuesit të Departamentit. Departamenti shqyrton këto rezultate në mënyrë të strukturuar, vlerëson besueshmërinë e tyre dhe identifikon fushat që kërkojnë ndërhyrje. Në vijim, ndërmerren masa konkrete për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, përmes adresimit të çështjeve të evidentuara dhe zbatimit të rekomandimeve përkatëse.[328] |
| **Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | Në funksion të garantimit të cilësisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm të proceseve akademike, TBU përdor të dhënat e mbledhura nga vetëvlerësimet periodike si një instrument kyç për analizën e situatës aktuale dhe për identifikimin e fushave që kërkojnë ndërhyrje. Bazuar në rezultatet e pyetësorëve dhe mekanizmave të tjerë të vlerësimit, janë ndërmarrë masa konkrete që përfshijnë organizimin e trajnimeve dhe seminareve për rritjen e efektivitetit të metodave të mësimdhënies. Në rastet kur evidentohet performancë e ulët apo problematika të përsëritura, merren masa të posaçme për adresimin e tyre, duke synuar ruajtjen e standardeve akademike dhe forcimin e cilësisë së brendshme institucionale.[329] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi VI.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | Tirana Business University (TBU) demonstron përkushtim të vazhdueshëm ndaj sigurimit të brendshëm të cilësisë[330], duke vepruar në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, Statutin [331]dhe aktet e brendshme rregullative të saj[332]. TBU ka integruar objektivat strategjike në veprimtarinë e përditshme të strukturave të saj drejtuese dhe të personelit akademik, duke e lidhur ngushtësisht me vizionin dhe misionin.<br><br>TBU zbaton me përpikmëri kuadrin ligjor në fushën e arsimit të lartë[333] dhe i kushton rëndësi të veçantë respektimit të standardeve të cilësisë në të gjitha nivelet e funksionimit. Procedurat e brendshme të sigurimit të cilësisë janë të mirëstrukturuara, transparente dhe të orientuara drejt përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit, duke siguruar një qasje institucionale të përgjegjshme dhe të matshme ndaj cilësisë akademike. |

[328] 36.1. Rregullore e NJSBC, 36.1.3. Raporti vjetor i NJSBC 23-24, 36.3.3. Raporti vjetor i KSC FBD 23-24
[329] 36.1.2. Plan pune i NJSBC 2024-2025, 36.3.2. Plani pune i KSC FBD 24-25
[330] 36.1. Rregullore e NJSBC
[331] 2. Statuti i TBU
[332] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU
[333] 62. Ligji 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH", 68.VKM Nr. 531, datë 11.069.2018 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë"

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | Tirana Business University (TBU) ka ngritur dhe e mban në funksion të qëndrueshëm Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NJSBC), e integruar si strukturë e përhershme brenda organizimit institucional [334]që nga themelimi i saj.[335] NJSBC[336] përmbush një rol thelbësor në monitorimin dhe vlerësimin periodik të efikasitetit të veprimtarive akademike dhe kërkimore, duke garantuar që proceset zhvillohen në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të cilësisë. Njësia gëzon akses të plotë në të dhënat institucionale dhe operon mbi bazën e një strategjie të qartë dhe të miratuar për sigurimin e cilësisë.<br><br>Përveç kësaj, TBU ka funksionalizuar Komisionin e Cilësisë (KC)[337], i cili luan një rol qendror në hartimin dhe zbatimin e politikave, strategjive dhe procedurave për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike dhe administrative. Komisioni siguron ndjekjen dhe monitorimin efektiv të këtyre politikave në të gjitha njësitë akademike dhe administrative të TBU-së duke kontribuar drejtpërdrejt në përmbushjen e objektivave strategjike të TBU-së në fushën e cilësisë. |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit. | Sigurimi i cilësisë në Tirana Business University (TBU) përbën një prioritet strategjik dhe realizohet në mënyrë të strukturuar përmes përfshirjes aktive të personelit akademik dhe administrativ, mbikëqyrjes së vazhdueshme nga strukturat drejtuese, funksionimit efektiv të Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NJBSC)[338], si dhe angazhimit të studentëve, përfaqësuesve të tregut të punës [339]dhe institucioneve shtetërore si ASCAL dhe MAS.<br>TBU i është nënshtruar në mënyrë periodike procesit të akreditimit institucional dhe atij të programeve të studimit, duke marrë vlerësime pozitive nga agjencitë përkatëse[340], çka dëshmon për përmbushjen e standardeve të përcaktuara në kuadrin kombëtar të sigurimit të cilësisë. Gjithashtu, TBU-së i janë kryer verifikime të ligjshmërisë nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS), të cilat kanë konfirmuar përputhshmërinë me kërkesat ligjore në lidhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukturore.[341]<br>Në përputhje me angazhimin për përmirësim të vazhdueshëm, TBU ka institucionalizuar praktikat e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm, duke i përdorur ato si bazë për analizën dhe përmirësimin sistematik të cilësisë së mësimdhënies, përmbajtjes akademike dhe organizimit të përgjithshëm institucional. Këto procese vërtetojnë angazhimin e vazhdueshëm të TBU-së për të garantuar cilësi të lartë dhe përputhshmëri me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë. |

[334] 20. Rregullore për Funksionimin e Organeve Kolegjiale
[335] 2. Statuti i TBU
[336] 36.1. Rregullore e NJSBC
[337] 36.3.2. Plani pune i KC FBD 24-25, 36.3.3. Raporti vjetor i KSC FBD 23-24
[338] 36.1. Rregullore e NJSBC
[339] 14.1. Vendim Dekanati për Bordin e Tregut të Punës FBD, 14.1.1. Axhenda e Takimit me BTP 2023-2024, 14.1.2 FBD - PROTOKOLL - Mbledhje BTP
[340] 70. Vendim BA.Ascal. Nr. 33. datë 22.04.2022
[341] 44. Raporti i MAS për inspektimin e kapaciteteve (2022-2023), 44.1. Raporti i MAS për inspektimin e kapaciteteve (2024)

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit. | Tirana Business University (TBU) ka vendosur dhe zbaton në mënyrë të vazhdueshme një sistem të avancuar të sigurimit të brendshëm të cilësisë, i cili mbështetet në përdorimin e treguesve të qartë, të matshëm dhe të krahasueshëm për vlerësimin e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve akademike. Këta tregues shërbejnë për të reflektuar në mënyrë objektive gjendjen aktuale, arritjet dhe fushat ku kërkohen ndërhyrje për përmirësim të vazhdueshëm. Procesi i sigurimit të cilësisë është i institucionalizuar dhe mbikëqyret në mënyrë rigoroze nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC) [342]dhe Komisioni i Cilësisë (KC)[343]. Ai përfshin përdorimin e instrumenteve sistematike si anketat dhe sondazhet e rregullta me studentët dhe stafin akademik, si dhe monitorimin e vazhdueshëm të performancës mësimore dhe kërkimore. Këto të dhëna përpunohen dhe analizohen për të mbështetur vendimmarrjen institucionale dhe hartimin e politikave për rritjen e cilësisë.[344]<br><br>Për më tepër, bashkëpunimi i ngushtë me Bordin e Tregut të Punës[345] dhe institucionet shtetërore si Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) siguron që programet e studimit të jenë të përditësuara, të përputhshme me zhvillimet më të fundit në ekonomi dhe biznes dhe të orientuara drejt nevojave të tregut të punës.<br><br>TBU ka krijuar gjithashtu mekanizma të qartë për promovimin. dhe shpërblimin e ekselencës akademike [346]dhe kërkimore. Këto përfshijnë ndarjen e bursave për studentët me performancë të lartë, çmime për arritje në fushën e kërkimit, si dhe mbështetje për zhvillimin profesional të stafit përmes pjesëmarrjes në konferenca shkencore dhe platforma ndërkombëtare të shkëmbimit akademik. Këto politika dhe praktika e pozicionojnë TBU si një institucion të përkushtuar ndaj cilësisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm, duke garantuar një ambient akademik dinamik, inovativ dhe të orientuar drejt rezultateve konkrete. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |

---

[342] 36.1. Rregullore e NJSBC
[343] 36.3.2. Plani pune i KSC FBD 24-25
[344] 36.4. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e pyetesorit nga studentet, 36.5. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e fokus grupeve.
[345] 14.1. Vendim Dekanati për Bordin e Tregut të Punës FBD, 14.1.1. Axhenda e Takimit me BTP 2023-2024, 14.1.2. FBD - PROTOKOLL - Mbledhje BTP, 19. Studimi për tregun e punës
[346] 43.2. Politika e granteve

| | |
|---|---|
| Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | Tirana Business University (TBU), në përputhje me Rregulloren e Brendshme [347]dhe standardet e përcaktuara nga ASCAL, zbaton një proces të formalizuar dhe të dokumentuar për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programeve të studimit të ciklit të parë.<br><br>Procesi përfshin një qasje të integruar ndërinstitucionale, me bashkëpunimin aktiv të:<br><br>• Zyrës së Kurrikulave[348], e cila koordinon dhe ndihmon në përgatitjen teknike dhe akademike të dokumentacionit për rishikimin e programeve të studimit,<br>• Departamenteve akademike, të cilat kryejnë vetëvlerësimin përkatës të programit në fund të çdo viti akademik,<br>• Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë [349](NJBSC), që mbledh dhe analizon të dhënat për vlerësimin cilësor të programit,<br>• Komisionit të Cilësisë (KC)[350], që shqyrton rezultatet dhe rekomandon masa për përmirësim pranë Senatit Akademik,<br>• si dhe Zyrës së Marrëdhënieve me Tregun e Punës[351], që siguron konsultimin me aktorë të jashtëm.<br><br>Të gjitha dokumentet dhe rezultatet e këtyre proceseve u komunikohen autoriteteve vendimmarrëse, si dhe arkivohen nga Zyra e Kurrikulave dhe NJBSC për qëllime transparence dhe auditimi.<br><br>TBU i është nënshtruar me sukses vlerësimeve të jashtme për akreditimin institucional dhe të programeve të studimit, duke marrë vlerësime pozitive që dëshmojnë funksionimin efektiv të këtij mekanizmi. |
| Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët. | TBU zbaton një proces të mirëstrukturuar raportimi që përfshin përcaktimin e rezultateve të pritshme, analizimin e arritjeve, identifikimin dhe nxitjen e praktikave të suksesshme, si dhe ndërmarrjen e masave për përmirësim të vazhdueshëm. Raportet e hartuar reflektojnë përputhshmërinë me kuadrin ligjor dhe standardet e cilësisë në fuqi, duke shërbyer si bazë për përmirësimin dhe përshtatjen e vazhdueshme të programeve të studimit. Strukturat përkatëse si NJBSC dhe njësi të tjera të brendshme të cilësisë sigurojnë zbatimin efektiv të masave të propozuara dhe mbështesin përparësinë e cilësisë në arsim dhe kërkim, në përputhje me nevojat e tregut dhe misionin akademik të institucionit[352]. |
| Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të | TBU zbaton një sistem të integruar të metodave të drejtpërdrejta të vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit, në përputhje me kërkesat e standardeve të arsimit të lartë dhe dokumentet rregullatore në fuqi. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe didaktikës realizohet përmes: |

347 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU
348 15. Politika e Zhvillimit të Kurrikulave në TBU
349 36.1. Rregullore e NJSBC
350 36.3.2. Plani pune i KSC FBD 24-25
351 14.1. Vendim Dekanati për Bordin e Tregut të Punës FBD, 19. Studimi për tregun e punës
352 36.1. Rregullore e NJSBC, 36.1.3. Raporti vjetor i NJSBC 23-24, 36.3.3. Raporti vjetor i KSC FBD 23-24

| | |
|---|---|
| mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime [353]ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. | • Vëzhgimeve në auditor nga drejtuesit e departamenteve dhe Zyra e Kurikulave,<br>• Anketave periodike me studentët, që evidentojnë përvojën e tyre me procesin mësimor[354]<br>• Vlerësimeve paralele të provimeve dhe detyrave, me qëllim sigurimin e objektivitetit dhe krahasueshmërisë së rezultateve<br><br>Zyra e Kurikulave,[355] në bashkëpunim me NJBSC [356]dhe KC, monitoron zbatimin e këtyre metodave, duke përpunuar të dhënat dhe rekomandimet që i parashtrohen strukturave vendimmarrëse për përmirësime të vazhdueshme në përmbajtjen dhe metodat e mësimdhënies. |
| Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | TBU zbaton metoda të tërthorta për vlerësimin e cilësisë së programeve, duke realizuar çdo semestër sondazhe online të strukturës së vlerësimit të studentëve për çdo lëndë[357] (bazuar në Formularin e Vlerësimit të Studentit)[358]. Gjithashtu, intervista me alumnit dhe punëdhënës zhvillohen çdo vit përmes bashkëpunimit me Bordin e Tregut të Punës,[359] me qëllim vlerësimin e përshtatshmërisë së kompetencave të fituara nga studentët me nevojat e tregut.[360] Të dhënat përpunohen dhe analizohen nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC) dhe KC, të cilat përgatisin raporte me masa të rekomanduara për përmirësim që i paraqiten Senatit Akademik dhe Rektoratit. Ky cikël i dokumentuar kontribuon në rishikimin e rregullt të programeve dhe përshtatjen e tyre me standardet e cilësisë dhe kërkesat e tregut. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi VI.4<br>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre. | |
|---|---|
| Kriteret | Vlerësimi |
| Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe | Tirana Business University (TBU) ka integruar në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë mekanizma të mirëstrukturuar që garantojnë përfshirjen sistematike të aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në funksion të sigurimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit. Në këtë kontekst, një nga format më efektive të bashkëpunimit me faktorët e jashtëm është Bordi i Tregut të Punës, i cili përfaqëson një strukturë |

[354] 36.4. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e pyetesorit nga studentet
[355] 15. Politika e Zhvillimit të Kurrikulave në TBU
[356] 36.1. Rregullore e NJSBC
[357] 36.4. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e pyetesorit nga studentet, 36.5. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e fokus grupeve
[358] 36.6. Formati i pyetësorit për vlerësimin e lëndës & pedagogut nga studentët
[359] 14.1. Vendim Dekanati për Bordin e Tregut të Punës FBD, 14.1.1. Axhenda e Takimit me BTP 2023-2024,14.1.2. FBD - PROTOKOLL - Mbledhje BTP
[360] 19. Studimi për tregun e punës

| | |
|---|---|
| përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | këshilluese funksionale, e përbërë nga përfaqësues të bizneseve, industrisë dhe institucioneve partnere. Ky bord kontribuon drejtpërdrejt në harmonizimin e përmbajtjes së programeve me nevojat aktuale të tregut të punës dhe zhvillimet sektoriale.[361]<br>Përtej angazhimit me partnerë vendas, TBU është e angazhuar në mënyrë të vazhdueshme në iniciativa dhe projekte ndërkombëtare, me fokus në forcimin e kapaciteteve për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. Pjesëmarrja në programin Erasmus+, vizitat studimore, trajnimet dhe shkëmbimet akademike, kanë krijuar hapësira për njohjen dhe adaptimin e praktikave më të mira evropiane.[362]<br>Në këtë mënyrë, TBU demonstron jo vetëm përputhshmëri me standardet kombëtare dhe evropiane, por edhe kapacitet të qëndrueshëm institucional për të ndjekur dhe zbatuar politika moderne të sigurimit të cilësisë, në një mjedis arsimor gjithnjë në transformim. |
| Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | Në TBU, ndarja e përgjegjësive dhe funksioneve në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë është e formalizuar dhe e qartë, e përcaktuar në aktet rregullatore të institucionit (Statuti, Rregullorja e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Rregullorja e Fakulteteve dhe Udhëzimet përkatëse)[363]. Këto dokumente përcaktojnë qartësisht rolin dhe kompetencat e çdo strukture, individi apo grupi interesi të përfshirë në proces.<br>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC)[364] luan një rol qendror dhe funksional në monitorimin, koordinimin dhe vlerësimin e të gjitha veprimtarive që lidhen me sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë. NJSBC garanton që përgjegjësitë të mos jenë vetëm formale, por të zbatohen në praktikë në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme.<br><br>Përfshirja e studentëve [365] dhe stafit akademik është e institucionalizuar dhe aktive. Studentët kontribuojnë përmes:<br><br>• Sondazheve të strukturuara të vlerësimit, që realizohen në mënyrë periodike dhe të digjitalizuar;<br>• Përfaqësimit në NJSBC dhe Senatin Akademik, ku adresohen çështje që lidhen me cilësinë;<br>• Takimeve të rregullta të konsultimit[366], që nxisin dialogun institucional.<br><br>Stafi akademik, nga ana tjetër, jo vetëm që vlerësohet në mënyrë të vazhdueshme për performancën[367], por edhe angazhohet në procesin e |

[361] 14.1. Vendim Dekanati për Bordin e Tregut të Punës FBD, 14.1.1. Axhenda e Takimit me BTP 2023-2024, 14.1.2. FBD - PROTOKOLL - Mbledhje BTP, 19. Studimi për tregun e punës
[362] 34. Projektet e fituara nga TBU/ Projekte ku eshte perfshire DBF/Projekte te fituara tek AKKSHI, 46. Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit (Aneks Tabela 20 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB), 47.3. Raporti ne lidhje me mobilitetet e stafit dhe studenteve
[363] 2. Statuti i TBU, 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU, 6. Rregullore e Fakultetit te Biznesit dhe Drejtesise, 7. Rregullore e Departamentit te Biznesit dhe Finances, 36.1. Rregullore e NJSBC
[364] 36.1. Rregullore e NJSBC
[365] 60.1. Perfshirja e studenteve ne qeversijen e TBU, 60.2. Procesverbal i Mbledhjes së Senatit Studentor 24-25, 60.3. Raporti për përzgjedhjen e Senatit Studentor 24-25
[366] 14.7. Rrregullore e Këshillimit Akademik
[367] 36.8. Formulari i vleresimit te pedagogut nga eprori-kolegu, 36.9. Praktike e vlerësimit total të performances të pedagogut, 2. Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik

| | |
|---|---|
| | rishikimit të lëndëve dhe programeve, duke sjellë përmirësime të qëndrueshme dhe të dokumentuara në përmbajtjen mësimore.<br><br>Strukturat drejtuese të fakulteteve dhe administrata akademike zbatojnë rekomandimet e NJSBC në mënyrë të përgjegjshme, duke i integruar ato në planet vjetore të punës dhe strategjitë zhvillimore të programeve. |
| Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit. | Në TBU, sigurimi dhe vlerësimi i cilësisë së programeve të studimit realizohet përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe të institucionalizuar, që garanton angazhimin aktiv të të gjitha njësive përgjegjëse për programin, si dhe të personelit akademik, ndihmësakademik, administrativ dhe vetë studentëve. Ky proces udhëhiqet nga aktet rregullatore të TBUsë të cilat përcaktojnë qartë rolet dhe përgjegjësitë e secilit aktor të përfshirë.[368]<br>Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) përbëhet nga Kryetari i Komisionit, një përfaqësues i stafit akademik nga secili fakultet, një përfaqësues i stafit ndihmës akademik ose administrativ, si dhe një përfaqësues i Këshillit të Studentëve. Kjo përbërje siguron një qasje të ekuilibruar dhe gjithëpërfshirëse në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë, duke mbështetur vazhdimisht përmirësimin e standardeve akademike dhe të veprimtarisë institucionale në tërësi.[369] |
| Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. | Përfshirja dhe angazhimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit në TBU bazohet në respektimin rigoroz të parimeve të integritetit akademik dhe barazisë. Institucioni zbaton politika të qarta për të garantuar që çdo proces vlerësimi të zhvillohet në mënyrë të paanshme dhe gjithëpërfshirëse, duke shmangur çdo formë diskriminimi apo trajtimi të pabarabartë ndaj personelit apo studentëve.<br><br>Përzgjedhja e anëtarëve të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) bazohet në kritere të qarta dhe objektive, të cilat përfshijnë:<br><br>a) Kompetencat profesionale – Anëtarët duhet të zotërojnë ekspertizë të njohur në fushën e tyre, për të garantuar një analizë cilësore dhe të besueshme;<br>b) Paanshmëria – Kujdes i veçantë i kushtohet shmangies së çdo konflikti interesi, duke siguruar që anëtarët të veprojnë me objektivitet dhe integritet profesional;<br>c) Aksesi në informacion – Anëtarëve u garantohet mundësia për të mbledhur dhe analizuar në mënyrë të plotë të dhënat dhe burimet e nevojshme për vlerësim;<br>d) Njohja e kontekstit institucional dhe akademik – Anëtarët duhet të kenë njohuri të mirëfillta mbi funksionimin e institucionit dhe standardet e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë.<br><br>Për të ruajtur objektivitetin dhe integritetin e procesit, anëtarët e NJSBC-së nuk mund të jenë pjesë e strukturave drejtuese të TBU-së. Kjo masë |

[368] 60.1. Perfshirja e studenteve ne qeverisjen e TBU, 36.2. Procedura e zgjedhjes së NJSBC 24-25
[369] 60.1. Perfshirja e studenteve ne qeversijen e TBU, 36.2. Procedura e zgjedhjes së NJSBC 24-25

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| | kontribuon në ndarjen funksionale të përgjegjësive dhe garanton pavarësinë institucionale në proceset e vlerësimit të brendshëm.[370] |
| Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | Me qëllim garantimin e një vlerësimi gjithëpërfshirës dhe të një përmirësimi të vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit, TBU angazhon në mënyrë aktive bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm në kuadër të proceseve të sigurimit të brendshëm të cilësisë.<br><br>Përfshirja e tyre realizohet përmes mekanizmave të strukturuar si:<br>• Takimet periodike me Bordin e Tregut të Punës, të cilat shërbejnë si platformë për diskutimin e trendeve të tregut të punës dhe përshtatshmërisë së përmbajtjeve akademike me nevojat reale të sektorëve profesionalë;[371]<br>• Pjesëmarrja në projekte të dedikuara për sigurimin e cilësisë, përfshirë nisma kombëtare dhe ndërkombëtare që synojnë harmonizimin me praktikat më të mira akademike dhe përmirësimin e metodologjive të vlerësimit.[372]<br><br>Këto ndërhyrje forcojnë dimensionin praktik të arsimit të ofruar dhe garantojnë që programet e TBU-së të reflektojnë vazhdimisht zhvillimet bashkëkohore të tregut dhe standardet evropiane të arsimit të lartë. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi VI.5<br>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë. | |
|---|---|
| Kriteret | Vlerësimi |
| Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | TBU ka ndërtuar një politikë të qartë dhe të dokumentuar të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila bazohet në standardet kombëtare dhe evropiane të cilësisë në arsimin e lartë. Kjo politikë është pjesë integrale e Strategjisë Institucionale[373], miratuar nga autoritetet përkatëse të TBU-së. Të gjitha veprimtaritë që lidhen me vlerësimin, mbikëqyrjen dhe përmirësimin e cilësisë në nivel programi janë të dokumentuara dhe bëhen të njohura për studentët dhe palët e interesuara.<br><br>Politika dhe strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë në TBU janë të përcaktuara qartë dhe zbatohen në mënyrë transparente. Në kuadër të kësaj, |

[370] 36.1. Rregullore e NJSBC, 36.2. Procedura e zgjedhjes së NJSBC 24-25
[371] 14.1. Vendim Dekanati për Bordin e Tregut të Punës FBD, 14.1.1. Axhenda e Takimit me BTP 2023-2024, 14.1.2. FBD - PROTOKOLL - Mbledhje BTP
[372] 37.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programin e studimit (BaAB), 37.4. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit, 47.1. Rregullore për shkëmbimin e stafit, 47.2. Rregullore per shkembimet studentore
[373] 3.1. Strategjia e Zhvillimit te TBU 24-29, 3.1.1. Strategjia e Zhvillimit te TBU 18-23


TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| | Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSB) [374]organizon veprimtarinë e saj bazuar në një plan vjetor, që përcakton monitorimet në sektorët dhe proceset që i nënshtrohen vlerësimit, duke përfshirë fazat kryesore të mbledhjes së të dhënave dhe publikimin e raporteve me gjetjet përkatëse.<br><br>TBU garanton akses të hapur për studentët, stafin akademik dhe administrativ, si dhe për partnerët dhe aktorët e jashtëm të interesuar në politikat dhe procedurat e sigurimit të cilësisë. Raportet e vlerësimit dhe analizat e cilësisë së programeve të studimit publikohen rregullisht, duke përfshirë rekomandimet për përmirësim, dhe sigurojnë një proces të hapur, transparent dhe të vazhdueshëm për rritjen e cilësisë akademike në institucion.[375] |
| Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. | Publikimi i rezultateve të vlerësimeve të programeve të studimit realizohet duke respektuar parimet thelbësore të transparencës, etikës akademike dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) përgatit raporte të detajuara që përmbajnë analiza të cilësisë akademike dhe të proceseve të zhvillimit të programeve, përfshirë edhe të dhëna të ndjeshme që kërkojnë trajtim të kujdesshëm dhe konfidencial.[376] |
| Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | TBU harton dhe zbaton plan masash të detajuara në vijim të çdo vlerësimi të brendshëm, i cili kërkon që rezultatet të përkthehen në veprime konkrete për përmirësim. Planet e masave përfshijnë:<br><br>• organizimin e trajnimeve të synuara për stafin akademik,[377]<br>• përmirësimin e metodologjive mësimdhënëse,[378]<br>• rishikimin e përmbajtjes së moduleve,<br>• forcimin e komponentëve të praktikës dhe përfshirjen e kërkesave të tregut të punës (referuar Rregullores së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë në TBU).[379]<br><br>Këto masa monitorohen nga NJSBC dhe raportohen në fund të çdo vitit akademik për të vlerësuar progresin dhe impaktin.[380] |
| Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. | Të gjitha dokumentet, procedurat dhe instrumentet e sigurimit të cilësisë reflektojnë angazhimin e institucionit për të garantuar një proces të qëndrueshëm dhe efektiv monitorimi dhe vlerësimi, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit. Ky proces realizohet në mënyrë të strukturuar përmes rishikimit periodik të politikave dhe praktikave të brendshme, analizës së të dhënave nga vlerësimet e studentëve dhe stafit akademik, si dhe përfshirjes aktive të aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm – përfshirë përfaqësues të tregut të punës dhe alumnit. Në funksion të |

[374] 36.1.2. Plan pune i NJSBC 2024-2025, 36.3.2. Plani pune i KSC FBD 24-25
[375] 36.1.3. Raporti vjetor i NJSBC 23-24, 36.3.3. Raporti vjetor i KSC FBD 23-24
[376] 36.1.3. Raporti vjetor i NJSBC 23-24, 36.3.3 Raporti vjetor i KSC FBD 24-25, 36.7. Raporti i Fokus Grupeve
[377] 38.1.1. Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin dhe studentët
[378] 15. Politika e Zhvillimit të Kurrikulave në TBU
[379] 37. Rregullore e praktikës mësimore & dokumentat përkatëse
[380] 36.1. Rregullore e NJSBC

TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| | përmirësimit, institucionit i hartohet një plan veprimi që synon adresimin e problematikave të evidentuara dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe të të nxënit,[381] duke mbështetur zhvillimin profesional dhe akademik të studentëve dhe stafit në një mënyrë sistematike dhe të bazuar në evidencë. |
| Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. | Në TBU, përfshirja aktive e stafit akademik dhe studentëve në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë realizohet si në mënyrë të drejtpërdrejtë, përmes pjesëmarrjes në strukturat e garantimit të cilësisë, ashtu edhe në mënyrë të tërthortë, përmes informimit dhe ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e përmirësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit.<br><br>Ky informacion transmetohet rregullisht përmes rregulloreve institucionale dhe përfaqësuesve të studentëve në struktura si NJSBC[382], Senati Akademik dhe Këshilli i Studentëve.[383] Një rol të veçantë në këtë proces ka edhe Java e Orientimit, e organizuar në fillim të vitit akademik, që ka për qëllim njohjen e studentëve të rinj me standardet e cilësisë dhe mekanizmat e sigurimit të saj brenda institucionit.<br><br>Kjo qasje garanton angazhimin e të gjithë palëve të përfshira në proces dhe kontribuon në zhvillimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike në TBU. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

381 56. Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies
382 36.1. Rregullore e NJSBC
383 60.1. Perfshirja e studenteve ne qeversijen e TBU, 60.3. Raporti për përzgjedhjen e Senatit Studentor 24-25

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Administrim Biznesi" Me profile : Menaxhim, Marketing, Kontabilitet Financë**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Programi ofrohet në një fushë kyçe për zhvillimin ekonomik, me një kërkesë të qëndrueshme dhe në rritje për profesionistë të profilizuar në menaxhim, marketing dhe financë, siç dëshmohet edhe nga bashkëpunimet me sektorin privat.
2. Lëndët janë të organizuara sipas logjikës së progresit akademik, nga bazat drejt lëndëve të avancuara, duke reflektuar interdisiplinaritet dhe balancim të përmbajtjes teorike dhe praktike.
3. Pjesëmarrja aktive e studentëve në projekte, praktikë dhe bashkëpunime me bizneset përmes Marrëveshjeve me Grupin Balfin dhe Bordin e Tregut të Punës.
4. Zbatimi i mekanizmave të sigurimit të brendshëm të cilësisë, përfshirë sondazhet semestrale të studentëve, rishikimin e lëndëve dhe vlerësimin e stafit pedagogjik.
5. Stafi akademik përbëhet nga pedagogë me kualifikime të larta dhe përvojë reale në industri, duke garantuar një mësimdhënie të balancuar ndërmjet bazës teorike dhe qasjes praktike, të përqendruar në zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve.
6. TBU ka krijuar dhe zgjeron vazhdimisht bashkëpunimet ndërinstitucionale në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar, përmes marrëveshjeve akademike, pjesëmarrjes aktive në programin Erasmus+ dhe iniciativave për diploma të dyfishta. Këto nisma rrisin ndërkombëtarizimin, pasurojnë përvojën akademike të studentëve dhe fuqizojnë lidhjen e tyre me tregun global të punës.
7. Infrastruktura moderne, përfshirë auditorët e pajisur me teknologji bashkëkohore, laboratorët, mjediset e praktikës dhe qasja në burime digjitale, ofron një mjedis të favorshëm për mësimdhënie dhe zhvillim profesional.

**Pika të dobta:**

1. Tendenca demografike në rënie dhe konkurrenca në rritje nga institucionet e tjera të arsimit të lartë, kanë ndikuar në numrin e regjistrimeve në program, duke e bërë të vështirë sigurimin e grupeve të qëndrueshme studentore çdo vit akademik.
2. Mungesa e interesit të vazhdueshëm nga maturantët për disa profile specifike të programit të studimit, e lidhur edhe me perceptimin për mundësitë e punësimit pas përfundimit të ciklit të parë.

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

3. Ndikimi i lartë i faktorëve të jashtëm në zgjedhjen e studimeve, si emigracioni i të rinjve, preferenca për studime jashtë vendit apo në programe profesionale afatshkurtra, ka ndikuar në uljen e qëndrueshmërisë së regjistrimeve.
4. Gjithashtu, zhvillimet ekonomike dhe sociale në vend ndikojnë në kapacitetin financiar të familjeve për të financuar arsimin e lartë, duke ndikuar drejtpërdrejt në numrin e aplikimeve.
5. Konkurrenca e fortë nga universitetet publike dhe private tjera ku oferta më e gjerë dhe më e diversifikuar e konkurentëve mund të tërheqë studentë potencialë.

**Rekomandime:**

1. Thellimi i bashkëpunimeve me universitete të huaja për programe të përbashkëta ose të dyfishta diplomimi, duke fuqizuar dimensionin ndërkombëtar të diplomave të ofruara.
2. Nxitja e pjesëmarrjes së stafit në konferenca ndërkombëtare, publikimeve në revista të indeksuara dhe projekte të financuara në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
3. Ftesa e ekspertëve ndërkombëtarë për të rritur ekspozimin e studentëve dhe stafit ndaj trendeve globale në arsim, menaxhim, teknologji dhe zhvillim të qëndrueshëm.
4. Krijimi i një platforme digjitale ku studentët dhe stafi mund të raportojnë çështje dhe të ndjekin procesin e zgjidhjes.
5. Përdorimi i AI për të personalizuar mësimin, analizuar performancën e studentëve dhe për të ofruar asistencë digjitale në kohë reale.

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

**Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor in ''Business Administration'' with Profiles: Management, Marketing, Financial Accounting**

**Strengths and affirmations**

1. It is offered in a key field for economic development, with a stable and growing demand for qualified professionals in management, marketing, and finance, as evidenced by the institution's active collaboration with the private sector.
2. The curriculum is structured according to the logic of academic progression—from foundational to advanced courses—and reflects an interdisciplinary approach, with a balanced integration of theoretical knowledge and practical application.
3. Students are actively engaged in projects, internships, and collaborations with businesses, particularly through formal partnerships with the Balfin Group and the Labor Market Board.
4. Internal quality assurance mechanisms are actively implemented, including semester-based student surveys, course reviews, and evaluation of teaching staff, ensuring continuous academic improvement.
5. The academic staff is composed of highly qualified lecturers with real-world industry experience, ensuring a teaching approach that is well-balanced between theory and practice, and focused on the development of students' professional competencies.
6. TBU has established and continues to expand institutional cooperation at the regional, national, and international level through academic agreements, active participation in the Erasmus+ program, and initiatives toward dual degree offerings. These actions foster internationalization, enrich students' academic experience, and strengthen their connection with the global labor market.
7. The modern infrastructure, including classrooms equipped with advanced technology, laboratories, practical training spaces, and access to digital resources, provides a supportive environment for teaching, learning, and professional development.

**Weaknesses**

1. Demographic decline and increasing competition from other higher education institutions have affected the number of enrollments in the program, making it difficult to secure stable student groups each academic year.
2. The lack of sustained interest from high school graduates in certain specific profiles of the study program is also linked to perceptions about employment opportunities after completing the bachelor's cycle.

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

3. External factors significantly influence study choices, such as youth emigration, preference for studying abroad, or enrollment in short-term professional programs, which has impacted the stability of enrollments.
4. Furthermore, economic and social developments in the country affect families' financial capacity to support higher education, directly influencing the number of applications.
5. Strong competition from other public and private universities, offering a wider and more diversified range of programs, can attract potential students away.

**Recommendation:**

1. Deepening collaborations with foreign universities for joint or double degree programs, thereby strengthening the international dimension of the offered diplomas.
2. Encouraging staff participation in international conferences, publications in indexed journals, and projects funded at national and international levels.
3. Inviting international experts to increase exposure of students and staff to global trends in education, management, technology, and sustainable development.
4. Creating a digital platform where students and staff can report issues and track the resolution process.
5. Utilizing AI to personalize learning, analyze student performance, and provide real-time digital assistance.

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

**Lista e dokumenteve bazë për procesin e akreditimit të programeve të studimit**

0 Raporti i Vleresimit të Brendshëm për BaAB (shqip)

00 Plani i veprimit për përmbushjen e rekomandimeve të BA për BaAB

01. Raporti i Vleresimit të Brendshëm për BaAB (anglisht)

02. Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB BaAB

1 Mendimi i Dekanit FBD

2 Statuti i TBU

2.1.1. Vendim Senati 7 dt.28.09. 2022 per riorganizmin e Fakulteteve FAB dhe FD

2.1.2. Vendim Senati 9 dt. 28.09. 2022 per hapjen e Fakultetit te Teknologjise se Informacionit

2.1.3. Vendim Senati 9-1 dt.16.11.22 Per hapjen e programeve Inxh.Informatike; Inxh.Kompjuterike dhe Inxhienieri Softwerike

2.1.4. Vendim SA Nr. 51dt.11.09.23 mbi ristrukturimin ne zbatim te urdherave 195 ,196 MAS

2.2. Struktura Organizative TBU

3.1. Strategjia e Zhvillimit te TBU 24-29

3.1.1. Strategjia e Zhvillimit te TBU 18-23

3.2. Strategjia e Kerkimit Shkencor 24-29

3.2.1 Strategjia e Kerkimit Shkencor 18-23

4. Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit Ba-AB

5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU

6. Rregullore e Fakultetit te Biznesit dhe Drejtesise

7 Rregullore e Departamentit te Biznesit dhe Finances

7.1. Formulari i planifikimit të ngarkesës të stafit akademik në auditor nga departamenti

8. Rregullore për Sekretarinë Mësimore

9. Rregullore e programit të studimit Ba "Administrim Biznesi" (shqip)

9.1. Rregullore e programit të studimit Ba"Administrim Biznesi" (anglisht)

10. Formati i tezës së provimit përfundimtar

11 Udhëzim për përgatitjen e temës së diplomës

12.1. Kalendari akademik 2022-2023

12.2. Kalendari akademik 2023-2024

12.3. Kalendari akademik 2024-2025

13. Rregullore për punësimin, largimin nga puna dhe vlerësimin e personelit

13.1. Shembull njoftim për vend vakant për staf akademik në website

13.2. Politika e BNJ ne TBU

13.3. Format Dosje staf akademik (administrohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore, sipas PAK/PAE):

13.4. Praktika e rekrutimit te stafit

14. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore

14.1. Vendim Dekanati për Bordin e Tregut të Punës FBD

14.1.1 Axhenda e Takimit me BTP 2023-2024

14.1.2. FBD - PROTOKOLL - Mbledhje BTP

14.2. Panairi i punës 2024 (ftese)

14.3. Aktivitete të realizuara nga ZÇS për studentët Ba

14.4. Aktivitete bashkëpunime me biznesin për studentët Ba

14.5. Ditët informuese në TBU

14.6. Urdhër Rektori për planin e gjimnaz tour 24-25

14.7. Rrregullore e Këshillimit Akademie

14.7.1 Plan Pune Këshilltari Akademik FBD-FTI

15. Politika e Zhvillimit të Kurrikulave në TBU

16.1. Kurrikula e programit Ba "Administrim Biznesi" (shqip)

16.2. Kurrikula e programit Ba "Administrim Biznesi" (anglisht)

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

16.3. Plani mësimor i programit të studimit Ba "Administrim Biznesi" (shqip)

16.4. - Plani mësimor i programit të studimit Ba "Administrim Biznesi" (anglisht)

16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – Ba "Administrim Biznesi"

16.6. Shkresa TBU Nr.45, dt.27.03.2025 Per ndryshim ne kurrikulat e programeve te studimit te TBU 25-26 ( ndryshim brenda 20%)

16.7. Shkresa e MAS, Nr. 2109/3, Dt. 06/05/2025 per konfirmimin e ndryshimeve.

17.1. Modeli i diplomës_Modeli i Suplementit të Diplomës_për BaAB per 3 profilet

17.2. Forma e re e propozuar e diplomës dhe suplementit_për BaAB me 3 profile

18. Kodi i Etikës

19. Studimi për tregun e punës

20. Rregullore për Funksionimin e Organeve Kolegjiale

21. Adresimi i rekomandimeve të akreditimeve të mëparshme

22. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e studimit – BaAB (shqip & anglisht)

23. Formati i Syllabusit (shqip/anglisht) – VKM 41/2018

24. CV e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit

25. CV e stafit akademik udhëheqës i diplomave (në rastin kur nuk është pjesë e stafit akademik të programit) (nëse ka)

26. 22. CV e stafit ndihmës akademik (nëse ka)

27. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse (Aneks Tabela no.1 & 2 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB )

28. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit BaAB për 3 vite 22-25 (Aneks Tabela 6,12,7,8 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB)

29. Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik, të angazhuar në programin e studimit BaAB për 3 vite 22-25 (Aneks Tabela 4 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB )

30. Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga njësia përgjegjëse (Aneks Tabela 3 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB)

31. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin (Aneks Tabela 21 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB)



TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

32. Procedura e Pranimit të Studentëve në TBU (Shkëputur nga Rregullore. eTBU)

32.1. Procedura e ndjekur për pranimin e studentëve Ne TBU (Ba AB-IE-IS-IK)

33. Rregullore per Transferimin e studimeve

34. Projektet e fituara nga TBU/ Projekte ku eshte perfshire DBF/Projekte te fituara tek AKKSHI

35. Të dhëna për punësimin real të studentëve 22-24 (Aneks Tabela 23)

36.1. Rregullore e NJSBC

36.1.2. Plan pune i NJSBC 2024-2025

36.1.3 Raporti vjetor i NJSBC 23-24

36.2. Procedura e zgjedhjes së NJSBC 24-25

36.3. Politika per Sigurimin e Cilesise

36.3.1 Rregullore e Komisionit te Sigurimit te Cilesise

36.3.2. Plani pune i KSC FBD 24-25

36.3.3 Raporti vjetor i KSC FBD 23-24

36.4. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e pyetesorit nga studentet

36.5. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e fokus grupeve

36.6. Formati i pyetësorit për vlerësimin e lëndës & pedagogut nga studentët

36.7. Raporti i Fokus Grupeve

36.8. Formulari i vleresimit te pedagogut nga eprori-kolegu

36.9. Praktike e vlerësimit total të performances të pedagogut

37. Rregullore e praktikës mësimore & dokumentat përkatëse

37.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi (Aneks Tabela 5)

37.2. Memorandum TIP_TBU_Subjekt

37.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programin e studimit (BaAB)

37.4 Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit

37.5. Vendimet për përcaktimin e Pedagogut-pedagogëvve Udhëheqës për Praktikat Mësimore për vitin 24-25 FBD

38.1 Politika për zhvillimin professional të stafit

38.1.1 Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin dhe studentët

39. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit BaAB

40 Formati i relacionit për monitorimin e syllabuseve

41. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit BaAB

42. Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik

43. Rregullore e Qendrës për Kërkime e Studime Ekonomike dhe Juridike - QKSEJ

43.1. Indikatorët e vlerësimit të performancës kërkimore-shkencore për personelin akademik

43.1.2. Formular i raportimit te punes kerkimore shkencore

43.2. Politika e granteve

43.3. Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit të programit të studimit BaAB (Aneks Tabela 19)

43.4. Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë, në tre vitet e fundit (Aneks Tabela 22; 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB)

44. Raporti i MAS për inspektimin e kapaciteteve (2022-2023)

44.1 Raporti i MAS për inspektimin e kapaciteteve (2024)

44.2. Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Aneks Tabela 16 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB)

45. Strategjia e Zhvillimit te IT

45.1. Udhëzues për përdorimin e teknologjisë të informacionit

45.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS

45.3. Guidë për studentët për përdorimin e LMS

45.4 Trajnime mbi sistemin LMS

46 Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit (Aneks Tabela 20 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB)

47.1. Rregullore për shkëmbimin e stafit

47.2. Rregullore per shkembimet studentore

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

47.3. Raporti ne lidhje me mobilitetet e stafit dhe studenteve

48. Rregullore e bibliotekës

48.1. Inventari i teksteve ne Bibilotekë për fushën e programit të studimit BaAB

48.2. Procedura e miratimit të Dokumentit Mbi Procedurën e Blerjes së Literaturës në TBU

49. Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Aneks Tabela 17 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB)

50. Politika e Marketingut të TBU për programet e studimit

51.1. Të dhëna mbi koston për student (Aneks Tabela 18.1 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB)

51.2. Të ardhura dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB )

51.3. Pasqyrat Financiare 2021_2022_2023

51.4. Raport auditimi 2021_2022_2023

51.5. Procedura e miratimit të buxhetit 2023 dhe planit buxhetor 24-27

52. Ndryshimet e kurrikulës BaAB (Aneks Tabela 11)

53. Shkresa për akreditimin e programeve BaAB në ASCAL

54.1. Plani vjetor i DBF 23-24

54.2. Raporti vjetor I DBF 23-24

55.1. Raporti vjetor institucional 2021-2022

55.2. Raporti vjetor institucional 2022-2023

55.3. Raporti vjetor institucional 2023-2024

56. Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies

57. Rregullore e Arkivës

58. Mareveshja e MAS_TBU_dt.9.07.2024 _Përcaktimi i Personeli Akademik

59.1. Brochure Scientific Conference TBU

59.2. Program of TBU Conference

60. Rregullore e Keshillit Studentor

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

60.1. Perfshirja e studenteve ne qeversijen e TBU

60.2. Procesverbal i Mbledhjes së Senatit Studentor 24-25

60.3. Raporti për përzgjedhjen e Senatit Studentor 24-25

61.1. Vendim për tarifat dhe bursat e studentëve për vitin 24-25

61.2. Tarifat dhe bursat VA 2024-2025

61.3. Të dhëna për shpërndarjen e bursave ndër vite

61.4. Kontratë dhurimi Mane Foundation dt.9.11.23

61.5. Kontratë dhurimi Mane Foundation_TBU studenti Klejvi Pero 24-25

61.6. Skema e bursave sociale në TBU

62. Ligji 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH"

63. TBU_Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 794, dt. 06. 10. 2010 Licensimi i TBU

64. Urdhër MAS Nr. 75, datë 16.02.2011

65. Urdhër MAS Nr. 326,dt. 15.08.2013 Akreditimi Institucional dhe i Programeve

66. Vendim i Këshillit të Akreditimit Nr. 506, dt 18.07.2013

67. VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit", e ndryshuar

68. VKM Nr. 531, datë 11.069.2018 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë"

69.1 VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 Kodifikimi programeve qbz

69.2 Ministria e Arsimit "Për afatet e kodifikimit të programeve të Studimit ofruar nga institucionet e Arsimit të Lartë" nr.prot.295 ,dt 16.01.2023

69.3. Udhezim-Nr.31-date-15.11.2022-Kodifikimi-i-programeve-te-studimit-IAL-pdf

69.4. Korrespondenca me MAS mbi kodifikimin e programev te studimit

69.5. Shkresa e MAS Nr. 7381/22, dt. 30.12.2024 për "Konfimimin e kodeve te programeve të studimit në Kolegjin Universitar Tirana Business University.

70. Vendim BA.Ascal. Nr. 33. datë 22.04.2022

71. Urdhër Rektori – ngritja e GVB për akreditimin e programit të studimit BaAB

72. Tabela e kuotave sipas troje, transferime_2024-2025

72.1 Procedura per rialokimin e kuotave të pranimit 24-25